

Prill 2019  
Numri: 133  
E përnuajshme

Revistë edukative-kulturore - [www.revistaetika.com](http://www.revistaetika.com)

# ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë  
Kosovë: 1.5 Euro  
Maqedoni: 90 Den  
Evropë: 7 Euro

10



## RRUGËTIMI I MUSLIMANIT





revistaetika



progresibotime

TË  
RINJ

*Shtëpia botuese Progresi  
vjen me 2 libra të rinj, të cilët  
do të ushqejnë botën tonë shpirtërore  
dhe do t'i japin drejtim jetës sonë  
individuale dhe shoqërore.*



Islami përbën një jetë krejt të re. Nëse njeriu përdor vetëdijen pasi hyn në strukturën e Islamit, atëherë feja jonë ia ndërton përsëri personalitetin. Në të vërtetë, nëse mendojmë pak më thellë, do të vëmë re se njeriu jeton duke “marrë dhe dhënë frymë”. Kur merr frymë, lind, dhe kur jep frymë, vdes. Për këtë arsye, nëse mendojmë pak më seriozisht, dalim në rezultatin se duhet t’ia japim hakun çdo frymëmarrjeje. Çdo frymëmarrje duhet ta jetojmë sipas Islamit dhe në Botën e Përtejme duhet ta dërgojmë të ndërthurur me besimin.

Termi “ndjeshmëri ndaj frymës së fundit”, në të vërtetë nënkupton “ndjeshmërinë ndaj çdo frymëmarrjeje”, sepse ne nuk mund ta dimë se cila frymëmarrje do të jetë e fundit, ngaqë Fuqia e cila na i ka dhuruar këto frymëmarrje, nuk na ka njoftuar për këtë.

Ata që mendojnë thellë, përpiqen që çdo frymëmarrje ta jetojnë sikur të ishte fryma e fundit e tyre. Të menduarit me thellësi, bekon me vetëdije çdo sjellje dhe veprim tonin. Disiplina e të qenit “ibnu’l-vakt/biri i kohës”, që sufitë e kanë si parim, në të vërtetë do të thotë që çdo frymëmarrje, pra çdo sekond të jetës, ta përjetojmë me vetëdije. Çfarë do të thotë “biri i kohës”? Termi “biri i kohës” nënkupton një njeri që rilind çdo moment, që përpiket të kryejë çdo veprim me cilësinë që kërkon myslimanizmi, që e mbush botën e brendshme me vetëdijen se “Allahu e shikon”, dhe një njeri që arrin prehjen shpirtërore përmes sentencës: “Këtë vepër nesër mund ta mbart dhe ta çoj pa druajtje në audiencën e Allahut Teala, sepse nuk do të turpërohem prej saj. Këtë vepër timen mund ta mbroj në atë audiencë të lartë. Kjo vepër nuk është një punë boshe, e gabuar apo manipulative...”

Dhikri/përmendja e Zotit mban vetëdijen gjallë. Dhikri duhet të përfshijë mendjen dhe zemrën, në refrenin: “Mos e harro Krijuesin! Mos e harro Krijuesin! Mos e harro Krijuesin!” Nëse nuk e harrojmë Atë, nuk harrojmë asgjë, dhe nuk degradojmë në humbje të vetëdijes, të cilën e quajmë gaflet/shkujdesje. Të jesh “biri i kohës” do të thotë që vazhdimisht të rilindësh përgjatë kësaj rruge dhe gjithmonë të qëndrosh i ri. Çfarëdo moshe që të ketë fiziku i “ibnu’l-vakt”, zemra e tij gjithmonë gjendet në moshë të re. Ajo nuk bën lëshime, nuk konsumohet dhe nuk lodhet. Të qenit “ibnu’l-vakt” do të thotë rinovim i vazhdueshëm i energjisë së brendshme. Si mund të realizohet kjo?

**Prill 2019**

VITI: XIII

NUMRI: 133

**BOTUESI**

Shtëpia botuese "Progresi"

**DREJTOR**

Albert Halili

**KRYEREDAKTOR**

Alban Kali

**REDAKTOR**

Zija Vukaj

**PËRKTHYES**

Albert Halili

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

**DIZAJN**

Bledar Xama

**ADRESA**

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

**MOBILE**

+355 67 340 6182

**E-MAIL**

rev.etika@gmail.com

**WEBSITE**

www.progresibotime.com

**KOSOVË**

Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 45 639 143

Prishtinë; Kosovë

Mob: +377 44 566 577

**MAQEDONI**

Drvarska 28; Stara Carsija

Skopje; Makedonija

Mob: +389 7145 6003

**ABONIMI VJETOR**

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro


Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

# Përmbajtja



Fazil Mustafa Pasha  
Dr. Ardian Muhaj

15



8

Pozita jonë te Allahu  
Idris Arpat



Udhëtimi i përjetësisë  
Osman Nuri Topbash

34




10

30

Pesha e mungesës  
Edison Çeraj



- 5 Çdo moment me gjallëri,  
çdo moment me vetëdije  
Ahmet Tashgetiren
- 10 A arrihet kënaqësia e kësaj bote  
vetëm duke bërë gjynahe?  
Ali Riza Temel
- 12 Përçarja  
Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan
- 18 Kuptimi i vëllazërisë në besim  
Nuredin Jëlldëz
- 20 Ajetet e lutjeve në Kuranin Fisnik  
Xhafer Durmush
- 22 Akumulimi i sevapeve  
Raif Koçak
- 24 Veprat që e zbukurojnë fytyrën  
Xhemal Nar
- 25 Sekretet e suksesit të vezirit  
Ferudun Ozdemir



44

Abdullah ibn Xhaferi 26  
Mustafa Erish  
Një Ajet-Një Hadith 32


El-Halim 40  
Ilir Hoxha  
Zgjidhja për ndihmë ndaj individit,  
shoqërisë, umetit dhe njerëzisë  
gjendet në përshpirtje  
M. Ali Eshmeli

I falimentuari i Ahiretit 50  
Ferit Piku  
Nëse nuk do të keni më punë me Allahun 53  
Urtësi

Të qash për jetimët 54  
Shefika K. Meriç

42

Gruaja nga këndvështrimi  
i ajetit 35 të sures "El-Ahzab"  
Imam Muhamed Sytari



Rrezja e parë që bie në zemër  
Fatma Allada

57



# Çdo moment me gjallëri Çdo moment me vetëdije

— Ahmet Tashgetiren —

Njëri prej rreziqeve më të mëdha me të cilin mund të përballet myslimani, është sindroma e bretkosës së zier. Kjo sindromë është e tillë:

Nëse bretkosën do ta fusnim në ujë apo vaj të nxehtë, menjëherë do të hidhej dhe do të dilte jashtë, por nëse do ta fusnim në ujë normal apo të vakët dhe do ta nxehnim ujin dalëngadalë, ajo nuk do ta kuptonte nxehtësinë dhe pas pak kohe do të zihej.

Kur myslimani gjendet ballë për ballë me një ndërhyrje shumë të fortë në lidhje me besimin dhe vlerat e tij, të gjitha reflekset i vihen në funksion dhe si rezultat kapet më fort pas rrugës së vet. Por kur helmin e shpërndarë në një atmosferë që ia ka rrethuar të gjitha anët, e merr nëpërmjet frymëmarrjes pak nga pak, nuk mund ta kuptojë

ndryshimin që i ndodh në zemër, dhe pas një farë kohe shndërrohet në një njeri me personalitet të paqartë, që përjeton së bashku me Islamit edhe mënyra të tjera jetese.

Domosdoshmërisht neve na duhet të mbajmë gjallë vetëdijen dhe jetën duhet ta ndërtojmë në bazë të saj. E fshehta e personalitetit për myslimanin, në të gjitha kohët, gjendet këtu.

Të qenit mysliman duhet të jetë një zgjedhje e vetëdijshme. Edhe të qëndruarit mysliman duhet të realizohet përmes një zgjedhjeje po të tillë. Njeriu duhet ta shqiptojë shahadetin me vetëdije. Këtë ndoshta nuk mund ta kuptojnë ata që e kanë trashëguar Islamit nga gjyshi apo babai. Por për ata që kanë hyrë në Islam nga botë të tjera, perceptimi i dy sentencave është jashtëzakonisht i rëndësi-

shëm. E para: E vërteta e ekzistencës dhe njësimi të Allahut. E dyta: E vërteta që Muhamedi (a.s.), është robi dhe i Dërguari i Allahut...

Nëse nuk e kanë kuptuar ekzistencën e Krijuesit më parë, atëherë së pari duhet ta perceptojnë këtë, dhe nëse kanë pasur një besim “politeist”, atëherë duhet ta konvertojnë besimin e tyre në “monoteist”. Ky veprim quhet besim. Besimi është çështje perceptimi. Një besim pa perceptim nuk mund të shndërrohet në një rregull kryesor dhe përcaktues të personalitetit të njeriut. Për këtë arsye, edhe poeti i famshëm Mehmet Akif Ersoji thotë: “Sa xhevahir madhështor është besimi! Ndërsa zemra e ndryshkur e pa besim, është barrë për kraharorin.” Besimi për myslimanin është burimi kryesor. Nëse nuk ekziston gjallëria për të zgjedhur, çdo aspekt i myslimanizmit që do të ndërtohet mbi këtë bazë, do të jetë i privuar nga gjallëria e perceptimit.

Të gjitha parimet e besimit bëhen fuqi ndërtuese e një jete të re vetëm kur të perceptohen siç duhet. “Marifetull-llah / njohja e Allahut” është e mundur vetëm me anë të perceptimit. Bota e Përtejme i jep drejtim jetës vetëm përmes një perceptimi të gjallë. Pejgamberi, Kurani, etj. shndërrohen në eliksire që japin jetë vetëm nga një perceptim i tillë. Pajisja e fushës së besimit me perceptim, është kusht për takimin me Islamin. Edhe pasi të hyjmë në Islam,

vetëdija duhet të vazhdojë të qëndrojë e gjallë.

Nëse një person hyn rishtas në Islam, mëson namazin dhe qëndron në audiencën e Allahut (falet), ai patjetër fillon të mendojë që qëndrimi në audiencën e Allahut Teala nuk është diçka krejt e thjeshtë. Kështu nis të kërkojë në thellësitë e shpirtit të tij. Ku konsiston ky kërkim?

Për shembull, ai do të pyesë dikë që është mysliman që prej shumë kohësh: “Çfarë ndjeni në namazet që falni? Unë nuk po ndjej gjë në brendësinë time?”

Myslimani i hershëm në atë moment do të ndalojë. Ndoshta çështja për të cilën është pyetur, është një ndjesi që nuk e ka kërkuar asnjëherë brenda vetes. Nëse ai do të jetë i mbarsur me kulturën islame, me vete do të thotë: “Ajo që synon ky person duhet të jetë qetësia e brendshme.” Pastaj, ky mysliman do të vazhdojë të hetojë botën shpirtërore të tij duke e pyetur veten:

“Me të vërtetë, çfarë është qëndrimi në audiencën e Allahut? Çfarë është sexhdeja? Çfarë është rukuja? Çfarë është të qëndruarit në këmbë përgjatë namazit? Çfarë është këndimi i Kuranit në namaz? Çfarë është të thënët “Allahu Ekber”? Çfarë është nijeti që e bëjmë në fillim? Me të vërtetë, a e kemi

**NË TË VËRTETË, NËSE MENDOJMË PAK MË THELLË, DO TË VËMË RE SE NJERIU JETON DUKE “MARRË DHE DHËNË FRYMË”. KUR MERR FRYMË, LIND, DHE KUR JEP FRYMË, VDES. PËR KËTË ARSYE, NËSE MENDOJMË PAK MË SERIOZISHT, DALIM NË REZULTATIN SE DUHET T’IA JAPIM HAKUN ÇDO FRYMËMARRJEJE. ÇDO FRYMËMARRJE DUHET TA JETOJMË SIPAS ISLAMIT DHE NË BOTËN E PËRTEJME DUHET TA DËRGOJMË TË NDËRTHURUR ME BESIMIN.**

vëmendjen në namaz kur falemi?”

Personi që sapo e ka përçafuar Islamit, siç e zbulon namazin moment pas momenti, do të fillojë ta jetojë çdo çast dhe dimension të jetës sipas Islamit, sepse Islami është një mënyrë të jetuari, një botëkuptim dhe preferencë për leximin e universit. Islami është zgjedhja për t'i dhënë kuptim ekzistencës. Islami është zgjedhja për t'u bërë një njeri i ri. Çfarë kuptimi do të kishte nëse dikush do të konvertohej në mysliman, por te ai nuk do të ndodhte asnjë ndryshim?! Po nëse dikush prej nesh do kalonte nga bota e Islamit në botë të tjera, dhe nuk do të dallonte ndryshim në jetën e vet, a do të mund të thuhej se jeta e mëparshme e tij ka qenë e bazuar te Islami?

Islami përbën një jetë krejt të re. Nëse njeriu përdor vetëdijen pasi hyn në strukturën e Islamit, atëherë feja jonë ia ndërton përsëri personalitetin. Në të vërtetë, nëse mendojmë pak më thellë, do të vëmë re se njeriu jeton duke “marrë dhe dhënë frymë”. Kur merr frymë, lind, dhe kur jep frymë, vdes. Për këtë arsye, nëse mendojmë pak më seriozisht, dalim në rezultatin se duhet t'ia japim hakun çdo frymëmarrjeje. Çdo frymëmarrje duhet ta jetojmë sipas Islamit dhe në Botën e Përtejme duhet ta dërgojmë të ndërthurur me besimin.

Termi “ndjeshmëri ndaj frymës së fundit”, në të vërtetë nënkupton “ndjeshmërinë ndaj çdo frymëmarrjeje”, sepse ne nuk mund ta dimë se cila frymëmarrje do të jetë e fundit, ngaqë Fuqia e cila na i ka dhuruar këto frymëmarrje, nuk na ka njoftuar për këtë.

Ata që mendojnë thellë, përpiqen që çdo frymëmarrje ta jetojnë sikur të ishte fryma e fundit e tyre. Të menduarit me thellësi, bekon me vetëdije çdo sjellje dhe veprim tonin. Disiplina e të qenit “ibnu'l-vakt/biri i kohës”, që sufite e kanë si parim, në të vërtetë do të thotë që çdo frymëmarrje, pra çdo sekond të jetës, ta përjetojmë me vetëdije. Çfarë do të thotë “biri i kohës”? Termi “biri i kohës” nënkupton një njeri që rilind çdo moment, që përpiqet të kryejë çdo veprim me cilësinë që kërkon myslimanizmi, që e mbush botën e brendshme me vetëdijen se “Allahu e shikon”, dhe një njeri që arrin prehjen shpirtërore përmes sentencës: “Këtë vepër nesër mund ta mbart dhe ta çoj pa drujtje

në audiencën e Allahut Teala, sepse nuk do të turpërohem prej saj. Këtë vepër timen mund ta mbroj në atë audiencë të lartë. Kjo vepër nuk është një punë boshe, e gabuar apo manipulative...”

Dhikri/përmendja e Zotit mban vetëdijen gjallë. Dhikri duhet të përfshijë mendjen dhe zemrën, në refrenin: “Mos e harro Krijuesin! Mos e harro Krijuesin! Mos e harro Krijuesin!” Nëse nuk e harrojmë Atë, nuk harrojmë asgjë, dhe nuk degradojmë në humbje të vetëdijes, të cilën e quajmë gaflet/shkujdesje. Të jesh “biri i kohës” do të thotë që vazhdimisht të rilindësh përgjatë kësaj rruge dhe gjithmonë të qëndrosh i ri. Çfarëdo moshe që të ketë fiziku i “ibnu'l-vakt”, zemra e tij gjithmonë gjendet në moshë të re. Ajo nuk bën lëshime, nuk konsumohet dhe nuk lodhet. Të qenit “ibnu'l-vakt” do të thotë rinovim i vazhdueshëm i energjisë së brendshme. Si mund të realizohet kjo?

Sytë dhe zemrat e njerëzve mund të lodhen. Atmosfera në të cilën jetojmë dhe besimet e ndryshme ekzistuese, ndikojnë deri në damarët tanë. Hadithi fisnik i të Dërguarit të Allahut, (a.s.), në të cilin lufta me nefsin përkufizohet si “lufta e madhe”, pikërisht në këtë pikë fiton kuptimin e plotë. Edhe përkufizimi: “Asketizmi është një luftë pa periudha paqeje, që bëhet kundrejt nefsit.”, fiton kuptim të plotë në këtë pikë.

Pastrimi shpirtëror konsiston në përpjekjen për të qenë i gjallë dhe i vetëdijshëm në çdo moment. Le ta theksojmë se gjendja e të qenit i vetëdijshëm dhe i gjallë në çdo moment, nuk është një strukturë karakteri që e ka përvetësuar vetëm shkolla askete.

Asketi është një njeri që kërkon, që rend pas gjallërisë dhe që e kupton se është i vetëdijshëm në çdo çast. Kjo është një ndjeshmëri e domosdoshme për çdo mysliman.

Tashmë mund të themi këtë:

Forca e myslimanizmit tonë është në raport të njëjtë me gjallërinë dhe vetëdijen që kemi. Ne duhet të përpiqemi që, siç ka thënë edhe poeti i shquar Junus Emre, “të rilindim në çdo moment”, në mënyrë që myslimanizmi ynë të mos pësojë humbje në cilësi. Zoti (xh.sh.), na e dhuroftë të gjithëve këtë gjallëri në vetëdije!

Amin!



# POZITA JONË TE ALLAHU



— Idris Arpat —



Nën këtë titull do të përpiqemi t'i japim përgjigje pyetjes: “Cila është pozita e njeriut te Allahu i Lartësuar?” Allahu Teala na ruajt nga gabimi në të shkruar dhe i ruajtë lexuesit nga gabimi në të kuptuar! Trajtimin le ta fillojmë me fjalën e tevhidit.

Tevhidi ndalon që Zotin (xh.xh.), ta imagjinojmë me mendje, duke i dhënë një imazh të ngjashëm me dikë a diçka. Ndërsa shprehja “kelimetu't-tevhid” shpreh të vërtetën se nuk ka zot tjetër përveç Allahut Teala. (Enciklopedia Islame e Fondacionit të Entit për Çështjet Fetare të Republikës së Turqisë, vëll. 25, fq. 214.)

Tevhidi nënkupton njohjen dhe shprehjen e faktit se i gjithë autoriteti i përket Allahut Fuqiptotë, ngaqë Zoti (xh.sh.), posedon të gjitha atributet. Të shprehurit e “kelimetu't-tevhid” me gjithë zemër dhe shpirt, do të thotë nënshkrim i fund-listës së nënshtrimit ndaj Tij. Nga ky nënshkrim kuptohet pranimi i të gjitha pikave të listës.

“Kelimetu't-tevhid” përbëhet nga dy pjesë: pjesa mohuese dhe ajo pohuese. Mohimi “nuk ka zot”, thekson refuzimin e të gjithë zotave jo të vërtetë dhe të gjitha besimeve të formuara në bazë të këtyre zotave. Një mysliman që thotë “la ilahe/nuk ka zot”, automatikisht shprehet se e ka mbyllur veten kundrejt të gjitha gabimeve në këtë pikë. Përveç kësaj, ai shprehet se nuk ekziston një qenie tjetër që posedontribute hyjnore siç i posedon Allahu Teala. Për këtë arsye, ai pranon se nuk ekziston një qenie tjetër, nga i cili duhet të merren urdhrat në mënyrë të padiskutueshme, përveç Allahut të Lartësuar. Ndërsa kur robi thotë pjesën tjetër të fjalës së tevhidit, e cila është “il-lall-llah”, ai dëshmon se pranon që Allahu Teala është ekzistenca e vetme që meriton të adhurohet, sepse Allahu (xh.xh.), është ekzistenca e vetme që posedon të gjitha atributet hyjnore. Sigurisht që i Drejti Absolut posedon të gjitha atributet hyjnore.

Allahu i Lartësuar e shpjegon veten me “Esmau'l-Husna/Emrat e Bukur” në Kuranin Fisnik, me argumenta që na bëhen të dukshme përmes çdo krijese

që ka krijuar në këtë botë dhe me zërin që lartësohet në ndërgjegje. Meqë Allahu i Madhëruar e shpjegon Vetën e Tij, atëherë njeriut i takon që të përpiqet ta kuptojë Atë. Nëse njeriu arrin ta kuptojë sadopak, duke u impenuar me të gjitha mundësitë, atëherë brenda tij do të zgjohet një mahnitje e pamatë, e cila do të sjellë edhe nënshtrimin ndaj Zotit (xh.sh.). Nënshtrim do të thotë adhurim. Adhurim do të thotë t'i bindesh urdhrat të Allahut me dëshirë dhe vullnet të lirë, ndërkohë që i pohon vetes: “Meqë Allahu Teala më njeh dhe më do më shumë seç e dua veten, apo seç më duan të tjerët, pranoj që të jetoj vetëm sipas parimeve të Tij.” Kështu duhet ta kuptojmë ajetin: **“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.”**, të sures Fatiha. Kur adhurojmë dikë, prej atij presim edhe ndihmën. Kjo është më se e natyrshme.

Allahu i Lartësuar e shpjegon Vetën dhe emrat e bukur të Tij, por njeriu është një qenie e kufizuar, ndërsa Allahu Teala është i pakufishëm. Për këtë arsye, njeriu mund ta kuptojë Allahun deri në një pikë të caktuar. Edhe adhurimin kundrejt Zotit, sado që të përpiqet, mund ta kryejë vetëm deri në një pikë të caktuar. **“Po, (asnjë njeri) nuk i kryen dot pa mangësi urdhrat e Atij.”** (Abese, 23.) Prandaj robi duhet ta dijë cakun e tij në këtë pikë dhe të veprojë me modesti.

“Tevhidi uluhije” ka lidhje me qenien e Allahut të Lartësuar, ndërsa “tevhidi rububije” ka lidhje me krijesat e Tij. Të qenit e Zotit (xh.xh.), i pashoq, i pabarabartë dhe i pangjashëm në të gjitha cilësitë e Tij, shprehet në formën: “Zot i vetëm.” Zoti është poseduesi, furnizuesi, vendosësi i rregullave, etj. për të gjitha krijesat. Kjo shprehet në formën: “Zoti i vetëm i tokës dhe qiejve.” Ngaqë bota e krijesave ia ka borxh Allahut Teala ekzistencën, vazhdimësinë e jetës në një rregull të caktuar dhe plotësimin e çdo lloji nevojë, sigurisht që edhe adhurimin duhet t'ia dedikojë Atij.

Nënshtrimi ndaj Zotit (xh.xh.), nuk përbëhet vetëm nga adhurimet e mirënjohura prej të gjithëve.





Në të vërtetë, nënshtrimi ndaj Zotit është të jetuarit për Allahun dhe sipas rregullave të Allahut në çdo aspekt të jetës. Ky është nënshtrimi me gjithë zemër. Nënshtrimi të krijesat e tjera është i pavullnetshëm, ndërsa të njeriu është me vullnet të plotë.

Ngaqë Allahu është i Drejti Absolut, edhe rregullat që vendos Ai, janë rregulla që sigurojnë drejtësinë. Mjafton që njeriu të mos gabojë në zbatimin e tyre.

Ata që vendosin rregulla duke abuzuar me autoritetin e tyre, absolutisht do t'i vendosin ato për mbrojtjen e interesave dhe salltaneteve të veta, duke shkelur parimin e drejtësisë, të paktën në disa pika të caktuara. E nëse nuk ka drejtësi, nuk ka as paqe. Dihet se të gjitha problemet në botën e njerëzve lindin për shkak të shkeljes së drejtësisë. Domethënë, nëse do të ndërtohej një botë me bosht drejtësinë dhe mirësinë, nuk do të kishte asnjë lloj problemi.

Sigurisht që Allahu i Lartësuar nuk ka për t'i lënë krijesat e Tij në duar të pandërgjegjshme. Ai i ka marrë nën garanci të drejtat e të gjitha krijesave me parimet që ka dërguar, sepse Ai është Mbrojtësi më i mirë dhe Mëshiruesi më i madh. Kjo do të thotë se Islami është një rend botëror. Prandaj tërësia e Kuranit Fisnik dhe Sunetit të të Dërguarit të Allahut, (a.s.), duhet të mbrohet. Ata që dëshmojnë se i besojnë Allahut (xh.xh.) dhe Pejgamberit të Tij, nuk bëjnë përzgjedhje sipas interesave të tyre dhe nuk marrin iniciativën për të formuar një fe sipas mendimeve të veta. Edhe theksimi me insistim i vetëm disa rregullave të caktuara të fesë, duke lënë në harresë të tjerat, përbën të njëjtin lloj gabimi, i cili mund të përkufizohet si “ndërhyrje në fe”.

Shprehja “Muhammedun Resulull-llah/Muhamedi është i Dërguari i Allahut” që gjendet në vazhdimësi të “kelimetu’t-tevhidit”, siç ka thënë edhe Said Havva, mbart këtë kuptim: “Ne jemi të obliguar ta pranojmë fenë siç e ka shpjeguar Muhamedi, (a.s.), me të gjitha rregullat. As nuk mund të heqim, as nuk mund të shtojmë asgjë. Këtu duhet të bazohet edhe mësimdhënia e fesë.”

Meqë po flasim për këtë çështje, duhet të kujtojmë edhe një herë ngjarjen e Adij ibn Hatemit:

Kur Adij ibn Hatemi dëgjoi ajetin fisnik: “Çifutët kanë marrë për zota rabinët dhe të krishterët priftërinjtë.”, kërkoi shpjegim duke pyetur: “Unë i njoh të krishterët. Asnjë i krishterë nuk i bën sexhde priftit. Çfarë kuptimi ka ky ajet?” I Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, iu përgjigj Adij ibn Hatemit duke e pyetur:

*“A i shpallin priftërinjtë haram ato që Allahu i ka bërë hallall dhe hallall ato që Allahu i ka bërë haram? A nuk i pranojnë këto shpallje ata që ua dëgjojnë fjalën priftërinjve?”* Adij ibn Hatemi i tha: “Po, ashtu është.” Nisur nga këto fjalë, i Dërguari i Allahut, (s.a.s.), i tha: *“Ja, kjo është braktisje e Allahut dhe marrje për zot e priftërinjve.”*

Sa e njuh njeriu njeriu dhe sa e njuh botën njerëzore? Sa ia do të mirën njeriu njeriu dhe botës njerëzore? Sa është i pavarur njeriu prej dobësive të tij kur vendos rregulla? Sa mund ta parashikojë njeriu të ardhmen? Sa mund t'i llogarisë njeriu ato që do të ndodhin? Sigurisht që ka një kufi për të gjitha këto. Ndërkohë që për Allahun Teala nuk ka kufizime. Kjo është një e vërtetë e njohur për të gjithë.


Ngaqë Allahu i Lartësuar kërkon mbrojtjen e të drejtave të krijesave të Tij, sigurisht që këtë botë do t'ua besojë atyre që vlerësojnë drejtësinë, butësinë dhe mëshirën e Tij. Edhe besimtarët do t'i zbatojnë të gjitha detyrat e kërkuara për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Nëse është e nevojshme dija, do të marrin dije. Nëse është i nevojshëm personaliteti, do të përvetësojnë personalitetin Islam. Nëse është e nevojshme fuqia, do të bëjnë çdo gjë të lejuar për ta arritur atë fuqi. Ata që pretendojnë se janë mbrojtësit e drejtësisë së Allahut Teala në sipërfaqen e tokës, nuk mund të rrinë pa reaguari kundrejt ngjarjeve që ndodhin. Ata përpiqen të parashikojnë të ardhmen me aq sa munden. Nëse në këtë botë, adhuruesit e dëshirave, pasioneve dhe nefseve të veta, bëjnë projekte qindra vjeçare, robërit e Allahut duhet të bëjnë projekte dyqind apo pesëqind vjeçare. Besimtarët duhet ta dinë se mungesa e vizionit është fillimi i fundit. Dihet se “ata që nuk janë të aftë të mendojnë në afatgjatë, gjenden farë pranë me dështimin”.

Këtu është e nevojshme që të shtjellojmë edhe një çështje tjetër në mënyrë të përmbledhur:

Ngaqë Suneti është zbatimi dhe përjetimi i Kuranit Fisnik, i Dërguari i Allahut, (a.s.), është shembulli që duhet të pasojmë. Ne nuk mund ta imagjinojmë Sunetin të ndarë nga Kurani dhe Kuranin të ndarë nga Suneti. Që të dy janë kusht për njëri-tjetrin.

Paqja e Zotit qoftë mbi robërit e përkushtuar që përvëlohen me mallëngjimin për një botë me bazë “drejtësinë dhe mirësinë”.



# A ARRIHET KËNAQËSIA E KËSAJ BOTE VETËM DUKE BËRË GJYNAHE?

— Ali Riza Temel —

A nuk mund të bëhet një jetë e kënaqshme duke vepëruar brenda kornizës së hallallit dhe duke mos e ulur veten te haramet? A nuk janë hallallet të mjaftueshme për t'u kënaqur? A është jeta sipas Islamit një jetë e dëshpëruar, e ngrirë, e ftohtë dhe pa kënaqësi? A është jeta fetare me një bazë të mbushur plot haramet si një tokë e mbushur me mina? A është myslimani një udhëtar që jeton me shqetësimin e shkeljes në minë?

Përqasja laike dhe shekullare, që po sundon botën e ditëve të sotme, për fat të keq po e koncepton dhe reklamon fetarizmin si barrë, vështirësi dhe jetë në burg, dhe po shet perceptimin se të jetuarit e pavarur nga feja është shpëtim nga skllavëria. Poseduesit e kësaj përqasjeje dhe këtij perceptimi nuk janë të vetëdijshëm se po bëjnë një jetë të papërgjegjshme dhe jonjerëzore, për shkak se janë robër të dëshirave dhe pasioneve të tyre. Për njeriun asnjëherë nuk mund të ketë një jetë pa rregull dhe disiplinë. Edhe kafshët në aspektin absolut nuk janë të lira. Çka i jep kuptim jetës janë vlerat njerëzore dhe morale. Humbja e këtyre vlerave është humbje e humanizmit.

Njeriu është mëkëmbësi i Allahut Teala në sipërfaqen e tokës. Njeriu është krijesa më fisnike. Zoti (xh. sh.), çdo gjë na e ka nënshtruar për të na sprovuar. Ai shprehet në Kuranin Fisnik: **“Është Ai që për ju ka krijuar çdo gjë që ka në Tokë...”** (Bakara, 29.)

Po ashtu thotë: **“Thuaj: “Kush i ka penguar stolitë dhe ushqimet e këndshme, të cilat Ai i ka krijuar për robërit e Vet?” Thuaj: “Ato janë për besimtarët (dhe të tjerët) në këtë botë, ndërsa në botën tjetër do të jenë vetëm për besimtarët. Kështu ua shpjegojmë shpalljet njerëzve që dinë.”** (A'raf, 32.)

Mirësitë e Allahut sigurisht që më së shumti i meritojnë ata që i besojnë Atij. Zoti (xh.xh.), kujtdo që përpiket dhe punon për ta arritur atë që dëshiron,

ia jep shpërblimin e përpjekjes. **“Ne i mbështesim të gjithë me dhuratat e Zotit tënd: edhe këta, edhe ata. Dhuratat e Zotit tënd nuk i mohohen askujt.”** (Isra, 20.)

Në këtë botë të sprovës ku jetojmë, sigurisht që do të ketë urdhra dhe ndalesa, sepse sprovat nuk mund të realizohen në ndonjë mënyrë tjetër. Urdhrat dhe ndalesat janë kusht për një jetë njerëzore me paqe dhe siguri. Ndërsa jetë pa rregulla nuk mund të ketë. Çështjet e lejuara janë shërim, ndërsa ato të ndaluara janë zeher. Haramet janë si ushqimi në kurth. Ata që ushqehen me haramet, janë si mizat që lëshohen mbi mjaltin e helmuar.

Në dukje, haramet duken magjepsëse, sepse nefsi dhe shejtani i tregojnë të mirat të këqija dhe të këqijat të mira, si magjistarët.

Dëshirat dhe nevojat që njeriu ka, mund t'i plotësojë nëpërmjet rrugëve të lejuara. Për realizimin e tyre nuk ka nevojë që t'u drejtohet haramet. Në të vërtetë, haramet shkaktojnë degjenerim, sepse janë shkelje e rregullave natyrale dhe ligjore. Ai që i shkel rregullat e ligjshme, shkel edhe veten.

Siç e kemi shprehur edhe në fillim, korniza e çështjeve të lejuara është e mjaftueshme për kënaqësitë. Nevojat seksuale mund të plotësohen nëpërmjet martesës. Kur nevojat plotësohen me mënyra të lejuara, atëherë ato kanë sevape si adhurimet, sepse trajtohen si bindje ndaj Zotit (xh.xh.). Ndërsa haramet përfaqësojnë kundërshtimin ndaj Zotit. Për të shuar urinë, ka ushqime të pafundme të pastra dhe të lejuara. Për të shuar etjen, ka pije të panumërta që janë hallall. Për të kënaqur sytë, ka shumë bukuri dhe pamje të mrekullueshme. Për t'u qetësuar, ka shumë lloje argëtimesh të lejuara. Për t'i plotësuar nevojat dhe dëshirat, ka shumë mënyra dhe mundësi të lejuara. Jeta jonë

nuk ka nevojë aspak për imoralitetin, vjedhjen dhe bixhozin.

Allahu Teala nuk na ka sjellë një fe që nuk mund të zbatohet dhe përjetohet, përkundrazi, ka dhënë urdhra dhe ndalesa për gjallërimin e njerëzimit. Edhe pse këto i rëndojnë nefsit dhe bien në kundërshtim me epshet tona, janë urdhra dhe ndalesa që na japin jetë dhe shërim. Në shikimin e parë operacioni është i frikshëm dhe ilaçet janë të hidhura e të padëshiruara, por ngaqë na shërojnë dhe na japin jetë, detyrimisht aplikohen, sepse rezultat e tyre janë pozitive.

Islami është feja më e përshtatshme për natyrshmërinë e njeriut. Edhe Allahu (xh.xh.), edhe i Dërguari i Tij, kanë synuar lumturinë e të dy botëve për njerëzit. Zoti i Madhëruar shprehet në Kuranin Fisnik: *"...Allahu dëshiron që t'jua lehtësojë dhe jo që t'jua vështirësojë..."* (Bakara, 185.) *"Tashmë ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për gjynahet që bëni ju, jua dëshiron të mirën me gjithë zemër që ju të shkoni rrugës së drejtë dhe është i butë e i mëshirshëm me besimtarët."* (Teube, 128.)

Siç e thamë edhe më sipër, njeriu është një krijesë me përgjegjësi. Ai është mëkëmbësi i Allahut Teala në tokë. Atij i është dhënë vullneti i lirë. Njeriu ka marrë përsipër përgjegjësinë, pra, amanetin që qiejt, toka dhe malet hezituan ta merrnin. Për këtë arsye, njeriu është i detyruar të veprojë me kujdes. Për çdo vepër është i detyruar që të bëjë llogarinë nëse fiton apo humbet prej saj. Në të kundërt, jeta e tij nuk mbetet më njerëzore, por shndërrohet në një jetë shtazore. Allahu Teala shprehet: *"Pa dyshim, ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, Allahu do t'i shpjerë në Xhenete, nëpër të cilat rrjedhin lumenj. Ndërsa ata që nuk besojnë dhe kënaqen e hanë ashtu siç gëlltisnin bagëti, do të kenë Zjarrin si vendbanim!"* (Muhammed, 12.) Madje, shumë prej kafshëve bëjnë përzgjedhje në çështjen e të ushqyerit.

Njeriut nuk i ka hije që të kaplohet nga joshja e kësaj bote dhe të harrojë Dhuruesin e vërtetë të mirësive. Adhurimi dhe nënshtrimi ndaj Zotit (xh.xh.), është shprehje e falënderimit ndaj Tij. I Dërguari i Allahut, (s.a.s.), ka thënë: *"Padyshim se kjo botë është e ëmbël dhe magjepsëse. Allahu ju ka bërë mëkëmbës aty. Ai po ju vëzhgon se si veproni. Jini të kujdesshëm në çështjet e kësaj bote dhe të grave. Prova e parë e bijve të Izraelit ishin gratë."* (Rijazu's-Salihin, Hadithinr: 70.) Edhe Allahu Teala shprehet: *"...Mos e lini jetën e kësaj bote t'ju mashtrorë dhe as djallin mos e lini t'ju mashtrorë për Allahun."* (Lukman, 33.)

Allahu i Lartësuar e sprovon njeriun me joshjen ndaj haremeve dhe vështirësinë e ibadeteve, por haramet i ngjajnë mjaltit të helmuar, ato janë vrasëse. Ndërsa adhurimet janë si ilaçet që shndërrohen në burim shërimi. Nëse kënaqësia e Allahut (xh.xh.), mbahet në plan të parë, ngjarjet e rënda shndërrohen në mirësi dhe vështirësitë në mëshirë.

A është kusht për të konsumuar alkool ndërsa ha peshk në ndonjë vend me pamje nga deti? A është e domosdoshme që të mos kemi turp dhe të zhvishemi kur ecim dhe notojmë në det, në bregdet etj.? A nuk

mund të argëtohem dhe dëfrehemi si na ka hije? A është e pamundur që të ndajmë vend notimi të veçantë për gratë dhe për burrat? A bëhet fjalë për të përfutur nga deti apo nga diçka tjetër?

Përdorimi i mirësive të Allahut duke kundërshtuar ligjet e Tij, është shenjë e qartë mosmirënjohjeje. Shndërrimi i këtyre mirësive në mosmirënjohjeje, në vend të falënderimit, është i papranueshëm nga ndër-gjegjja.

Çështja vërtitet e vërtitet dhe përsëri vjen e lidhet me besimin. Ai që i beson Allahut Teala dhe fesë së Tij, më e pakta ndjen keqardhje për mëkatet dhe pendohet. Fatkeqësia më e madhe është nxjerrja jashtë funksioni e Allahut dhe fesë së Tij. Kjo sjell shkatërrim të rendit në shoqëri dhe rënie të vlerave etike e njerëzore.

Pika e fundit, ku mund të arrijë një përjasje shekullare që nuk e beson Ahiretin, është falimentimi material dhe shpirtëror. Kjo botë, në të cilën po sundon hedonizmi, po zhytet me shpejtësi drejt batakut të këtij të fundit.

Dëshirat dhe epshet që nuk disjolinohen, janë si ujërat e tërbuar që nuk mund të mbahen nën kontroll. Siç janë tragjedi zjarri dhe përmbytja, edhe pasionet e pakontrolluara janë vetë tragjedia.

Burimi themelor i moralit dhe drejtësisë është feja. Allahu Teala është Ai që e ka krijuar njeriun dhe njëkohësisht Ai që i ka vendosur rregullat të cilat duhet të zbatohen. Ai i di më së miri nevojat, dobësitë dhe strukturën e njeriut, i cili është vepër e Tij. Ai që prodhon makinerinë, përgatit edhe manualin e përdorimit. Allahu Teala thotë: *"E si të mos dijë Ai që ka krijuar gjithçka, kur Ai njuh çdo gjë me imtësi dhe është i Gjithëinformuari?!"* (Mulk, 14.)

Në fillim të këtij shkrimi jemi shprehur se nuk ka nevojë për t'u bërë mëkatarë dhe për të bërë harame, në mënyrë që të bëjmë një jetë të lumtur dhe të këndshme. Plotësimi i këtyre nevojave është i mundur edhe nëpërmjet rrugëve të lejuara. Për të arritur në këtë pikë, duhet të formojmë një vend dhe mjedis Islam. Meqë shejtani asnjëherë nuk ndalon së vepruari, dhe meqë nuk arrijmë ta formojmë njëqind për qind një mjedis të tillë, atëherë duhet të formojmë një strehë në të cilën mëkatet kryhen sa më pak të jetë e mundur. Ky përparim nuk mund të arrihet me mëkate, por me një jetë që ka në qendër besimin.

Ne nuk duhet të rendim pas dëshirave provizore, por pas ngjyrave që nuk veniten, pas vlerave të reja që nuk vjetrohen dhe pas bukurive të përhershme. Ata që rendin pas gjërave që perëndojnë dhe humbin, në fund do të perëndojnë dhe humbin edhe vetë. Lumturia e përhershme nuk mund të shkatërrohet për një kënaqësi të përkohshme. Gjërat e lejuara janë aq të shumta saqë nuk kemi nevojë për gjërat e ndaluara. Gjithmonë është e mundur të jetojmë duke e zbatuar Islamin.



# PËRÇARJA

## NDARJA NË FRAKSIONE

— Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan —

NË KURANIN FISNIK  
ËSHTË DËNUAR  
ASHPËR SJELLJA E  
KONTRADIKTAVE  
NË FE, NË MASËN  
QË RREZIKON  
TË PËRÇAHET  
UMMETI ISLAM.  
ZOTI I MADHËRUAR  
THOTË: **“ME TË  
VËRTETË, TI S’KE  
TË BËSH FARE ME  
ATA QË E PËRÇAJNË  
FENË E TYRE DHE  
SHNDËRROHEN NË  
SEKTE. TE ALLAHU  
ËSHTË PUNA E TYRE  
E PASTAJ AI DO T’U  
TREGOJË ÇFARË  
PATËN PUNUAR.”**  
(EN’AM, 159.)

“Puna e vëllezërve në Islam paska qenë “bi’l-ma’ruf/urdhërimi për të mirë”,

Vëllezërit duhet ta pengojnë njëri-tjetrin, nëse vërejnë ndonjë veprim të papërshtatshëm apo ligësi.” (Mehmet Akif Ersoj)

Kuptimi leksikor i fjalës “tefrika” është ndarje në pjesë dhe njësi, përçarje dhe diskriminim. Ndërsa në kuptimin terminologjik do të thotë ndarje në fraksione nga aspekti i besimit. Nisur nga ky kuptim, ndarja në fraksione është një fenomen të cilin e ka ndaluar Islami, i cili e ka bërë parim tevhidin në besim dhe bashkimin në shoqëri. Thirrja është shumë e qartë: “(O ju që keni besuar!) **Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kuranin) dhe mos u përçani!..**” (Al ‘Imran, 103.)

Ne si myslimanë dëshmojmë se Allahu Teala është Një dhe se “Siratu’l-Mustekim/Rruga e Drejtë” është rruga e vetme që të shpie te Ai. Në Kuranin Fisnik thuhet: **“Ti, me të vërtetë, udhëzon në rrugën e drejtë, (në) rrugën e Allahut, të Cilit i përket gjithçka që ndodhet në qiej dhe gjithçka që ndodhet në Tokë.”** (Shura, 52-53.) Në këtë mënyrë, jemi njoftuar se puna themelore e të Dërguarit të Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, është udhëzimi në rrugën e drejtë.

Por të mos harrojmë se edhe pse rruga e drejtë është një e vetme, asnjëherë nuk është pengesë që grupet e ndryshme të ecin në të njëjtën rrugë, sepse në një

rrugë të gjerë dikush mund të ecë djathtas, dikush mund të ecë majtas dhe dikush tjetër mund të ecë në mes. Nuk është aspak normale që këto grupe të zihen, grinden dhe përplasen me njëri-tjetrin, me qëllim afrimin e të tjerëve pranë vetes. Ndoshta për shkak të këtyre zënkave dhe grindjeve, shumë prej nesh do të privohen nga ecja në këtë rrugë të drejtë dhe do ta gjejnë veten duke u rrokullisur në humnerë, ndërkohë që thonë se të gjithë duhet të ecin pas tyre.

Ndarja në fraksione dhe përçarja e ummetit të Muhamedit sot po ndodh pikërisht për shkak të këtyre mosmarrëveshjeve, intolerancës dhe pasimit të grupeve në mënyrë të verbër. Në fakt, përçarja për të cilën dëshirojmë të flasim fokusohet pikërisht në këtë pikë.

Në të vërtetë, të mendosh se mirësi është vetëm rruga jote dhe se ajo mirësi mund të përdoret vetëm me lejen tënde, pavarësisht nëse ky mendim mbështetet te nijeti i mirë, do të thotë ta shndërrosh atë rrugë të gjerë në një rrugë të ngushtë në të cilën mund të ecin vetëm disa njerëz. Tentativa për t'ia shfaqur shoqërisë/ummetit një botëkuptim të tillë, ka shkaktuar ndarje në fraksione, kontradikta dhe ofendime, që e kanë preokupuar ummetin përgjatë gjithë historisë.

Ndërsa i Dërguari i Allahut, (a.s.), i cili ia ka shpjeguar këtij ummeti rrugën e drejtë me gjerësinë, gjithëpërfshirjen, drejtësinë dhe sigurinë e saj, ka thënë: *“Hiqani kokën kujtdo që dëshiron t'i ndajë dhe përçajë punët e ecurinë e myslimanëve ndërkohë që (këta të fundit) jetojnë të bashkuar e në harmoni!”*<sup>1</sup> Në këtë mënyrë, i Dërguari i Allahut, (s.a.s.), e ka shpjeguar krejt qartë se çfarë krimi të madh bëjnë ata që dëshirojnë t'i përçajnë myslimanët për shkak të disa ndryshimeve të vogla në çështje detajore, ndërkohë që janë të një mendimi në çështjet themelore.

“Siratu'l-mustekim” është rruga e një ummeti larg ifratit dhe tefritit, domethënë është rruga e ummetit të Muhamedit (s.a.s.), dhe sahabëve të tij. “Ehlisunnet ve'l-xhemat” si pjesa kryesore e ummetit, përbëhet nga ata që ndjekin këtë rrugë.<sup>2</sup> Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik: *“(O ju që keni besuar!) Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kuranin) dhe mos u përçani!..”* (Allimran, 103.)

1. Muslim, Imare 59, 69; EbuDavud, Sunet, 27. (Hadithinr: 4762); Nesai, Tahrir, 6; AhmedibnHanbel, Musned, IV, 261, 341; V, 23.

2. Për fat të keq, në ditët e sotme shumë budallallëqe i atribuohen krejt lehtë “Ehlisunetit” dhe bëhen objekte ose të tregtisë, ose të politikës. Edhe ky është një shkak tjetër për përçarje.

*“Drejtjuni Atij me pendesë, frikësojuni Atij dhe falni namazin e mos u bëni si ata, që i shoqërojnë Atij diçka tjetër (në adhurim), si ata, që fenë e vet e kanë përçarë dhe janë ndarë në grupe, e ku çdo grup është i kënaqur me atë që ka.”* (Rum, 31-32.)

Ndërsa në një hadith fisnik sugjerohet kjo masë: *“...Kur të shohësh se çdokush pëlqen mendimin e vet, lëri njerëzit dhe përpiku të shpëtosh veten!”* (Tirmidhi, Tefsiru'l-Kur'an 6 (hadithinr: 3251); Bejhaki, Shuabu'l-Iman, VII, 127.)

Ky hadith fisnik tregon se njerëzve dhe shoqërive që përçahen, duke u kapluar nga sëmundja e konsiderimit të vetes në rrugë të drejtë, u shtohen tepër mundësitë për t'u larguar nga kjo rrugë. Për shkak të kësaj verbërie, bëhet shumë e vështirë edhe mundësia për t'i paralajmëruar, sepse të përpiqesh me njerëz të tillë është njëlloj si të tentosh

RRUGA E DREJTË ËSHTË NJË E VETME, ASNJËHERË NUK ËSHTË PENGESË QË GRUPET E NDRYSHME TË ECIN NË TË NJËJTËN RRUGË, SEPSE NË NJË RRUGË TË GJERË DIKUSH MUND TË ECË DJATHTAS, DIKUSH MUND TË ECË MAJTAS DHE DIKUSH TJETËR MUND TË ECË NË MES. NUK ËSHTË ASPAK NORMALE QË KËTO GRUPE TË ZIHEN, GRINDEN DHE PËRPLASEN ME NJËRI-TJETRIN, ME QËLLIM AFRIMIN E TË TJERËVE PRANË VETES.

të mjekosh një sëmundje të pashërueshme.

Allahu Teala thotë në Kuranin Fisnik: *“Këdo që e kundërshton të Dërguarin, pasi i është dhënë udhëzimi dhe ndjek rrugë tjetër nga ajo e besimtarëve, Ne e lëmë të ecë andej nga është nisur dhe do ta përcëllojmë në zjarrin e Xhehenemit; eh, sa vendbanim i keq që është ai!”* (Nisa, 115.)

Në fund të ndarjes në fraksione e në grupe dhe të pëlqimit të vetes, që në të vërtetë do të thotë përçarje në besim, vjen edhe konsiderimi i vetes apo i grupit si i pagabueshëm dhe i mbrojtur nga mëkatet. Një pohim i tillë rrallë herë shihet te prijësit e grupeve dhe shpesh herë te pasuesit e tyre. Ky lloj pohimi bëhet duke u mbështetur te dashuria ekstreme apo te interesi material.

Ndërsa Imam Shatibiu (v. 790/1388.), është shprehur: *“Kushdo që pohon se është i mbrojtur nga gabimet dhe mëkatet, ka vepruar si ai mash-*

truesi që pohon se është profet.”<sup>3</sup> Nisur nga kjo frazë mund të themi: “Ata që pohojnë me siguri se një person është i mbrojtur nga mëkatet, bien në pozitën e atyre që u kanë besuar pejgamberëve të pavërtetë.”

Të gjitha këto gjëra negative që u përpoqëm t'i radhisim deri këtu, zhdukin ndjenjat e durimit ndaj tjetrit, mirëkuptimin dhe tolerancën ndërmjet myslimanëve. Ata i bëjnë njerëzit të heqin dorë prej punës dhe të merren me gjëra boshe. Për shkak të tyre përhapen trazirat, prishet paqja dhe fillon anarkia, me plot kuptimin e fjalës. Pastaj humbet e vërteta dhe gradualisht fitojnë vlera personat dhe jo parimet.. Pastaj këta persona merren për shembull.

Ja pra, kur arrihet në këtë pikë, pranohet çdo mendim i personit që pëlqehet. Ndërsa ai që e kundërshton nuk merret në konsideratë edhe nëse është në të drejtë. Në këtë mënyrë, humbet e drejta. Pastaj del jashtë funksioni detyra “el-emrubi'l-ma'rufive'n-nehjuani'l-munkerit”. Ndërkohë, realiteti që nuk duhet harruar dhe që duhet të bëjmë kujdes ndaj tij është: “Pa e njohur të vërtetën nuk mund t'i njohim njerëzit që e pasojnë.” Për ta mësuar gjendjen e vërtetë të injorantëve apo të ekstremistëve që bëjnë komente të pabaza, pa metodologji dhe duke i kaluar të gjitha kufijtë në insistimin e tyre, edhe pse në pamjen e jashtme duken mjaft interesantë, së pari jemi të detyruar të njohim esencën/të vërtetën e vlerave, domethënë, të njohim vetë të vërtetën.

Në Kuranin Fisnik është dënuar ashpër sjellja e kontradiktave në fe, në masën që rrezikon të përçahet ummeti Islam. Zoti i Madhëruar thotë: **“Me të vërtetë, ti s'ke të bësh fare me ata që e përçajnë fenë e tyre dhe shndërrohen në sekte. Te Allahu është puna e tyre e pastaj Ai do t'u tregojë çfarë patën punuar.”** (En'am, 159.)

Shprehja “ata që e përçajnë fenë e tyre”, që përmendet në ajetin fisnik, së pari u drejtohet ehlikitabit (çifutëve e të krishterëve) dhe politeistëve që

ishin ndarë në shumë grupe të ndryshme besimi ndërmjet tyre. Krahas kësaj, mund të thuhet se ky ajet u drejtohet edhe myslimanëve që përpiqen t'i përshtatin dispozitat e fesë sipas dëshirave e interesave të tyre, që nuk i njohin apo i neglizhojnë disa dispozita të cilat nuk u leverdisin, që përpiqen të prishin fenë, që bëjnë përçarje duke përdorur ajetet fisnike sipas dëshirave të tyre personale dhe që përpiqen të përçajnë myslimanët e tjerë. Gjithashtu, në vazhdimin e ajetit fisnik theksohet mjaft qartë se ata që ndjekin prijës të ndryshëm dhe veprojnë në kundërshtim me bashkimin në fe (ata që shndërrohen në sekte), do të jenë larg edhe nga i Dërguari i Allahut, (s.a.s.). Padyshim se një përfundim i tillë do të sjellë humbje dhe shkatërrim të jashtëzakonshëm.

Në ditët e sotme, disa grupe fetare gjenden ballë për ballë, apo përfaqësojnë pikërisht këtë rrezik.

Kjo mund të kuptohet lehtë nga deklaratimet dhe pohimet e tyre, në të cilat shpaloset bindja se vetëm ata janë në rrugë të drejtë. Ndërkohë një situatë e tillë bëhet shkak për hapjen e plagëve të thella në ummet, për lindjen e përçarjeve, për copëtimin e unitetit të ummetit dhe për humbjen e ndikimit të vëllazërisë në besim, shkurtimisht, bëhet shkak për formimin e një mjedisi të përçarë dhe sundimin e këtij

të fundit. Dëmi që i shkaktohet ummetit nga një gjendje e tillë është aq i qartë saqë nuk ka nevojë për asnjë shpjegim.

Tashmë le ta përfundojmë shkrimin me disa vargje nga poezia e shkruar afërsisht njëqind vite më parë, nga poeti i ndjerë Mehmet Akif Ersoji:


Ndërkohë që Islami ju urdhëron të qëndroni të lidhur dhe të bashkuar,

Nuk e kuptoj dot nga ju hyri në tru ndjenja e ndarjes.

Mos vallë shejtani ua futi në mendje mendimin për nacionalizëm?

Sepse armiku nuk mund të hyjë te një popull pa hyrë përçarja.

Kur zemrat të jenë të bashkuara, nuk mund t'i mposhtin as topat, as murtaja.



3. Shatibi, I'tisam, II, 97.



# FAZIL MUSTAFA PASHA

KRYEVEZIRI QYPRILI I RËNË DËSHMOR

— Dr. Ardian Muhaj —

Fazil Mustafa Pasha (1637-1691) lindi në Köprü. Pas shkollimit në Stamboll në vitin 1659 hyri në radhët e rojeve të sulltanit në pallat. Pas vdekjes së të atit Mehmet Pashës (kryevezir në vitet 1656-1661) u angazhua përkrah të vëllait të tij më të madh kryevezirit Fazil Ahmet Pasha në shumë prej fushatave ushatarake të ndërmarra prej tij.<sup>1</sup> Në vitin 1680, kur kryevezir ishte kunati i tij Merzifonlu Mustafa Pasha, Fazil Mustafa Pasha u bë vezir i shtatë në këshillin ose divanin perandorak, pas suksesit të fushatës së Cehrinit kundër liderit kozak që kishte ngritur krye.<sup>2</sup> Besimi dhe vlerësimi për familjen e Qyprilinjve u shtua dhe Fazil Pasha u caktua në rangun e vezirit të gjashtë në shkurt 1681. Gradualisht përmes aftësive u ngrit deri në rangun e vezirit të tretë në 1683. Humbja e osmanëve në rrethimin e Vjenës solli si pasojë edhe rënien e kryevezirit dhe

kunatit të tij, që u ekzekutua në 25 dhjetor 1683. Bashkë me të edhe prestigji i Qyprilinjve u dëmtua. Pas riformatimit të politikës osmane që pasoi dëshkrimin e rrethimit të Vjenës në vitin 1683, Qyprilinjët u përballën me një armiqësi të hapur nga kryeveziri i ri Ibrahim Pasha. Situata ndryshoi në vitin 1687 kur në postin e kryevezirit erdhi dhëndri i familjes së Qyprilinjve Sijavush Pasha që u caktua kryevezir pas një rebelimi të ushtrisë që e detyroi Sulltan Mehmedin IV të braktiste fronin në favor të djalit të tij Sulltan Sulejmani II (1687-1691). Në ndryshimet që pasuan këtë riformatim Fazil Mustafa Pasha u emërua për pak kohë vezir i dytë dhe zëvendës i vezirit të madh.

Ndërkohë situata ndërkombëtare përkeqësohej dhe austriakët e venedikasit po depërtonin gjithnjë e më shumë në territoret osmane. Në frontin ballkanik osmanët për tri vite rresht pësuan humbje të vazhdueshme. Kryevezirët që erdhën pas dhëndrit të Qyprilinjve Merzifonlu Mustafa Pashës, Kara Ibrahim (16 dhjetor 1683) dhe Sulejman Pasha (dhjetor 1685) u rreguan të paaftë, por edhe të pakurajo duke

1. Fehmi Yilmaz, "The Life of Köprülüade Fazil Mustafa Pasha and his reforms (1637-1691)," *Osmanli arastirmalari*, nr. 20 (2000), f. 166.

2. Abdurrahman Abdi Pasa, *Vekayiname*, Edited by Fahri Çetin Derin, Istanbul Üniversitesi Sosyal Bilimler Enstitüsü, Istanbul 1993, f. 168-169;



refuzuar të viheshin në ballë të ushtrisë osmane dhe duke caktuar zëvendës. Kështu austriakët arritën të marrin Beogradin në 8 shtator 1688. Në tetor ata kishin mbërritë në Shkup dhe tashmë urgjenca e një kryeveziri të aftë e me autoritet bëhej çështje e pashmagshme. Në 9 nëntor 1689 Sulltan Sulejmani II mbajti një këshill me pjesmarrjen e Shejhulislamit dhe ylemave ku u vendos të thirrej në detyrën e kryevezirit Fazil Mustafa. Fazil Mustafa Pasha në këtë kohë ishte 52 vjeç dhe kishte një formim akademik të shëndoshë në dijet fetare dhe në punët e administratës, ashtu edhe përvojë të gjatë në fushëbeteja.

Duke qenë i ndërgjegjshëm se pa mbështetjen e shtresave të popullsisë nuk mund të kishte sukses rimarrja e pozicioneve në luftën me Lidhjen e Shenjtë, anuloi taksat e jashtëzakonshme të vendosura nga paraardhësit e tij gjatë luftës dhe u vu vetë në krye të ushtrisë osmane që u mbloodh gjatë gjithë pranverës së vitit 1690. Situata financiare ishte dëshpëruese. Kryevezirat paraardhës kishin vendosë taksa shtesë për financimin e luftës dhe kjo kishte ndikuar në animin e jomyslimanëve ndaj ushtrive të huaja. Kështu hoqi taksat e vendosura mbi nënshtetasit jomyslimanë si ajo mbi prodhuesit e verës e rakisë që mendohej se i kishte nxitur të bashkëpunonin me austriakët e venedikasit. Sipas Fazil Mustafa Pashës përderisa pijet alkoolike ishin të ndaluara për myslimanët atëherë edhe taksat e vjela prej tyre nuk mund të përdoreshin nga shteti osman. Kjo natyrisht shërbeu për rikthimin e besnikërisë së atyre që kishin bashkëpunuar.

Nga ana tjetër situata ushtarake ishte tragjike. Prandaj Fazil Mustafa Pasha ndërmoi një reformë të thellë në eltiën e ushtrisë duke zëvendësuar ose transferuar drejtuesit kryesorë. Përveç kësaj ai shpalli mobilizimin e përgjithshëm të të gjithë nënshtetasve osmanë për mbrojtjen e Islamit. Sipas fermanit thuhej se armiqtë po synonin të zhduknin fenë islame, prandaj duhej që ushtarët ashtu edhe rajaja të kontribuonin në mbrojtjen e shtetit. Ata që nuk mund të merrnin pjesë ushtarakisht, si të sëmurët dhe të moshuarit, duhej të ofronin ushqim për ushtrinë. Mobilizimi i përgjithshëm përfshiu edhe vilajetet detare të Algjerisë, Tripolit, Egjiptit e Tunizit.<sup>3</sup> Refugjatët ishin një problem shtesë. Shumë familje myslimane ishin detyruar të braktisin shtëpitë e tyre sidomos pas marrjes së Beogradit, Nishit dhe djegies së Shkupit nga austriakët. Ai dërgoi ushtrinë e Krimesë drejt Shkupit për të ndalur avancimin austriak dhe për të fituar kohë. Po ashtu në këtë front dërgoi edhe ushtrinë e Moresë nën komandën e Mahmud Pashës. Kjo masë rezultoi efikase, pasi ushtritë e Krimesë dhe të Moresë ia dolën që të rimarrin me sukses Shkupin, Kumanovën, Kaçanikun, Prizrenin, Prishtinën dhe Novobërdën, deri në afërsi të Nishit.

Në korrik 1690 gjithçka ishte gati për nisjen e fushatës. U vendos në këshillin e luftës që sulltani të qëndrojë në Stamboll ndërsa Fazil Mustafa Pasha do të udhëhiqte fushatën. Në 31 korrik ushtria osmane u prit me entuziazëm nga popullsia e Sofies që kishte qenë në panik. Më pas osmanët mbërritën në Nish më 16 gusht. Në kështjellë përveç ushtarëve hungarezë e austriakë ishin edhe 400 nënshtetas osmanë të konsideruar banditë nga osmanët, pasi kishin masakruar e persekutuar myslimanët e zonës. Fazil Mustafa Pasha u ofroi rrugëkalim të sigurtë vetëm ushtarëve austriakë e hungarezë në rast se dorëzonin kështjellën, por jo banditëve. Gjithsesi oferta u refuzua dhe rrethimi zgjati tri javë. Më 8 shtator osmanët ia dolën ta marrin Nishin dhe 6 mijë ushtarë austriakë e hungarezë u lejuan të largohen pasi u çarmatosën.<sup>4</sup> Këtë fat nuk e patën 400 banditët të cilët u ekzekutuan. Pas kësaj fitoreje Fazil Mustafa Pasha shpërndaui të holla për ushtrinë nga pasuria e tij. Fazil Pasha mbërriti në

3. F. Yilmaz, "The Life of Köprülüzade Fazil Mustafa Pasha," f. f. 178-187.

4. F. Yilmaz, "The Life of Köprülüzade Fazil Mustafa Pasha," f. f. 194-195.



afërsi të Beogradit në 1 tetor 1690. Pas një jave rrethim më 8 tetor një predhë osmane shkaktoi një zjarr në magazinën e barutit në kështjellë. Kjo shkaktoi demoralizimin e të rrethuarve dhe për pasojë 15 mijë ushtarë u vërsulën për të shpëtuar përmes Danubit e Savës me barka. Shumë prej tyre u mbytën, kurse një pjesë ia doli të shpëtojë. Kjo ishte fitorja më e madhe e Fazil Pashës. Sërish dhuroi të holla nga thesari i tij.

Ndërkohë duke përfitur nga largimi i forcave të Moresë drejt fushatës së Beogradit, venedikasin kishin ndërmarrë një sulm nga toka dhe deti dhe kishin marrë Kaninën dhe Vlorën. Fazil Mustafa Pasha e njihte aftësinë dhe fuqinë detare të venecianëve prandaj iu vu punës për forcimin e flotës. Reformoi zinxhirin drejtues dhe ndërmori ndërtimin e anijeve të reja. Fazil Mustafa Pasha ngarkoi bejlerbeun e Rumelisë Xhafer Pasha, atë Shkodrës Sulejman Pasha, dhe sanxhakbeun e Prizrenit e Dukagjinit Mahmud Pasha për fushatën e Vlorës. Këto forca nuk vonuan dhe ia dolën t'i marrin sërish Vlorën dhe Kaninën, edhe pse Kanina u hodh në erë me eksplozivë nga venedikasin para se të evakuohej prej tyre.

Gjatë pranverës së viti 1691 ai punoi pa pushim për të rregulluar dhe reformuar administratën e financat. Sulejmani II ishte i sëmurë dhe kandidatët për fron ishin Mustafai, i biri i Mehmetit IV dhe Ahmedi, vëllai Sulejmanit II. Edhe pse në këshillin perandorak Fazil Pasha kërkoi të mos marrë pjesë në fushatë, këshilli vendosi se prania e tij ishte e domosdoshme dhe ai pranoi. Megjithatë kërkoi që sulltani i sëmurë dhe princat të shkonin në Edirne dhe la porosi që në rast të vdekjes së Sulejmanit II të vinte në fron i vëllai Ahmedi. Kështu pas balancimit të buxhetit perandorak, në qershor 1691 u vu sërish në krye të ushtrisë për të vazhduar sukseset e arritura në fushatën e një viti më parë kundër austriakëve. Më 22 qershor ushtria mbërriti në Beograd dhe në 26 qershor u mor vesh se Sulejmani II kishte vdekur në 23 qershor dhe se Ahmedi II ishte fronëzuar po atë ditë sipas dëshirës dhe porosisë së kryeministrit. Guximi i tij që shkonte përkrah aftësive ushtarake e administrative dhe virtyeteve morale e fetare nuk e lejonte të qëndronte në prapavijë dhe si pasojë kur ndodhej në sheshin e betejës së Slankamenit në afërsi të Beogradit në 19 gusht 1691 u qëllua nga forcat kundërshtarë dhe vdiq në fushën e betejës. Kjo shkaktoi tërheqjen e osmanëve megjithëse humbjet ishin të njëjta për të dy palët. Trupi i Fazil Pashës të rënë në fushën e betejës nuk u gjet.

Edhe pse qëndroi në këtë detyrë për më pak se dy vite nga nëntori 1689 deri në gusht 1691 ai la një trashëgimi të sukseshme reformash dhe një tufë sukseshesh ushtarake që i rikthyen osmanët në pozitat e mëparshme, me përjashtim të Hungarisë. Nga reformat e tij që do të kishin pasoja pozitive në periudhat e mëvonshme ishte njëfarë decentralizimi apo delegimi i pushtetit tek oxhaqet e provincave, të cilat në këtë mënyrë e ndjenin më shumë përgjegjësinë e mbrojtjes së zonave përkatëse, pa pritur çdo gjë nga Stambolli. Po ashtu ndikoi në rritjen e efikasitetit të qeverisë qëndrore dhe hoqi traditën e kahershme që zyrtarët e lartë të shtetit t'i ofronin dhurata sulltanit gjatë festave fetare apo edhe kur merrnin një detyrë. Ishte i dhënë shumë pas diturive, veçanërisht pas dijeve fetare dhe gjuhësore. Njëri prej djemve të tij Numan Pasha (Köprülü Numan Pasha) gjithashtu arriti në rangun e kryeministrit në vitet 1710-1711.<sup>5</sup>

5. *Tarih-i Sütlale-i Köprülüzade, është burimi kryesor për historinë e familjes së Qyprilinjve.* Günhan Börekçi, "Fazil Mustafa Pasa," 1A; Caroline Finkel, *Osman's Dream: The Story of the Ottoman Empire, 1300-1923* (London: John Murray, 2005), f. 253-328; M. T. Gökbilgin and R. C. Repp, "Köprülü," In *Encyclopaedia of Islam*, 2nd ed., vol. 5, edited by C. E. Bosworth, E. van Donzel, B. Lewis, and Ch. Pellat (Leiden: Brill, 1960...), f. 256-263; Metin Kunt, "The Waqf as an Instrument of Public Policy: Notes on the Köprülü Family Endowments, in *Studies in Ottoman History: In Honor of Professor V.L. Ménage*, edited by Colin Heywood and Colin Imber (Istanbul 1994), f. 189-198; Metin Kunt, "Naima, Köprülü and the Grand Vizirate." *Bogaziçi Üniversitesi Dergisi 1* (1973), f. 57-62



# *Kuptimi i vëllazërisë* **NË BESIM**

— Nuredin Jëlldëz —

Shprehja: “Të dua!”, që një besimtar ia drejton bashkëshortes së tij, është krejt e natyrshme dhe nuk mund të kritikohet për sa i përket aspektit të të qenit hallall dhe me vend. Por nëse një bashkëshort i thotë me sinqeritet bashkëshortes së tij: “Të dua për hir të Allahut!”, fraza ka vlerë dhe dobi shumë herë më të madhe.

Në të njëjtën mënyrë, nëse njeriu i thotë fëmijës së tij: “Të dua fort!”, padyshim i ka thënë njërën prej fjalëve më të ëmbla dhe më të natyrshme. Por nëse i thotë: “Të dua për hir të Allahut!”, atëherë kjo është një frazë e përkryer, vlere e së cilës nuk ka të krahasuar. Një frazë e tillë sjell një rezultat të mrekullueshëm, që i ngjan bashkimit të argjendit me floririn. Kjo frazë nënkupton: “Ju për mua jeni nën

Përderisa tregtia, vizitat e thjeshta e të ndërsjella dhe përsëritjet reciproke të bëhen me cilësitë e besimtarit, do të mbartin rëndësinë e veprave që ia vlen të shënohen nga engjëjt për ne. Allahu i madhëruar, siç dëshiron të na shikojë duke bërë sexhde para Tij nëpër xhami, dëshiron të na shikojë edhe si vëllezër që gjenden nën çadrën e besimit.




sigurinë dhe garancinë e Allahut. Unë ashtu ju shoh. Ta dini këtë!” Prej kësaj shprehjeje mund të dallohet lehtë ndryshimi dhe epërsia ndërmjet fëmijës që gjendet nën garancinë e një të përkohshmi dhe fëmijës që gjendet nën garancinë e Allahut Teala. Tashmë ky baba, kjo nënë dhe ky fëmijë kanë krejt tjetër pozicionim.

Pesha e rëndë të shprehjes “për hir të Allahut”, nuk është e nevojshme t’i shpjegohet një njeriu besimtar. Çfarëdo rëndësie që të ketë fjala Allah për të, të njëjtin kuptim mbart edhe shprehja “për hir të Allahut”. Kjo frazë është shumë më e thellë sesa thjesht një lëvizje e buzëve.

Nënat dhe baballarët duhet ta rrisin interesimin për fëmijët e tyre në gradën “për hir të Allahut”. Robërit e Allahut Teala duhet të posedojnë perceptimin që e bën çadër kënaqësinë e Zotit (xh. xh.), i Cili i ka krijuar dhe u ka dhënë jetë atyre, brenda një lidhjeje prindër/fëmijë Kur fëmijët ta lartësojnë të folurit e tyre kundrejt baballarëve dhe nënave, në shkallën “për hir të Allahut”, do të shfaqin profilin e njeriut besimtar që lartësohet sikur të jetë duke u ngritur në miraxh. Fëmijët e këtyre nënave dhe baballarëve nesër, me lejen e Allahut, do të jenë prej robërve të mbështetur nëpër kolltukë të Xhenetit dhe notues në mirësitë e tij, pasi do t’i kenë harruar të gjitha vuajtjet që kanë përjetuar në këtë botë provizore.

Nënshtrimin ndaj Allahut (xh. xh.), jemi të detyruar ta njësojmë me të jetuarit si i ka hije një myslimani dhe si një brez i mësuar me edukatën e të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Nëse morali ynë do ta ketë burimin te feja, atëherë ky është vërtetë morali. Nëse do të presim shpërblim për moralin tonë, atëherë dijeni se ka rregulla për pritjen e shpërblimit. Kryerjen e çdo gjëje “për hir të Allahut” duhet ta reflektojmë te marrëdhëniet bashkëshortore, kundrejt fëmijëve, prindërve dhe qëndrimeve tona. Nëse do të veprojmë kështu, atëherë nuk do të kemi nevojë të shqetësohemi për masën e përmbushjes së brendësisë së shprehjes “për hir të Allahut”, e cila duket si e lehtë veç në të thënë, por në fakt, aq sa e mbushim brendësinë e “Allahu Ekber-it” kur bëjmë dhikër, dhe aq sa e reflektojmë në jetën e përditshme përmbajtjen e tesbihëve, aq të mirëfillta do t’i kemi edhe marrëdhëniet me Zotin (xh.sh.).



Gradën sublime “të dua për hir të Allahut”, që kërkohet ta arrijmë me pjesëtarët e familjes, duhet ta arrijmë edhe me vëllezërit besimtarë me të cilët falim namaz në xhami. Nevojitet të shqetësohemi seriozisht për t’ia dhënë hakun kësaj fraze. A nuk është ndjesia “për hir të Allahut” dallimi i qartë ndërmjet atyre që e bëjnë për sy e faqe dhe atyre që e bëjnë me sinqeritet vizitën ndaj të afërmeve? Vizitën e hallës, puthjen e dorës së tezes etj, mund t’i shndërrojmë në vepra që na afrojnë te Allahu i Lartësuar, por mund t’i lëmë edhe në gradën e traditës. Kultura e Medinës na urdhëron që puthjen e dorës së dikujt më të madh, vizitën e një të sëmuri, dhënien e një lëmoshe, buzëqeshjen dhe të gjitha veprimet që i bashkojnë njerëzit, t’i shndërrojmë në vepra të cilat do t’i gjejmë si sevape kur të dalim në audiencën e Allahut Teala, ose edhe si ibadet.

Përderisa tregtia, vizitat e thjeshta e të ndër-sjella dhe përhëndetjet reciproke të bëhen me cilësitë e besimtarit, do të mbartin rëndësinë e veprave që ia vlen të shënohen nga engjëjt për ne. Allahu i madhëruar, siç dëshiron të na shikojë duke bërë sexhde para Tij nëpër xhami, dëshiron të na shikojë edhe si vëllezër që gjenden nën çadrën e besimit. Aq sa na kërkohet që ta shfaqim nënshtrimin ndaj Zotit (xh.sh.), duke e vendosur ballin në tokë, aq duhet t’i kryejmë edhe detyrat e vëllazërisë, në mënyrë që të formojmë një shoqëri besimtare. Ajetet që na urdhërojnë të falim namaz në xhami, janë po ato ajete që formojnë kornizën e vëllazërisë. Ja, ky është nënshtrimi ndaj Allahut (xh.sh.). Ky është adhurimi ndaj Allahut Teala, edhe pse mund t’i duket i vështirë nefsit. Këto janë detyra krejt të natyrshme për të qenë besimtar.

Identiteti ynë na detyron të bëjmë tavaf rreth Qabesë, por ne duhet të jemi po të njejtët kur japim lëmoshë, kur buzëqeshim dhe kur lutemi pranë të sëmurit. Kur bashkëshortët të shfaqin dashurinë kundrejt njëri-tjetrit në shtëpi, janë të detyruar që këtë dashuri ta fusin nën çadrën e shprehjes “për hir të Allahut”. Kjo pra është familja besimtare. Edhe shoqëria besimtare është ajo shoqëri që formohet nga familje të tilla.

A nuk na urdhëron Zoti (xh.xh.), që të bëhemi një shoqëri e tillë?!



# Ajetet e lutjeve në Kuranin Fisnik

— Xhafer Durmush —

Lutja është lidhja që formohet ndërmjet Krijuesit të Lartësuar dhe njeriut. Ajo është lidhja që i mundëson njeriut që të njohë dobësinë e tij, duke ndjerë madhësh-tinë, dhembshurinë dhe mëshirën e Allahut (xh.xh.). Kur Imam Raziu e shpjegon ajetin fisnik, në të cilin thuhet: **“...Zoti im nuk do t’ju përfillte, sikur të mos ishte lutja juaj...”**<sup>1</sup>, shprehet: “Njeriu fiton vlerë në sajë të drejtimit me dëshirë dhe modesti ndaj Allahut, duke e perceptuar dobësinë e vet.” Për këtë arsye, është thënë: “Në lutje nuk ka ndërmjetës midis Allahut dhe robit. Lutja është pozita më e lartë e nënshtrimit ndaj Zotit (xh.xh.).”

Në Kuranin Fisnik ka afërsisht 200 ajete që flasin në lidhje me lutjen. Në një pjesë prej këtyre ajeteve njerëzit urdhërohen që t’i bëjnë lutje Zotit (xh. xh.), ndërsa në një pjesë tjetër të tyre flitet rreth rregullave, edukatës dhe ndikimeve të lutjes. Mbi të gjitha, u jepet vend edhe shprehjeve shembull, të cilat janë prej lutjeve të peygamberëve dhe të njerëzve të devotshëm. Pra, aty jepen lutje nga Isai (a.s.), Musai (a.s.), Ibrahim (a.s.) dhe Nuhu (a.s.). Gjithashtu, në Kuran jepen edhe shembuj nga lutjet e Ademit (a.s.), Shuajbit (a.s.), Junusit (a.s.), Jusufit (a.s.), Ejubit (a.s.) dhe Sulejmanit (a.s.). Krahas këtyre, disa sure dhe ajete kanë natyrën e teksteve shembull për lutje.<sup>2</sup> Për shembull, te surja Fatiha, pasi lavdërohet dhe falënderohet Allahu Teala me një metodë përmbledhëse, na mësohet sinqeriteti në lutje dhe nënshtrim ndaj Zotit (xh.xh.), dhe metoda më e dëlirë e e bukur për të shprehur dëshirën që të arrijmë udhëzimin. Edhe këto vargje nga surja Bekara: **“...Zoti ynë, na jep të mira në këtë botë, na jep të mira në botën tjetër dhe na ruaj nga dënimi i Zjarrit (të Xhehenemit)!..”** (Bekare, 201), sigurisht që janë ajetet që këndohen më së shumti

pas Fatihasë. Enes ibn Maliku (r.a.), na ka transmetuar se i Dërguari i Allahut, (a.s.), përgjatë lutjeve të tij, më së shumti ka pas lexuar këto ajete. Gjithashtu, Enes ibn Maliku (r.a.), na ka transmetuar se i Dërguari i Allahut (a.s.), na ka këshilluar edhe ne që t’i këndojmë këto ajete gjatë lutjeve tona.<sup>3</sup> Imam Muslimi ka hapur një kapitull të veçantë në lidhje me mirësinë e lutjeve së bashku me këto ajete të bekuara. Po ashtu, edhe ajeti i fundit i sures Bakara: **“...Zoti ynë, mos na ndëshko për atë që harrojmë ose veprojmë pa qëllim! Zoti ynë, mos na ngarko barrë të rëndë, ashtu si i ngarkove ata para nesh! Zoti ynë, mos na ngarko me diçka që nuk mund ta bartim! Na i shlyej gjynahet tona, na i fal ato dhe na mëshiro! Ti je Zoti Ynë! Prandaj na jep fitore kundër atyre që nuk besojnë!”** (Bekare, 286), është një prej ajeteve të lutjeve që këndohet më së shumti. Më poshtë po radhisim edhe disa ajete të tjera lutjesh që mund t’i mësojmë lehtë përmendësh dhe mund t’i kuptojmë pa ndonjë vështirësi:

**“...Zoti ynë! Me të vërtetë kemi besuar, andaj na i fal gjynahet tona dhe na ruaj nga dënimi i zjarrit!”** (Al Imran, 16)

**“O Zoti Ynë! Na e jep shpërblimin që na ke premtuar nëpërmjet të dërguarve të Tu dhe mos na poshtëro në Ditën e Kiametit! Se Ti, me të vërtetë, nuk e shkel premtimin e dhënë!”** (Al Imran, 194)

**“O Zoti ynë! Mos lejo që zemrat tona të shman-gen (nga e vërteta), pasi na ke udhëzuar në rrugën e drejtë, dhe jepna mëshirë prej Teje; vërtet, Ti je Dhuruesi i Madh!”** (Al Imran, 8)

**“O Zoti ynë, dhurona nga gratë tona dhe trashëgimtarët tanë, ç’është prehe për sytë tanë dhe bëna shembull për të mirët!”** (Furkan, 74)

**“O Zoti im, bëj që unë dhe pasardhësit e mi të kryejmë përherë namazin! O Zoti ynë, na i prano lutjet! O Zoti ynë, më fal mua, prindërit e mi dhe**

**besimtarët në Ditën, kur do të jepet llogari!”** (Ibrahim, 40-41)

Siç vihet re, në këto ajete gjenden falënderimet dhe lavdërimet më të bukura për Allahun (xh. xh.). Gjithashtu, në këto ajete gjendet edhe përmbledhja e mirësive që duhet të kërkojmë, në lidhje me këtë botë dhe botën e përtejme. Ndërkohë, aty jepet edhe përmbledhja e të këqijave prej të cilave duhet t'i kërkojmë mbrojtje Zotit (xh.xh.), për sa i përket kësaj bote dhe Ahiretit. Domethënë se ne duhet t'i përgjrohemi Allahut Teala me këto lutje, apo me lutje të tjera të ngjashme. Krahas këtyre ajeteve, edhe fjalët që i atribuohen Ejubit (a.s.), dhe të cilat gjenden ndërmjet ajeteve të lutjeve në Kuranin Fisnik, zënë një vend të veçantë, sepse ai edhe pse ishte kapluar nga një sëmundje e rëndë dhe po përjetonte fatkeqësi të mëdha, kurrë nuk u ankua dhe nuk i kërkoi asgjë Allahut (xh. xh.). Ai u mjaftua vetëm duke i shprehur Zotit gjendjen e tij: **“... Mua më ka kapluar fatkeqësia. Ndërsa Ti je më mëshiruesi i mëshiruesve!”** (Enbija, 83)

Lutjet zënë një vend të rëndësishëm edhe në hadithet e të Dërguarit të Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, sepse ai siç bënte lutje në kohën e Xhumasë, natën e Kadrit, pas namazit, ndërmjet ezanit e ikametit dhe në kohë të caktuara përgjatë ditës, lutej edhe kur fillonte namazin, kur merrte abdest, kur hynte në shtrat, kur zgjohej nga gjumi dhe kur dilte në udhëtim, domethënë, lutej kur fillonte çdo gjë dhe e falënderonte Allahun (xh.xh.), kur i mbaronte ato.

Bazuar në këto që thamë më sipër, ne duhet të lexojmë Fjalën e Allahut Teala (Kuranin), në mënyrë që t'i përforcojmë lutjet me ajete fisnike. Gjithashtu, duhet të lexojmë edhe kapitujt e lutjeve që janë vendosur në mënyrë specifike në koleksionet e hadithit, që lutjet t'i ekuilibrojmë me fjalët e bekuara të të Dërguarit të Allahut, (s.a.s.). Ndërsa, për t'i përforcuar edhe më tepër lutjet, duhet të kër-

kojmë edhe ndër librat që kanë shkruar njerëzit e devotshëm, sepse lutja dhe ibadeti janë esenca e nënshtrimit tonë ndaj Allahut (xh. xh.), pra janë qëllimi i krijimit tonë.<sup>4</sup>

Allahu i Lartësuar, i Cili i inkurajon robërit e Tij për të bërë lutje, duke u shprehur: **“Lutmëni mua, në mënyrë që t'i përgjigjem lutjes suaj!..”**, bën edhe këtë paralajmërim: **“...Me të vërtetë, ata që tregohen mendjemëdhenj e nuk duan të më adhurojnë, do të hyjnë në Xhehenem të poshtëruar!”** (Gafir, 60) Allahu Teala ka dhënë modelet e lutjeve më të bukura në Kuranin Fisnik. Në këtë mënyrë na inkurajon që gjuhën tonë ta ushtrojmë me lutje të pranueshme. Ndërsa Pejgamberi (a.s.), që thotë: **“Lutja është esenca e adhurimit.”**<sup>5</sup>, na mëson se si duhet t'i vëmë në praktikë këto lutje. Ne duhet të fillojmë duat me ajetet e lutjeve, në mënyrë që Fjalën e Allahut ta përsërisim sa më shpesh.

**Referencat:** 1. Furkan, 77. / 2. Mustafa Çagrixhi, Enciklopedia Islame e Entit për Çështjet Fetare të Republikës së Turqisë, neni i lutjes, fq. 536. / 3. Buhari, Deavat, 55. / 4. Shik. Surja Dharijat, 56. / 5. Tirmidhi, Deavat, 1.



## Shkaku për t'u përgëzuar me Xhenet

Në suren Shuara thuhet: **“Në Ditën, kur askujt nuk do t'i bëjë dobi as pasuria, as fëmijët, përveç atij që vjen me zemër të pastër tek Allahu!”**, **“Atë ditë Xheneti do t'u afrohet besimtarëve të devotshëm, ndërsa Xhehenemi do t'u tregohet atyre që kishin humbur.”** (Shuara, 88-91)

Termi “Kalbun Selim” që përmendet në ajet dhe për të cilën njoftohemi se ka një vlerë të madhe te Allahu Teala, nënkupton një zemër që është pastruar nga dyshimet e shirkut dhe që ka besuar me sinqeritet. Said ibn Musejebi (r.a.), thotë: “Kalbun Selim është zemra e dëlirur. Ajo është zemra e besimtarit.”

Ky transmetim e shpjegon në formën më të bukur ajetin fisnik që përbën temën tonë: Nganjëherë, i Dërguari i Allahut, (s.a.s.), jepte lajme për gjendjet e veçanta të disa njerëzve. Në këtë kontekst, një ditë tha: **“Njeriu që do të hyjë brenda nga kjo derë, është prej banorëve të Xhenetit.”** Pikërisht në ato momente, brenda hyri Abdullah ibn Selam (r.a.). Sahabët e nderuar u mblodhën te ai dhe e njoftuan për situatën. Pastaj i thanë: **“A mund të na tregosh për veprën në lidhje me të cilën shpreson më shumë që do shpërblehesh nga Allahu, në mënyrë që ta kryejmë edhe ne?”** Abdullahu (r.a.), u tha: **“Unë kam vepra të pakta. Ndërsa gjëja për të cilën shpresoj nga Allahu është pastërtia e zemrës. Unë qëndroj larg fjalëve dhe veprave boshe dhe të padobishme.”**<sup>1</sup>

Ka shumë vepra që e bëjnë vepruesin e tyre të fitojë kënaqësinë e Allahut (xh.sh.) dhe si rezultat, të përgëzohet me Xhenet. Njëra prej këtyre, ndoshta më e rëndësishmja është “kalbun selim”, pra të pasurit e një zemre të dëlirë dhe të pastër prej gjërave boshe dhe të padobishme, një zemër aq të gjerë, që kërkon mirësi për të gjithë, duke pajisur personin me cilësi të bukura.

Prandaj, ne duhet t'i kryejmë veprat me pastërti, në mënyrë që të shpresojmë.

1. Ruhu'l-Bejan, Përkthimi dhe Komentimi i Kuranit, Botimet Erkam, vëll. 14, fq. 87.

# AKUMULIMI I SEVAPEVE

*nga e sotmja për të nesërmen*

— Raif Koçak —



Njeriu i shekullit tonë tashmë nuk hedh asnjë hap pa marrë shpërblim për të. Sado e vogël të jetë ajo që mund të japë, patjetër kërkon ta shndërrojë në interes dhe fitim. Mendimet moderne e kanë drejtuar njeriun deri në gjendjen që të zvarritet në batakun e kamatës, e cila është e ndaluar në fe, për të plotësuar nevojat, ngaqë nuk mund të marrë ndihmë materiale nga të afërmit, nëse e kërkon.

Ajo që nuk mundet ta pranojë në asnjë mënyrë mendja e njeriut modern, është dhënia apo dhurimi, pa pritur shpërblim. Sipas mendjes moderne, nëse investoni njëqind mijë lekë diku, patjetër duhet të fitoni dyqind mijë lekë nga ky investim. Nëse jepni ndonjë gjë pa pritur shpërblim apo pa siguruar ndonjë interes material, konsideroheni budalla sipas shoqërisë moderne.

Gjërat për të cilat folëm janë produkt i një botë-kuptimi, i cili asnjëherë nuk mund të përputhet me mendimet tona. Feja islame, në të cilën mendohet vëllai para vetes dhe ndihma reciproke e solidariteti konsiderohen ibadet, përbën një institucion krejt të ndryshëm nga ai “moderni” që sqaruam më lart. Ky është institucioni i “infakut” që do të thotë: “Të harxhosh në rrugë të Allahut (xh.xh.), të ushqesh dikë dhe t’i japësh diçka për të vazhduar jetesën.”

Sipas Islamit, e gjithë pasuria që gjendet në këtë botë, i përket Allahut (xh.sh.). Njeriu jeton në këtë botë, i përdor këto pasuri, i harxhon ato për të jetuar dhe pasi t’i mbarojë jeta kalon në botën e përtejme, duke ia lënë radhën në përdorim dikujt tjetër. Disa prej njerëzve iu është dhënë pasuri, disa janë lënë në varfëri, disa janë krijuar të shëndetshëm dhe disa të tjerë janë të sëmurë apo me të meta. Domethënë, njerëzit si domosdoshmëri e natyrshmërisë së tyre, janë krijuar nevojtarë për njëri-tjetrin.

Njerëzit sprovohen me dije, shëndet, pasuri, mundësi të mëdha, fëmijë dhe familje. Njeriu që është bekuar me pasuri, është ballë për ballë me sprovën e ndarjes së saj me të tjerët. Ndërsa njeriu që nuk është begatuar me të, është ballë për ballë me sprovën për të siguruar jetesën duke punuar dhe duruar. Allahu Teala na urdhëron që këto mirësi t’i ndajmë me nevojtarët dhe ata që kemi nën përkujdesje, duke u shprehur:

**“O ju që keni besuar! Jepni pa u kursyer nga të mirat që ju kemi dhënë Ne, para se të vijë Dita (e Gjykimit) në të cilën nuk ka shit-blerje, as miqësi, as ndërmjetësi!..”** (Bakara, 254.)

**“O ju që keni besuar! Jepni pa u kursyer nga të mirat që keni fituar dhe nga ato që jua kemi nxjerrë Ne nga frytet e tokës. Mos dhuroni nga ato gjëra të pavlefshme të pasurisë suaj e të cilat ju nuk do t’i pranoni ndryshe veçse symbyllur. Ta dini se Allahu është i Vetëmjaftueshëm dhe i Denjë për çdo lëvdatë.”** (Bakara, 267.)

Kjo botë është fusha e sprovës. Në botën tjetër nuk mundemi të marrim me vete asgjë. Atje mund të shkojmë vetëm me veprat që kemi kryer në këtë botë. Gjithçka që posedojmë në këtë botë, do t’u



ngelet trashëgimtarëve tanë, kur të ndërrojmë jetë. Njerëzit e urtë kanë thënë: “Kur njeriu të vdesë, do të përballet me dy fatkeqësi, për sa i përket pasurisë. Robi asnjëherë nuk ka parë fatkeqësi të tilla. Fatkeqësia e parë është marrja e të gjithë pasurisë. Ndërsa fatkeqësia e dytë është marrja në llogari për pasurinë, edhe pse ajo i merret e tëra.”

Ndërsa i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, për të shprehur mirësinë e dhënies për hir të Allahut, ka thënë: “Çdo mëngjes zbresin dy engjëj. Njëri prej tyre lutet duke thënë: O Zot! Jepi atij që jep në emrin Tënd! Ndërsa tjetri lutet duke thënë: O Zot! Shkatërroja pasurinë atij që është koprrac!” (Buhari, Zekat, 27; Muslim, Zekat, 57.)

Nëse do t’i hedhim një vështrim natyrës, do të vërejmë qindra shembuj për mirësitë që na janë dhënë. Madje na janë dhënë mirësi më shumë seç kemi nevojë. Bletët bëjnë mjaltë më shumë seç kanë nevojë dhe na e japin ne. Pemët na japin fruta pa masë. Ndërkohë që për mbirjen e një fidani, mjafton edhe një farë e vetme.

Për pranimin e infakut, që është një adhurim financiar, ka disa kushte të vendosura nga Islami:

1. Infaku duhet të bëhet për kënaqësinë e Allahut të Lartësuar.

2. Pasuria që do të bëhet infak, duhet të jetë e fituar me mënyrë të lejuar.

3. Pasuria që do të bëhet infak, duhet të jetë prej pjesës më të mirë.

4. Njeriu që do të bëjë infak, duhet ta dije se në pasurinë që posedon kanë të drejtë edhe shoqëria, sidomos të varfrit. Prandaj, nuk duhet t’i mburret askujt.

5. Nevojtarëve duhet t’u jepet infakunë kohën e nevojës.

6. Infaku duhet të bëhet kur njeriu të jetë mirë me shëndet.

7. Infaku duhet të bëhet sipas mundësisë.

8. Infaku duhet të bëhet fshehurazi.

9. Në infak nuk duhet të ketë nxitim.

10. Prej infakut nuk duhet të pritët shpërblim.

11. Infaku nuk duhet të kthehet mbrapa.

12. Infaku duhet të bëhet duke përmendur emrin e Allahut Teala dhe t’i jepet atij që e kërkon. (Morali i Lartë Islam, Mustafa Bilgen, fq. 353-354.)

Nëse do t’u hedhim një vështrim periudhave kur institucioni i infakut ka funksionuar me plot kuptimin e fjalës, në civilizimin Islam, do të vëmë re ndihmë të ndërsjelltë dhe solidaritet të shkëlqyer ndërmjet njerëzve në shoqëri. Shumë vepra si xhamitë, medresetë, urat, shtëpitë për të pastrehët, mensat, çezmat dhe kanalet vaditëse, që i kanë ndërtuar gjyshërit tanë dhe që ne nuk mund t’i numërojmë dot, vëmë re se janë bërë prej kulturës së infakut. Në të njëjtën kohë, këto vepra që konsiderohen “sadakaton xharijeh/lëmoshë e vazhdueshme”, e vazhdojnë shërbimin e tyre edhe pasi ndërtuesit e tyre ndërrojnë jetë. Në këtë mënyrë, bëhen shkak për shkrimin e sevapeve vazhdimisht në librin e veprave të tyre.

Kur bëjmë infak, numri nuk ka shumë rëndësi. Nëse ka nijet të mirë ai që e bën infakun, shpesh herë ky infak ua kalon veprave që mund të jenë shumë më të mëdha. Për sa i përket kësaj çështjeje, i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: “Një dirhem i ka kaluar njëqind dirhemë.” Kur sahabët e nderuar e pyetën: “Si ka mundësi, o i Dërguari i Allahut?” Pejgamberi (a.s.) iu dha këtë përgjigje: “Një burrë kishte dy dirhemë. Njërin prej këtyre, që ishte më i mirë, e dha për hir të Allahut. (Dome thënë dhuroi gjysmën e pasurisë së tij.) Ndërsa (burri tjetër ishte shumë i pasur). Ai shkoi te pasuria, mori njëqind dirhemë dhe

i dhuroi për hir të Allahut.” (Nesai, Zekat, 49.)

Besimtari, qoftë i pasur apo i varfër, bën nijet në një formë të sinqertë për çdo gjë. Nëse dëshiron, pa tjetër që mund të gjejë diçka për ta dhënë në emër të Allahut Teala. Bazuar në mundësitë që ka, ai mund të bëjë infak nga pasuria, koha, fuqia, dija, aftësia, arti, gjuha, zemra dhe lutjet e tij. Njeriu nuk duhet të harrojë se çdo infak i bërë për hir të Allahut (xh. sh.), në Ahiret do të jetë ushqimi/sevapi ynë dhe do t’i shërbejë lumturisë sonë të përhershme.

Paqja e Zotit qoftë mbi ata që akumulojnë ushqime/sevape nga ditët e sotme për të nesërmen, duke e bërë natën ditë!

“Çdo mëngjes zbresin dy engjëj. Njëri prej tyre lutet duke thënë: O Zot! Jepi atij që jep në emrin Tënd! Ndërsa tjetri lutet duke thënë: O Zot! Shkatërroja pasurinë atij që është koprrac!”

(Buhari, Zekat, 27; Muslim, Zekat, 57.)





## Veprat që e zbukurojnë fytyrën

— Xhemal Nar —

Ka disa vepra që ua ndriçojnë, zbukurojnë dhe shkëlqejnë fytyrat besimtarëve. Këto vepra i shfaqin ata të këndshëm edhe kur plaken. Vazhdimisht shohim fytyra të tilla ndërmjet të moshuarve. Kur i shohim këto fytyra, nuk ngopemi dot me ta. Ndërsa në fytyrat e atyre që janë të privuar prej këtyre veprave, shohim një ftohtësi që e largon dhe e frikëson njeriun. Këta persona përshkruhen si “mëkatarë të mëdhenj”. Në përgjithësi jobesimtarët kanë fytyrat e tilla.

Cilat janë këto vepra?

Para së gjithash vjen besimi. Besimi e zbukuron fytyrën, po aq sa i jep prehje edhe zemrës. Besimi i ndriçon dhe i shkëlqen fytyrat. Këtë ndriçim mund ta shohim edhe te ndonjë vëlla i yni me ngjyrë.

Pastaj vjen abdesti. Ne i lajmë disa herë në ditë pjesët e caktuara të trupit për të marrë abdest. Marrja e abdestit i ndriçon këto pjesë të trupit. Në botën tjetër kjo dritë do të shihet qartazi. Ndërsa në këtë botë shohim qartë vetëm reflektimin e saj nëpër fytyra.

Edhe adhurimi përgjatë natës e ndriçon fytyrën. Veçanërisht zgjimi në kohën para agimit, marrja e abdest në atë kohë, falja e dy, katër apo tetë rekateteve, pendimi dhe kërkimi i faljes nga Allahu Teala, e ndriçojnë fytyrën. Gjithashtu, qoftë përmendja e Allahut dhe adhurimi i Tij, apo qoftë edhe ndikimi i azotit dhe energjisë që përhapet veçanërisht natën

në sipërfaqen e tokës, e ndriçojnë shumë fytyrën. Me të vërtetë këtë dritë arrijmë ta shohim në fytyrat e robërve që e përmendin Allahun duke falur namaz natën.

Leximi i Kuranit Fisnik dhe i haditheve të të Dërguarit të Allahut, (s.a.s.), mësimi përmendësh i tyre dhe transmetimi te njerëzit e tjerë, janë prej veprave të mira që i japin dritë, hijeshi dhe bukuri fytyrës. Bazuar në përvojë, këtë dritë mund ta shohim në fytyrën e dijetarëve të hadithit. Sigurisht që shenja më e madhe e dijetarëve të hadithit është mësimi përmendësh i haditheve. Normalisht çdo besimtar duhet të mësojë përmendësh dyzet hadithe qoftë edhe me kuptimin e tyre, por sa më shumë që të shtohen hadithet përmendësh, aq më shumë shtohet edhe ndikimi.

Në fytyrat e atyre që mbrojnë organet nga mëkatet, me në krye sytë, ka një perde të ndritshme turpi. Kushdo që e posedon atë perde, ka një fytyrë shumë të ëmbël. Ndërsa grisja e perdes së turpit sjell shfaqjen e disa errësirave në fytyrë. Prandaj, këtë duhet t’ua mësojmë në kohë të rinjve tanë. Përndryshe, nëse grisjet perda e turpit, është tejet e vështirë për t’u riparuar.

Ja pra, këto janë makijazhet shpirtërore të myslimanëve, të cilat ua ndriçojnë fytyrat besimtarëve dhe ua bëjnë të dashura e të këndshme. Sa mirësi të mëdha janë këto! Duhet të përkujdesemi fort që t’i mbrojmë dhe t’i shtojmë këto mirësi.



# Sekreti i suksesit të vezirit

— Ferudun Ozdemir —

Një ditë Sulltan Javuz Selimi mblodhi të gjithë vezirët e tij me qëllim që të përcaktonte si “kryevezir” atë që do të përmbushte dëshirën e tij duke u kërkuar:

“Më sillni një unazë të tillë që kur ta shohë një njeri i trishtuar të lumturohet. Po ashtu kur ta shohë një njeri i lumtur, ta humbasë lumturinë.”

Pasi dëgjuan kërkesën e Sulltanit, të gjithë vezirët iu vunë punës. Dolën në tregje e pazare, pyetën e kërkuan rreth e rrotull. Koha kaloi dhe erdhi vakti për t’u përgjigjur para sulltanit. Kështu vezirët dolën para tij me unazat e përgatitura dhe nisën t’i përshkruajnë. Gëzimi i Sulltan Javuz Selimit lexohej lehtë në fytyrë...

Unazën e përgatitur nga çdo vezir, Sulltani fillimisht e vendosi në dorën e një të varfri, i cili u lumturua nga ky vlerësim. Më pas të njëjtat unaza Sulltani i vendosi edhe në dorën e tij, por nuk u pa ndonjë ndryshim në gjendjen e tij emocionale.

Koha kaloi dhe teksa një nga vezirët vendosi në dorën e tij një tjetër unazë, papritmas lumturia në fytyrën e Sulltan Selimit u zhduk. Provuan t’ia vinin të njëjtën unazë një të varfri por gjendja e tij nuk ndryshoi, ishte përsëri i qeshur dhe lumturia e tij lexohej lehtësisht.

Pas kësaj, Sulltan Selimi pa humbur kohë e shpalli atë kryevezir. Të habitur nga kjo gjendje, vezirët e tjerë vrapuan ta pyesnin kryevezirin si e arriti këtë sukses:

“Ç’ishte ajo unazë që papritmas rrëmbeu lumturinë e Sulltanit? Si është e mundur që e njëjta unazë e lumturoi pafundësisht të varfrin e gjojë?”

Kryeveziri u përgjigj me delikatesë:

“Krejt e thjeshtë! Një ditë teksa po shëtisja i lumtur në treg një njeri asket ma preu rrugën dhe më vështroi me një shikim të mprehtë. Më pas me një ton qortues më tha:

**“Edhe kjo shkon e vjen!”**

Kur i dëgjova këto fjalë papritmas u mërzita, u trishtova. Ndërsa një lypsar që po qëndronte diku në qoshe të rrugës, pasi na dëgjoi, i qeshi fytyra, u gëzua, u lumturua...

Aty e kuptova që ishte kjo ajo që po kërkoja, prandaj menjëherë e shkrova këtë shprehje në unazën që i dhashë sulltanit. Kështu, sapo e vendosi në dorë, lexoi shkrimin: **“Edhe kjo shkon e vjen!”** dhe gëzimi u venit në çast. Sepse të gjithë ne e dimë se çdo gjë është e përkohshme, kalimtare...!”

*Konsideroje veten në këtë botë, një mysafir i ftuar për gosti në një saraj mbretëror. Mos ia ngul sytë bukurive të sarajit sepse asgjë prej tyre nuk mund të jetë e jotja. Mos mendo se do qëndrosh pafundësisht në saraje sepse ti nuk je tjetër vetëm se një mysafir i ftuar. Herët a vonë do largohesh. Nëse mendon kështu nuk do mërzitesh kur të ikësh. Por nëse harron se je një mysafir i përkohshëm, kur të ndahesh do mërzitesh, dëfrimet e kohës do kthehen në dhimbje...*

Përktheu dhe përshtati: Elona SYTARI



# Abdullah ibn Xhaferi

- R A D I J A L L A H U A N H U -

## *Fëmija i parë që lindi në Abisini*

— Mustafa Erish —

Abdullah ibn Xhaferi (r.a.), ishte bir hixhreti sepse lindi në Abisini!..

Ai ishte një fatlum që ia dha besën në moshën shtatëvjeçare të Dërguarit të Allahut, (s.a.s.), dhe pati nderin të hipte në kafshën e udhëtimit të Pejgamberit!..

Ai ishte një sahab i ri dhe ushtar i besimit, i cili u përkujtua si “Bahru’l-xhud/deti i bujarisë” dhe “Kutbu’s-seha/prijësi në bujari”!.. Ishte nipi i Ebu Talibit, xhaxhait të të Dërguarit të Allahut, (s.a.s.), dhe nipi (djali i vëllait hero) i Aliut (r.a.)!.. Abdullah ibn Xhaferi (r.a.), ishte kujtimi i parë i hixhretit për myslimanët, sepse lindi në Abisini si fëmijë i emigrit. Babai i tij ishte Xhafer Tajjari (r.a.), ndërsa nëna e tij ishte Esmâ binti Umejsel-Has’amijje (r.anha).

Abdullah ibn Xhaferi (r.a.), u rrit në një vatër familjare myslimane. Familja e tij në fillim emigroi në

Abisini dhe pastaj bëri hixhret në Medinë. Kur Abdullah ibn Xhaferi (r.a.), ishte shtatë vjeç, i dha besën të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Pejgamberi (a.s.) u interesua shumë për të. Kudo ku e shihte, e përkëdhelte dhe e ledhatonte. Këtë kujtim të këndshëm, që shfaq qartë interesimin e Hazreti Pejgamberit ndaj tij, e tregon vetë Abdullah ibn Xhaferi (r.a.):

“Më kujtohet qartë nga vogëlia ime, një ditë kur po luaja në rrugë së bashku me dy djemtë e Abbasit (r.a.), Kusemin dhe Ubejdullahun. I Dërguari i Allahut, (s.a.s.), erdhi pranë nesh me një kafshë. Ai na tha, duke më treguar mua me shenjë: “*Ma ngrini këtë djalë!*” – dhe më uli para tij. Pastaj na tham duke treguar me shenjë Kusemin: “*Ma ngrini edhe këtë!*” Atë e vendosi pas tij. Pastaj, ma ledhatoi tri herë kokën dhe për çdo ledhatim iu lut Allahut: “*O Allah! Ruaji Ti fëmijët e Xhaferit!*” (Ahmed, I, 205; Hakim, III, 655/6411.)



Babai i Abdullah ibn Xhaferit (r.a.), Xhafer Tajjari (r.a.), ra dëshmor në luftën e Mu'tesë. I Dërguari i Allahut, (s.a.s.), menjëherë shkoi te shtëpia e tij dhe i ngushëlloi pjesëtarët e familjes. Ai u interesua shumë për fëmijët e Xhaferit (r.a.), dhe e ndau dhimbjen bashkë me ta. Pejgamberi (a.s.), u përpoq shumë për t'i qetësuar, duke u dhënë mbështetje materiale dhe shpirtërore. Gjithmonë përgatiste ushqim në shtëpinë e tij dhe ua dërgonte. Këtë dashuri dhe shërbim të të Dërguarit të Allahut, (a.s.), e kujton edhe nëna e Abdullah ibn Xhaferit (r.a.), bashkëshortja e Xhaferit (r.a.), Esmā binti Umej-si (r.anha):

“Kur Xhaferi dhe shokët e tij ranë dëshmorë, i Dërguari i Allahut, (s.a.s.), erdhi te ne. Atë ditë pata punuar dyzet lëkura. Pasi pata bërë gati brumin e bukës, ua pata larë fytyrën fëmijëve dhe ua pata krehur kokën, i Dërguari i Allahut (s.a.s.), më tha: *“O Esmā! Ku janë fëmijët e Xhaferit?”* Ata i përqafoi, i puthi dhe i përkëdheli. Në ato momente filluan t'i rridhnin lot nga sytë. Unë i thashë:

“O i Dërguari i Allahut! Nëna dhe babai të qofshin falë! Përse po qan? Përse sillësh me fëmijët e mi sikur të jenë jetimë? Mos vallë ka ardhur ndonjë lajm i keq nga Xhaferi dhe shokët e tij?” I Dërguari i Allahut, (s.a.s.), më tha: *“Po, ata sot kanë rënë dëshmorë.”* Unë fillova të bërtisja duke thënë: “Ah, bashkëshorti im! Ah, Xhafer!” I Dërguari i Allahut, (s.a.s.), u ngrit dhe shkoi te vajza e tij, Fatimja (r.anha). Asaj i tha: *“Përgatisni ushqim për familjen e Xhaferit! Ata sot janë të zënë me fatkeqësinë që u ka ndodhur.”*

Familjes së Xhaferit (r.a.), iu dërgua ushqim tri ditë. I Dërguari i Allahut, (s.a.s.), nuk shkoi tri ditë në shtëpinë e Xhaferit (r.a.). Pastaj shkoi dhe i këshilloi pjesëtarët e familjes: *“Mos qani më për vëllain tim! Pas kësaj dite më takon mua që të përkujdesem për fëmijët e vëllait tim!”*

Abdullah ibn Xhaferi (r.a.), si një fëmijë i vogël, atë ditë kur babai i ra dëshmor, u ndikua shumë nga interesimi i ngrohtë dhe sjellja që i Dërguari i Allahut, (s.a.s.), shfaqti kundrejt tyre. Ai e tregon si më poshtë atë ditë, duke u shprehur se nuk do ta



**Abdullah ibn Xhaferi (r.a.), transmeton nga babai i tij: I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: “Thuajuni njerëzve tuaj të vdekur (që janë duke ndërruar jetë): “La ilaheil-lall-ilahu’l-Halimu’l-Kerim, Subhanall-llahi Rabbi’l-Arshi’l-adhim, El-hamdulil-lahi Rabbi’l-alemin.”** Ata që gjendeshin pranë tij e pyetën: “O i Dërguari i Allahut! Si do të ishte po t’ua thoshim këtë të gjallëve?” Pejgamberi ynë i nderuar u përgjigj: “Do të ishte më mirë, do të ishte më mirë!”

(Ibn Maxhe, Xhenaiz, 3.)

harronte kurrë momentin kur Pejgamberi (a.s.) ua kishte ledhatuar kokën dhe faqet me duart e tij të begata:

“I Dërguari i Allahut, (s.a.s.), na çoi në shtëpinë e tij sikur të ishim të vegjëlit e ndonjë zogu. Menjëherë u tha atyre që gjendeshin aty: *“Me thirrni një berber!”* Berberi erdhi dhe na qethi. I Dërguari i Allahut, (s.a.s.), ngriti duart dhe u lut duke thënë: *“O Allah! Ji ruajtësi i familjes së Xhaferit me mirësi! Jepi begati Abdullahut në tregti!”* Këtë e përsëriti tri herë. Kur erdhi nëna, ia tregova ngjarjen. Ajo u gëzua pa masë. I Dërguari i Allahut, (a.s.), i tha nënës: *“Mos u shqetëso aspak për jetesën dhe përkujdesjen ndaj fëmijëve! Unë do të jem kujdestari i tyre në këtë botë dhe në botën tjetër!”* (Ahmed, I, 204-205; Ebu Davud, Terexhxhul, 13/4192; Ibn Hisham, III, 436; Vakidi, II, 766;

Ibn Sa’d, IV, 37.)

Kur i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, ndërroi jetë, Abdullah ibn Xhaferi (r.a.), ishte një sahab i ri në moshën dhjetëvjeçare. Ai u njoh prej të gjithëve prej bujarisë së tij, krahas dashurisë dhe shërbimit ndaj të Dërguarit të Allahut, (s.a.s.). Për këtë arsye, ai njihet me llogarimin “bahru’l-xhud/deti i bujarisë” dhe “kutbu’s-seha/prijësi në bujari”. Në literatura transmetohen disa kujtime në lidhje me bujarinë e tij:

“Abdullah ibn Xhaferi (r.a.), gjatë një udhëtimi hyri në një bahçe hurmash. Shërbëtori i bahçes ishte një skllav me ngjyrë. Skllavit i kishin dhënë tri bukë. Në ato momente erdhi një qen. Skllavi ia dha qenit njëren prej bukëve. Qeni e hëngri bukën. Skllavi ia hodhi edhe bukën tjetër. Qeni e hëngri edhe atë. Skllavi ia hodhi edhe bukën e tretë. Qeni e hëngri edhe atë. Për këtë arsye, Abdullah ibn Xhaferi (r.a.), i tha skllavit:

-Cila është pagesa jote?

-Ja, këto tri bukë.

-Përse ia dhe të gjitha qenit?

-Në këto anë nuk ka asnjë qen. Ky qen duhet të ketë ardhur nga larg. Zemra nuk ma pranoi që ai të ngelej i uritur.

-Mirë, po ti çfarë do të hash sot?

-Do të bëj durim. Të drejtën time ditore ia dhashë kësaj krijese të uritur të Allahut.

Abdullah ibn Xhaferi (r.a.), u mahnit prej moralit të lartë të skllavit dhe tha: “Subhanall-llah/ I lartësuar është Allahu! Njerëzit thonë se unë jam shumë bujar, ndërkohë që ky rob qenka më bujar se unë!” Abdullah ibn Xhaferi (r.a.), bleu robin dhe bahçen e hurmave. Pastaj robiti i dhuroi lirinë dhe bahçen. (Gazali, Kimjaji Saadet, përkth. A. Faruk Mejan, Stamboll 1997, fq. 467.)

Ndërsa kujtimi i dytë i Abdullah ibn Xhaferit (r.a.), është si më poshtë:

“Zubejr ibn Avvami (r.a.), i kishte një borxh të konsiderueshëm Abdullah ibn Xhaferit. Pasi vdiq i ati, djali i Zubejrit shkoi te Abdullahu për të folur për borxhin. Abdullahu i tha: “Nëse dëshiron, mund të heq dorë prej borxhit dhe mund t’jua fal.” Abdullah ibn Zubejri nuk pranoi.” Nisur nga kjo, Abdullah ibn Xhaferi i tha: “Nëse juve ju duhet ta vononi një pjesë të borxhit, mund të vononi borxhin tim.” Abdullah ibn Zubejri (r.a.), nuk e pranoi as këtë ofertë.”

Kur Abdullah ibn Zubejri (r.a.), i pagoi borxhet e babait të tij, vëllezërit dhe motrat i thanë: “Tashti ndaje trashëgiminë!” Ndërsa Abdullahu (r.a.), u përgjigj:

“Betohem në Allahun se nuk do ta ndaj trashëgiminë pa e shpallur për katër vjet, përgjatë periudhës së haxhit, thirrjen: ‘Kushdo që i ka dhënë borxh Zubejrit, le të vijë ta kërkojë dhe t’ia paguajmë atë!’” Ai e bëri shpalljen për katër vjet. Pasi kaluan katër vjet, e ndau trashëgiminë. (Buhari, Fardu’l-Humus, 13.)

Abdullah ibn Xhaferi (r.a.), është shumë i njohur edhe për bujarinë që shfaq kundrejt një personi, te i cili pati qëndruar si mysafir përgjatë rrugës për në haxh. Sa të bukura dhe domethënëse janë për njerëzimin këto sjellje, përmes të cilave na mësohet se ai dëshironte t’i paguante shpërblimin për mikpritjen këtij personi! Ngjarja ndodhi siç vijon: “Hasani (r.a.), Husejni (r.a.), dhe Abdullah ibn Xhaferi (r.a.), dolën nga Medina dhe morën rrugën për në haxh. Përgjatë rrugës i humbën plaçkat dhe ngelën pa ushqim dhe pa ujë. Në shkretëtirë panë një çadër. Menjëherë shkuan drejt saj. Në çadër gjendej vetëm një grua e moshuar. Gruan e moshuar e pyetën nëse kishte diçka për të pirë. Plaka ua ktheu: “Kam një dele. Mileni dhe pijeni qumështin.” Pasi e molën delen dhe e pinë qumështin, i thanë se ishin edhe të uritur dhe e pyetën nëse kishte ndonjë gjë për të ngrënë. Gruaja e moshuar iu përgjigj: “Nuk kam asgjë tjetër përveç kësaj deleje. Thereni, në mënyrë që t’jua përgatis ushqimin.” Ata e therën delen dhe hëngrën. Kur deshën të largoheshin, gruas së moshuar i thanë: “Ne jemi prej fisit Kurejsh. Po shkojmë

në haxh. Nëse do të kthehemi shëndosh e mirë në Medinë, mos neglizho që të vish dhe të na vizitosh. Ne duam të të japim shpërblimin për mirësinë që na bërë.” Kur në mbrëmje erdhi bashkëshorti i gruas së moshuar dhe dëgjoi për atë që kishte ngjarë, u nxe dhe i tha: “Si mund t’ua japësh delen për ta ngrënë disa njerëzve që nuk i njeh? Po më thua se ishin disa njerëz prej Kurejshëve. Si mund t’i gjejmë ata?”

Kjo familje pas një farë kohe u detyrua të emigronte në Medinë. Pjesëtarët e saj e siguronin jetesën duke mbledhur dhe shitur pleh bagëtish. Një ditë, kur po kalonin nëpër rrugët e Medinës, rastisën te shtëpia e Hasanit (r.a.).

Hasani (r.a.), po qëndronte i ulur para derës. Ai menjëherë e njohu gruan e moshuar, por plaka nuk e njohu. Hasani (r.a.), u ngrit dhe shkoi te gruaja dhe ia kujtoi mirësinë që u kishte bërë, pastaj i dha shumë florinj dhe dele. Pastaj e dërgoi te Husejni (r.a.). Edhe Husejni pasi e nderoi dhe i dha shumë dhurata, e dërgoi te Abdullah ibn Xhaferi (r.a.). Abdullah ibn Xhaferi (r.a.), i dha dy herë më shumë se dhuratat që i kishin dhënë Hasani dhe Husejni, dhe e përcolli.

Pasi gruaja u largua, Abdullah ibn Xhaferi (r.a.), tha me vete: “Sa mirë që së pari paskeni shkuar te ata, sepse, po të vinit së pari te unë, ata do të ndiheshin në vështirësi.” Në këtë mënyrë, shprehu faktin se mendonte për vëllezërit e tij në fe dhe se kurrë nuk dëshironte që ata të gjendeshin në pozitë të vështirë. (Shik. Gazali, Kimjaji Saadet, fq. 463-464.)

Abdullah ibn Xhaferi (r.a.), mori pjesë në luftën e Xhemelit dhe Siffinit. Dënimin me vrasje që u dha për Ibn Mulxhemin, i cili pati vrasë Aliun (r.a.), e ekzekutoi pikërisht vetë ai.

Ai ka transmetuar rreth njëzet e pesë hadithe nga i Dërguari i Allahut, (a.s.). Prej tij kanë transmetuar hadithe dy bijtë e tij, Ismaili e Is’haku, dhe dijetarë prej tabiinëve si Kasim ibn Muhamedi dhe Urve ibn Zubejri.

Telkini ndaj të gjallëve

Abdullah ibn Xhaferi (r.a.), transmeton nga babai i tij: I Dërguari i Allahut, (s.a.s.), ka thënë: “*Thuajuni njerëzve tuaj të vdekur (që janë duke ndërruar jetë): “La ilaheil-lall-llahu’l-Halimu’l-Kerim, Subhanall-llahi Rabbi’l-Arshi’l-adhim, El-hamdulil-lahi Rabbi’l-alemin.”* Ata që gjendeshin pranë tij e pyetën: “O i Dërguari i Allahut! Si do të ishte po t’ua thoshim këtë të gjallëve?” Pejgamberi ynë i nderuar u përgjigj: “*Do të ishte më mirë, do të ishte më mirë!*” (Ibn Maxhe, Xhenaiz, 3.)

# TRI DITË ZI

Abdullah ibn Xhaferi (r.a.), ka thënë:

“I Dërguari i Allahut, (s.a.s.), u pati dhënë tri ditë leje për të mbajtur zi, bashkëshortes dhe fëmijëve të Xhafer ibn Ebu Talibit (r.a.). Pastaj shkoi te ata dhe u tha: “*Mi thërrisni fëmijët e vëllait tim!*” Na mblodhën dhe na sollën. E ndjenim veten si zogj të vegjël që kishin humbur nënën e tyre. Pastaj Pejgamberi (s.a.s.), tha: “*Më thërrisni një berber!*” Berberit që erdhi i tha që të na qethte, dhe berberi na qethi.” (Ebu Davud, Menasik, 78, Terexhxhul, 13. Veçanërisht shik. Nesai, Zinet, 57-58.)

Në lidhje me qethjen e flokëve janë transmetuar katër hadithe fisnike. Secili prej këtyre haditheve na e tregon rrugën duke vendosur në pah qëndrimin e të Dërguarit të Allahut, (s.a.s.), në lidhje me këtë çështje. Në shpjegimin e këtyre haditheve, që gjenden në Rijazu’s-Salihin, nxirren në pah këto çështje të rëndësishme:

Në hadithin e parë njoftohemi se i Dërguari i Allahut, (s.a.s.), e ka ndaluar qethjen vendvend të flokëve të fëmijëve, pikërisht si shpërndarja e reve nëpër qiell. Brenda kësaj ndalesë konsiderohet edhe qethja e pjesës më të madhe të kokës, duke lënë balluke në pjesën e përparme.

Në hadithin e dytë transmetohet kjo ngjarje: Kur i Dërguari i Allahut, (s.a.s.), pa një fëmijë që kishte qethur një pjesë të flokëve dhe pjesën tjetër jo, i këshilloi prindërit e tij: “*Ose qethjani plotësisht flokët fëmijës, ose lërjani pa qethur!*” Këtu vëmë re se i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka bërë ndërhyrje pikërisht vetë te kjo ngjarje, ngaqë qethja përgjysmë në ato kohë, i ngjante qethjes së politeistëve, çifutëve dhe të devijuarve.

As në ditët e sotme, kurrë nuk duhet të ndiqen stilet e rrobave dhe veshjeve të kulturave të huaja, në emër të modës. Të gjitha besimet kanë rrobat dhe veshjet e tyre, të cilat reflektojnë botën kulturore të njeriut që i pason.

Ndërsa në hadithin e tretë shohim se Hazreti Pejgamberi (a.s.), u ka dhënë tri ditë e tri net kohë për të mbajtur zi për babanë e tyre pjesëtarëve të familjes së Xhafer ibn Ebu Talibit (r.a.), i cili ra dëshmor në luftën e Mu’tesë. Pasi mbaroi kjo kohë, shkoi në shtëpinë e tyre dhe

duke përdorur fjalën “vëllai im”, ngaqë ishte biri i Ebu Talibit, u tha: “Këtej e tutje mos qani më për vëllain tim, Xhaferin!” Pastaj urdhëroi që të vinte një berber dhe t’i qethte fëmijët djem. Më i madhi prej fëmijëve, që i Dërguari i Allahut, (s.a.s.), qethi, ishte Abdullah ibn Xhaferi (r.a.).

Formën që ka caktuar dhe sugjeruar i Dërguari i Allahut, (s.a.s.), në lidhje me çështjen e qethjes së flokëve të fëmijëve, e shohim se e ka zbatuar edhe ai vetë në këtë ngjarje. Prej këtij sugjerimi dhe qëndrimi të Pejgamberit tonë të nderuar, kuptohet krejt qartë se nuk duhet ta neglizhojmë këtë çështje duke e trajtuar si të pa rëndësishme, dhe se myslimanët duhet të kenë një qëndrim dhe formë specifike të tyre në lidhje me çështjen e qethjes së flokëve.

Hadithi i katërt shpreh se gratë myslimane e kanë të ndaluar nga i Dërguari i Allahut, (s.a.s.), që t’i shkurtojnë flokët deri në rrënjë. Nga ana tjetër, Abdullah ibn Abbasi, radijallahu anhum, na njofton se Pejgamberi, (a.s.), ka thënë për të dalë nga ihrami: “*Gratë nuk ka nevojë t’i rruajnë flokët. Mjafton që t’i shkurtojnë.*” (Shik. EbuDavud, Menasik, 78.) Atëherë, gratë myslimane nuk duhet t’i presin asnjëherë flokët e tyre deri në rrënjë, përveç situatave të domosdoshme si në rast mjekimi. Prerja e flokëve të grave deri në rrënjë konsiderohet si një lloj “musle”, domethënë, konsiderohet si prerja e ndonjëres prej gjymtyrëve.

Neve na takon t’ua mësojmë sunetin dhe ndjeshmërinë e të Dërguarit të Allahut, (s.a.s.), brezave myslimanë, të cilët përpiqen t’u ngajnë yjeve të kinemasë dhe televizionit të ditëve të sotme, që veshin lloj-lloj rrobash në emër të modës, edhe nëse nuk u shkojnë, dhe që kanë pësuar humbje të personalitetit dhe identitetit.

Këto bukuri të Islamit janë prova që argumentojnë se sa e vërtetë është feja jonë dhe se mësimet e saj janë të vlefshme për të gjitha kohërat. Prandaj, të gjithë duhet t’u dalin për zot kokës, zemrës dhe flokëve të tyre. As perëndimi, as përrallat e modernizimit nuk duhet të bëhen perde për degradimin e këtij identiteti dhe personaliteti.



# Pesha e mungesës

— Edison Çeraj —

Sa herë kam rastin të shoh pikturat e Fatlumi, provoj ndjesinë e një gjëje që më mungon. Është si një shkëputje nga graviteti, nga “rregullat e lojës”, për të provuar kështu praninë e pranive: mungesën. Mungesa është prania më e pushtetshme. Ajo eklipson çdo lloj pranie të rrokshme nga shqisat, çdo gjë që na rrethon.

Pra, këto piktura na kujtojnë një botë që po zbehet brenda dhe jashtë qenies, ose – akoma më keq – një botë që po bëhet gjithnjë e më e huaj për ne. Në kohë dhe vende të ndryshme njerëzit e kanë shenjuar në forma të ndryshme, si: përrallore, magjike, mitike, legjendare, fantastike, metafizike e kështu me radhë. Ajo që ka rëndësi nuk janë shenjuesit e larmishëm që janë përdorur për këtë botë, pra për mungesën, por vetë ajo, tërheqja e saj e vazhdueshme nga dita dhe nata jonë; reduktimi i saj në iluzion apo makth. E megjithatë mungesa është përsëri aty, ose kudo, duke munguar aq ndjeshëm, sa nuk gjejmë dot fjalët për të. Çdo krijim i kësaj natyre nuk është gjë tjetër veçse një dhuratë nga mungesa, ose një zile e saj që synon të na “prishë” sado pak gjumin e thellë në të cilin zhytemi kaq shpesh; një gjumë pa ëndrra, si një mjegullnajë bjeshke, që i rrëmben ecjes shtegun.

Ka artistë të cilët kanë si synim të jenë të vërtetë ose besnikë ndaj rrethanave të jashtme ku bëjnë pjesë, që nuk duan të shkojnë “larg”, sidomos në

rastin e Shqipërisë ku ka kaq shumë “tundime” në rrafshin e peizazhit, arkitekturës, hapësirave publike etj., gjë që e hasim në pikturën e Edi Hilës.

Nga ana tjetër ka nga ata që nuk e “pleksin” veprën e tyre me çfarë i rrethon, dhe kështu zgjedhin apo i dorëzohen “imagjinatës”, asaj çfarë “u zbulohet” qenies së tyre, “domosdoshmërisë së brendshme”, siç e thotë Kandinski. I tillë është edhe Fatlumi. Ja pse kemi të bëjmë me një pikturë që nuk vuan dhe as nuk kushtëzohet nga domethënia, pra nga koncepti apo ideja, që po përdoren masivisht (si kripa) në artin bashkëkohor. Forma dhe përmbajtja veprojnë të njësuara në këtë lloj pikturë.

T’i jepesh një krijimtari të kësaj natyre në një realitet ku brutalja përzihet me një paqëndrueshmri “magjike” është një akt sublim rezistence, për të mos u bërë palë me atë që “duhet”, me atë që “kërkohet”, për të mos ecur “me hapin e kohës”.

## *Instalacioni si zgjatim i pikturës*

Duke qenë se pjesë e ekspozitës është edhe një instalacion, në shikim të parë – që shpeshherë është përcaktues për rishikimin – ai të jep idenë se është vazhdimësi e pikturës me mjete të tjera. Autori ka shfrytëzuar një mundësi postmoderne, por me një përkorje dhe mjeshtëri tradicionale, saqë të duket sikur “punimi” ka dalë nga një punishte e harruar



nga koha, që nuk ia doli asnjëherë të bëhej pjesë e ndonjë qendre tregtare, pikërisht ngaqë nuk ofron mallra në seri, ngaqë nuk e njih kopjen. Kjo punishte ofron vetëm mall.

Nga ana tjetër, kur instalacioni është në errësirë, kur trungjeve gjarpërues u “ndizen” krenat, të duket sikur je mes disa kandilësh deti që vallëzojnë shpengueshëm, pa u druajtur aspak nga ndonjë grabitqar që i bie rruga andej. Në këtë gjendje vepra sikur shkëputet nga toka dhe nis të animojë hapësirën, duke të ftuar që të bëhesh pjesë e “lojës”, pa u vënë në siklet për kuptimin, sepse ai cenon ritmin e “lojës”.

Ajo çfarë thamë për pikturën më lart, vlen edhe për instalacionin, sepse edhe ai është pjesë e së tërës.

### *Një lule dhe shumë lule*

Në fakt, është një “rrethanë” që e bën për vete autorin herë pas here: lulet. Ama lulet nuk janë rrethana, por shenja<sup>1</sup>, që lexohen edhe përmes nuhatjes,

1. “Universi është plot me shenja që ne nuk i kuptojmë”, thoshte Kafka; sepse i konsiderojmë thjesht rrethana, që janë aty rastësisht, pa hije; që

sidomos nuhatjes, shqisa më e afërt me kujtesën. Pastaj vjen faza e rileximit: ëndërrimi.

Jo vetëm që lulet nuk mund t’i rendisim te rrethanat, por teksta i shohim ato na shkëpusin për disa çaste nga rrethanat. Edhe një lule e vetme është në gjendja ta bëjë këtë. Një lule e vetme na kujton një thënie të Aleksandrit: “...për mua është shumë, për të tjerët nuk mjafton.” Me të marrë këtë shenjë, me ta lexuar kësisoj, strategu i urtë vazhdoi rrugën.<sup>2</sup>


Fatlumi është rritur në një mejdis me lule, pasi familja e tij ka një biznes të vogël lulesh, ku tregton pikërisht këtë “mall”. Por, me sa duket, për Fatlumin lulet nuk u bënë asnjëherë “mall tregu”, por mbetën mall shpirtëror, gjë që e provon piktura e tij, ku në jo pak prej tyre hasim elemente floreale që shkëputen nga natyra dhe harlisen duke u rritur me një tjetër ujë, me një tjetër diell.

Sidoqoftë, lulet mbeten shenjat që i tregojnë rrugën drejt vetes, duke e nxitur për rikthime të vazhdueshme në kujtim të mungesës.

Lulet janë çelësa për të hapur dyert e kujtesës.

shkojnë e vijnë; që i (keq)përdorim vetëm kur na duhen.

2. Vendet që pushtoi Aleksandri lulëzuan, kurse ato që pushtoi Xhingis Khani u shkretuan.





## Një Ajet

“Jo, për Zotin tënd, ata nuk do të jenë besimtarë të vërtetë, derisa të të marrin ty për gjyqtar për kundërshtitë mes tyre; e pastaj, të mos ndiejnë kurrfarë dyshimi ndaj gjykimit tënd dhe të të binden ty plotësisht!”

(Nisa, 65)

Në këtë ajet, Allahu i Lartmadhëruar urdhëron sahabet e prej këtu të gjithë myslimanët që në rast mosmarrëveshesh ndërmjet njëri-tjetrit të thërrasin në ndihmë gjykimin e të Dërguarit të Allahut. Ndërsa detyra e një myslimani që konsultohet me gjykimin e Pejgamberit është dorëzimi me gjithë zemër i këtij gjykimi profetik. Vetëm në sajë të këtij dorëzimi arrihet grada e muminit.

Myslimanët që do të vijnë pas sahabeve, pra ne, si mund të thërrasim në ndihmë gjykimin e Hazreti Pejgamberit? I Dërguari i Allahut në një hadith është shprehur:

*“Po ju lë dy gjëra. Nëse kapeni fort pas tyre nuk do të humbisni asnjëherë rrugën e drejtë. Librin e Allahut dhe Sunnetin e të Dërguarit të Tij.”* (Muvatta’, Kader 3)

Prandaj problemet tona jemi të detyruar t’i zgjidhim me dritën e Kuranit dhe Sunetit. Kjo do të thotë që çështjet në lidhje me të cilat ka gjykime të qarta në Kuran dhe në Sunet do t’i zgjidhim pikërisht ashtu siç na urdhërohet në Kuran dhe në Sunet. Por në qoftë se çështja (tema) nuk haset as në Kuran e as në Sunetin e të Dërguarit të Allahut atëherë do të marrim një vendim në frymën e urdhëresave dhe të këshillave të Kuranit dhe të Sunetit.

Zubejr Ibn Avvam debatoi me njërin prej Ensarëve në lidhje me ujitjen e një sipërfaqe toke jashtë Medines. Pasi ato nuk arritën t’i jepnin zgjidhje erdhën së bashku tek Pejgamberi për të kërkuar gjykimin e tij. Mirëpo gjykimi që Pejgamberi dha nuk i pëlqeu fare myslimanit prej ensarëve, madje ai e akuzoi Pejgamberin

se po bëhej palë me Zubejr ibn Avvamin. Kjo situatë u bë shkak për zbritjen e ajetit që kemi vendosur në krye të faqes. (Buhari, Tefsiri i sures (4), 12, Musakat 8, Sulh 12)

Sqarimi i disa pikave që lidhen me ajetin në fjalë do të sillte kuptimin më të thellë të çështjes si dhe rëndësinë që ka kjo temë.

Allahu i Lartmadhëruar e ka lidhur të qenurin besimtar i vërtetë (mu’min) me disa kushte:

1. Besimtarët janë të detyruar që për problemet e ndryshme që ato hasin në jetën e tyre të marrin Pejgamberin si gjyqtar në mesin e tyre. Ai që nuk pranon gjykimin e të Dërguarit të Allahut nuk mund të jetë mu’min (besimtar i vërtetë).

2. Besimtarët nuk duhet të preken apo të fyhen së brendshmi nga gjykimet apo vendimet e të Dërguarit të Allahut. Një njeri mund të shprehë pëlqimin e tij në dukje ose së jashtmi dhe të mjaftohet me kaq, por ajeti konsiston në domosdoshmërinë e pëlqimit të çdo gjykimi të Profetit edhe me zemër.

3. Besimtarët e vërtetë duhet t’i dorëzojnë tërësisht gjykimeve të të Dërguarit të Allahut. Ndoshta edhe një njeri që beson me zemër vërtetësinë e gjykimit në fjalë, mund të dyshojë apo të jetë kokëfortë së jashtmi në lidhje me pranimin ose jo të këtij gjykimi. Mirëpo Allahu i Lartmadhëruar në ajetin e mësipërm kërkon prej besimtarëve që ato jo vetëm të kenë iman të sinqeritë në zemër, por të dorëzohen tërësisht edhe se jashtmi.



Transmetohet se Pejgamberi (a.s.) ka thënë:

*"I gjithë ymeti im do të hyjë në xhenet, përveç atyre që nuk dëshirojnë!"*

Pejgamberi (a.s.) u pyet:

O i Dërguari i Allahut, po kush nuk dëshiron të hyjë në xhenet?

Pejgamberi (a.s.) tha:

*"Ata që do të më binden mua do të hyjnë në xhenet, ndërsa ata që nuk më binden janë ata që nuk dëshirojnë të hyjnë në xhenet."*

Ata që nuk dëshirojnë të hyjnë në xhenet mund t'i grupojmë në dy kategori ose mund t'i kuptojmë në dy mënyra. Njëri prej këtyre grupeve është ai që emëtohet "ummet-i davet", të cilëve i ka shkuar ftesa për të hyrë në islam, nëse nuk e pranojnë, pra nuk bëhen mysliman atëherë quhen kafir. Ndërsa grupi tjetër që emërtohet "ummeti ixhabet" janë ato individ që kanë pranuar islamin dhe të cilët duhet të jenë shembull për të tjerët. Në mesin e këtyre të fundit ka nga ato që nuk i binden asaj çfarë i është shpallur Pejgamberit (a.s.) duke mos i kryer obligimet fetare, e kështu ato meritojnë të quhen rebel ose gjynahqar. Kafirët nuk do hyjnë kurrë në xhenet. Ndërsa rebelët, gjynahqarët do të hyjnë në xhenet, por pasi të shlyejnë mëkatet në xhehenem. Kjo do të thotë që gjynahet nuk e zhdukim imanin (besimin) por e shpien njeriun në xhehenem. Duhet theksuar se qëndrimi i këtyre të fundit në xhehenem nuk do të jetë i përrjetshëm, si ai i kafirëve.

Sahabet u habitën dhe u bënë kurioz në lidhje me atë grup individësh të cilët nuk dëshironin të hynin në xhenet, prandaj e pyetën Pejgamberin (a.s.) për t'u informuar. Përgjigjja e Pejgamberit (a.s.) që e shkurtër, por shume kuptimplotë, sipas së cilës ai që do t'i bindet atij do të hyjë në xhenet, kurse ai që do t'i kundërvihet atij do të thotë se dëshiron xhehenemin. T'i bindesh Pejgamberit (a.s.) do të thotë të lidhesh me tërë forcën tënde me Kur'anin dhe Sunetin e Pejgamberit, e ato që do të veprojnë kështu do të hyjnë në xhenet si besimtarë të devotshëm. Ndërsa të rebelohesh ndaj Pejgamberit (a.s.) do të thotë të mos pranosh ftesën për të hyrë në fenë islame, e kështu të jetosh si kafir e të përfundosh përjetësisht në xhehenem, ose ta pranosh ftesën për të hyrë në fenë islame, por të mos veprosh sipas asaj çfarë urdhërohet nga kjo fe e nderuar, e kështu të jetosh si gjynahqar, që do të thotë të shkosh në xhehenem për t'i shlyer gjynahet e më pas të arrish të shkosh në xhenet.

#### **MËSIMET QË NXJERRIM NGA HADITHI:**

Bindja ndaj të Dërguarit të Allahut bëhet shkak për hyrjen e besimtarit në xhenet.

Të kundërshtosh Pejgamberin (a.s.) do të thotë të mos pranosh fenë e cila i është shpallur atij, e kështu të përfundosh në xhehenem përjetësisht. Ai që ka pranuar Islamin dhe vazhdon të kryejë gjynahe do të hyjë në xhehenem, por nuk do të qendrojë gjithmonë aty.

## *Mje Hadith*



# UDHËTIMI I PËRJETËSISË

## - PJESA IV -



### VDEKJA

Kur shpirtit i vishet rroba e trupit dhe hyn në këtë botë nga një derë e caktuar, automatikisht njeriu është udhëtar i vdekjes.

Edhe po të mblidheshin gjitha mirësitë e përkohshme në një njeri të vetëm dhe ai të ishte i pasur sa Sulejmani (a.s.), në aspektin material, i bukur sa Jusufi (a.s.), dhe të jetonte njëmijë vite në lumturi e madhështi, përsëri nuk do t'i bënin dobi!.. A nuk është një gropë e ngushtë në tokë përfundimi i gjithësecilit prej nesh?!..

\*\*\*

Padyshim se njeriu do të ringjallet në gjendjen që ka vdekur. Njëherë Abdullah ibn Amr (r.a.) kishte pyetur:

“O i Dërguari i Allahut! A mund të më tregoni

në lidhje me luftën dhe pjesëmarrjen në të?”

I Dërguari i Allahut, (a.s.), u përgjigj:

*“O Abdullah ibn Amr! Nëse lufton me sinqeritet duke duruar dhe duke e pritur shpërblimin vetëm nga Allahu, Ai do të të ringjallë si një person të sinqertë e durimtar, që e pret shpërblimin vetëm prej Tij.*

*Por, nëse lufton për t'u dukur dhe për t'u mburrur me pasurinë e shumtë dhe trimërinë e madhe, Allahu i Madhëruar do të të ringjallë si një person që dëshiron të duket e të mburret dhe mendjemadh.*

*O Abdullah ibn Amr! Në çfarëdo gjendjeje të luftosh apo të vdesësh, në atë gjendje do të ringjallë edhe Allahu!”* (Ebu Daud, Xhihad, 24/2519; Hakim, II, 95/2437.)

Lidhur me këtë çështje flasin edhe këto hadithe:



“Ditën e Kiametit njerëzit do të ringjallen në gjendjen që kanë vdekur!” (Muslim, Xhenet, 83.)

“Kur Allahu i Madhëruar dëshiron të dënojë një popull, dënimi i përfshinë të gjithë e më pas çdokush ringjallet sipas veprave të tij.” (Muslim, Xhenet, 84.)

Për të dhënë frymën e fundit me besim

Çdo diplomë, që njeriu merr në këtë botë, është e vlefshme për gjatë gjithë jetës së tij. Mirëpo në jetën shpirtërore nuk funksionon kështu. Aty nuk ka një garanci të tillë sepse ekziston rreziku që çdo gjendje dhe pozitë që fitohet të mund të humbet në çdo moment. Kurani Fisnik na jep shembull njerëzit si Bel’am ibn Baura dhe Karuni, të cilët kanë rrëshqitur nga rruga e drejtë në momentet e fundit.

Në fillim Karuni ishte një njeri i devotshëm dhe prej komentuesve më të mirë të Teuratit. Më vonë ai u sprova me pasuri dhe prej krenarisë, që i dhanë pasuria e pushteti, ai i doli kundër Musait (a.s.). Kjo krenari dhe mendjemadhësi, e çoi atë drejt shkatërrimit.<sup>1</sup>

Po ashtu, edhe Bel’am ibn Baura<sup>2</sup>, i cili kishte arritur majat e gradëve shpirtërore, më në fund anoi kah dëshirat e egos dhe u shkatërrua.

Në fakt, garancinë e shpëtimit dhe dhënies së

frymës së fundit me besim e kanë vetëm profetët dhe njerëzit të cilët janë përgëzuar nga ata.

Për këtë arsye besimtari:

- Duhet të jetojë gjatë gjithë jetës me frikë, me shpresë dhe me vigjilencë të lartë shpirtërore.

- Duhet të përpiqet të kuptojë misterin e ajetit fisnik: “**Adhuroje Zotin tënd derisa të të vijë vdekja!**” (Hixhr, 99.)

- Duhet që çdo frymë të jetës ta vlerësojë duke u munduar të vërë në jetë mësimet e Kuranit dhe Sunnetit dhe pa hequr nga gjuha dhe zemra lutjen e Jusufit (a.s.): “**...(O Zoti im) Bëj që të vdes si mysliman dhe më bashko me punëmirët (në botën tjetër)!**” (Jusuf, 101.)

- Nuk duhet të harrojë se diploma më e rëndësishme e kësaj bote të përkohshme është dëshmia e besimit që do të merret në frymën e fundit.


Lidhur me domosdoshmërinë e vigjilencës së zemrës deri në frymën e fundit, po japim një shembull shumë mësimdhënës:

Të nderuarit Sufjan Theurit i ishte kërrusur beli që në moshë të re dhe atyre që e pyesnin për shkakun, u përgjigjej:

“Kisha një mësues prej të cilit merrja dituri. Kur i erdhi momenti i vdekjes, u përpoqa ta nxisja të shqiptonte shehadetin por sado që u mundova ai nuk arriti ta thoshte. Dhe pikërisht kjo ndodhi ma kërrusi belin.”

\*\*\*

Fryma e fundit është momenti më kritik dhe më i vështirë i jetës. Në atë moment përmbysen



*O Abdullah ibn Amr!  
Nëse lufton me sinqeritet  
duke duruar dhe duke  
e pritur shpërblimin vetëm  
nga Allahu, Ai do të të  
ringjallë si një person të  
sinqertë e durimtar,  
që e pret shpërblimin  
vetëm prej Tij...*

1. - shih. Kuran, Kasas, 76-82.

2. - “Tregoju atyre (hebrenjve) për njeriun, të cilit Ne i mësuam shpalljet Tona, por u largua prej tyre. Kështu, djalli e pushtoi atë dhe ai u bë nga të humburit” (Araf, 175.) Komentuesit e Kuranit janë të mendimit se personi në këtë ajet, të cilit nuk i përmendet emri, është pikërisht Bel’am ibn Baura, prej popullit të Musait (a.s.). Në fillim ky person i kishte besuar Musait (a.s.), por më pas ra në mohim për hir të disa interesave të cekëta të kësaj bote.

të gjitha mendimet, ëndrrat dhe planet e njeriut për këtë botë. Lidhur me këtë në një ajet fisnik sqarohet:

**“Agonia e vdekjes do të sjellë të vërtetën (e jetës tjetër): ja, kjo është ajo së cilës përpiqeshe t’i ikje.”** (Kaf, 19.)

Ndërsa Aisheja (r.a.), tregon:

“(Në momentin e vdekjes) Para të Dërguarit të Allahut gjendej një enë me ujë. Ai i fuste duart e tij të bekuara në këtë enë dhe fërkonte fytyrën. Më pas thoshte: «*La ilahe illallah! Padyshim se vdekja është gjendje e vështirë!*»...” (Buhari, Rikak, 42. Megazi, 83.)

Nëse dëshirojmë që frymën e fundit ta japim me besim, duhet të përgatitemi për atë moment të vështirë, sepse një person në zemrën e të cilit nuk është rrënjësor besimi sa ka qenë gjallë, nuk ka jetuar në përputhje me Kuranin dhe Sunnetin dhe nuk e ka mësuar gjuhën e tij me përmendjen e shpeshtë të Allahut, e ka të vështirë që në atë moment të keq të sjell ndërmend shehadetin.

Këtë të vërtetë, e shpreh shumë mirë kjo ndodhi:

Transmetohet se një rrobaqepës e ka pyetur një dijetar në lidhje me hadithin e Profetit (a.s.), ku thuhet: “*Allahu e pranon teuben e robit të Tij derisa nuk i ka ardhur shpirti në fyt.*”<sup>3</sup>

Dijetari i përgjigjet duke e pyetur:

- Po, ashtu është. Por cili është profesioni yt?
- Unë jam rrobaqepës.
- Cila është gjëja më e thjeshtë në profesionin tënd?
- Të marrësh gërshtë dhe të presësh copën.
- Sa vjet ke që e bën këtë punë?
- Që prej tridhjetë vjetësh.
- A do të mund ta presësh copën kur të të vijë shpirti në fyt?
- Jo, nuk do të mundem.
- O rrobaqepës! Atëherë, nëse nuk do të mund të bësh një punë që e ke mësuar për një farë kohe dhe ke tridhjetë vjet që e bën lehtësisht, si do ta

bësh teuben të cilën nuk e ke bërë asnjëherë në jetën tënde kur të të vijë shpirti në fyt? Teuben bëje sot kur ke fuqi dhe shëndet! Përndryshe, në frymën e fundit nuk do ta kesh të mundur kërkimin e faljes dhe përfundimin e mirë... A nuk e ke dëgjuar ndonjëherë fjalën: “Nxitoni në teube pa ardhur vdekja!”<sup>4</sup>

Për rrjedhojë, lënia e teubes, istigfarit, falënderimit, dhikrit, mirënjohjes dhe adhurimeve ndaj Allahut, për një të ardhme e cila nuk dihet a do të vijë, ose për në fund të jetës, është shkak i një dështimi të hidhur, sepse ne nuk e dimë se kur do të na mbarojnë frymët tona të numëruara dhe në ç’gjendje do të na gjejë fryma e fundit. Ky është një mister hyjnor.

\*\*\*

Një ditë, **Omeri** (r.a.) vuri re se **Talha** (r.a.) ishte shumë i mërzitur. Kur e pyeti për shkakun, Talha (r.a.) tha:

“Njëherë, i Dërguari i Allahut, tha:

«Unë di një fjalë, që nëse shqiptohet në momentet e vdekjes, ajo patjetër do të bëhet dritë për librin e punëve të tij dhe në ato momente, trupi e shpirti i tij arrijnë kënaqësinë hyjnore, mëshirën dhe paqen, në sajë të kësaj fjale.»

Mirëpo, Resulallahu (a.s.), ndërroi jetë dhe unë nuk pata mundësi që ta pyes për fjalën. Prandaj jam i mërzitur.”

Pas kësaj, Omeri (r.a.), tha:

“Unë e di atë fjalë. Ajo është shprehja (*La ilahe il-lallah*) të cilën Profeti ynë dëshironte ta dëgjonte të thënë nga xhaxhai i tij (Ebu Talibi). Nëse Resulallahu (a.s.) do të dinte një fjalë më shpëtuese se kjo, patjetër do ishte ajo që do të dëshironte ta degjonte nga xhaxhai.” (Ibn-i Maxhe, Edeb, 54. Shih. Ahmed I, 6.)

E në fakt i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“*Kush thotë La ilahe il-lallah hyn në xhenet!*” (Ebu Daud, Xhenaiz, 15-16/3116; Ahmed, V, 247; Hakim, I, 503. Shih. Buhari, Xhenaiz, 1.)



3. Tirmidhi, Deauat, 98/3537.

4. Munavi, V, 65.

Sipas mendimit të dijetarëve, në këtë hadith bëhet fjalë për shprehjen **“La ilahe il-lallah”** dhe pjesën tjetër të pandashme të formulës së teuhidit **“Muhammedu’r-Rasulullah”**. Pra është e domosdoshme që këto pjesë të shqiptohen të dyja njëherësh. Në disa transmetime ceket vetëm shprehja **“la ilahe il-lallah”**, por në fakt synohen të dyja pjesët, sepse shprehja **“la ilahe il-lallah”** në aspektin e sheriatit pranohet si deklarimi i të dyja pjesëve.<sup>5</sup>

Nëse një jetë bëhet në përputhje të plotë me qëllimin e **“formulës së teuhidit”**<sup>6</sup>, kjo formulë gdhendet në zemër. Por nëse robi është neglizhent ndaj urdhrave dhe ndalesave të Allahut të Madhëruar, nëse ka shumë të meta, ose është plotësisht moskokëçarës, midis tij dhe shprehjes së teuhidit hapet një humnerë e madhe. Nëse ai nuk bën teube dhe nuk heq dorë nga indiferenca, kjo humnerë thellohet edhe më shumë. Dështimi më i madh pason jetën, nëse lidhja e kësaj shprehjeje me njeriun mbetet vetëm një shqiptim i thatë i germave të saj.

Allahu i Madhëruar urdhëron:

**“Vërtet mendojnë njerëzit, se do të lihen të thonë “Ne besojmë”, pa u vënë në provë?! Ne i kemi sprovuar ata që kanë qenë para tyre, në mënyrë që, Allahu të dallojë ata, që thonë të vërtetën dhe, ata që gënjejnë.”** (Ankebut, 2-3.)

\*\*\*

Njëherë Uehb ibn Munebbih është pyetur:

“A nuk është **«La ilahe il-lallah»** çelësi i Xhenetit?”

“Po, ashtu është. Mirëpo çdo çelës ka patjetër edhe dhëmbët e tij. Nëse mbart çelësin me dhëmbët e duhur dera do të hapet, përndryshe jo.” – u përgjigj ai. (Buhari, Xhenai, 1.)

Po ashtu edhe Imam Zuhriu, i cili ishte prej dijetarëve të mëdhenj të tabiinëve, është pyetur

në lidhje me hadithin e Profetit (a.s.): **“Kush thotë La ilahe il-lallah hyn në xhenet!”**, e ai është përgjigjur:

“Ky rregull vlente për ditët e para të Islamit, para se të zbriteshin farzet, urdhrat dhe ndalesat.” (Tirmidhi, Iman, 17/2638.)

Pas pranimit të fesë, është kusht që gjykimet e Kuranit dhe Sunnetit të zbatohen me përpikëri. Nisur nga kjo, të jetuarit në përputhje të plotë me **“formulën e teuhidit”** është domosdoshmëri për lumturinë tonë të përjetshme.

Veprat e këqija, që burojnë nga ndjekja e dëshirave dhe egos dhe nga neglizhenca e urdhrave të fesë, shpeshherë bëhen pengesë për shqiptimin e shehadetit në frymën e fundit. Lidhur me temën tregohet edhe një ndodhi e tillë:

Një person, i cili gjatë gjithë jetës ishte munduar të peshonte saktë me peshore, gjendej në momentet e vdekjes. Ndërkohë që po e nxisnin të shqiptonte shehadetin (La ilahe il-lallah), ai me shumë mundim tha:

“Lutjuni Allahut për mua që të ma lehtësojë shqiptimin e shehadetit. Gjuha e peshores mbizotëron mbi gjuhën time dhe më pengon ta shqiptoj shehadetin, sepse unë nuk i pastroja pluhurat që binin në pjatën e peshores!”<sup>7</sup>

Kur ishte duke shëtitur në shkretëtirat e Jemenit, Xhunejd Bagdadi (Allahu e mëshiroftë), pa një qen gjahu. Ai vuri re se atij i kishin rënë dhëmbët, ndërkohë që putrat me të cilat dikur sulmonte luanët, s’kishin më fuqi. Ai ishte dobësuar dhe bërë si dhëmbër e plakur. Një herë e një kohë ai u vërsulej demave dhe drerëve, ndërsa tani kishte filluar të gjuhej me brirë edhe nga deshët.

Kur Xhunejdi e pa qenin në atë gjendje të mjeruar e të këputur, i dha një copë bukë prej ushqimit të vet dhe me keqardhje për qenin tha këto fjalë:

“O qen! Nuk e di se cili nga ne të dy do të dali

5. - Adhimabadi, Aunu'l-Ma'bud, Bejrut, 1415, VIII, 267-268.

6. - **“La ilahe il-lallah Muhammedu’r-Rasulullah”**

7. - Imam Sharani, Ölüm Kıyamet Ahiret, Bedir Yay, sf. 48.

më mirë nesër. Me sa shoh tani, meqenëse unë jam njeri, jam më i mirë se ti. Mirëpo nuk e di se çdo më sjelli kaderi në të ardhmen! Nëse besimit tim nuk i rrëshqet këmba, do të vë në kokë kurorën e faljes së Allahut Teala. Por nëse më bie veshja e urtësisë që zotëroj, do të jem edhe më poshtë se ty, sepse sado i keq të jetë qenin nuk e çojnë në Xhehenem”.

Ndërsa i nderuari Muhammed Masum Faruki ka thënë:

“Frika për frymën e fundit është një mirësi aq e madhe, saqë të gjithë të dashurit e Zotit janë kapluar nga ajo.”

Besimtari që vazhdimisht bartë në zemrën e tij këtë ndjesi, e jeton jetën e kësaj bote me një kujdes të veçantë, sikur është duke ecur në një fushë të minuar. Me qëllim që banesa e fundit, ku do të arrijë, të jetë si një prej kopshteve të Xhenetit, ai bëhet dëgjuesi më i përshtirshëm i udhëzimit të heshtur të varrezave. Për rrjedhojë ai arrin nivelin e urtësisë që i mundëson të kuptojë se përgatitja për vdekjen nuk është përgatitje e varrit për veten, por përgatitje e vetes për varrin.

\*\*\*

Shejh Ahmed Harbi kishte një komshi të moshuar me emrin Behram, i cili ishte mexhusi, pra adhurues i zjarrit. Një ditë, Ahmed Harbi e këshilloi Behramin në lidhje me besimin. Mexhusiu i moshuar tha:

“O i madhi i myslimanëve! Do të të pyes për tre gjëra. Nëse do mund t’i përgjigjesh, do t’i besoj fesë tënde”.

“Pyet!” -tha shejh Ahmedi.

“Përse e krijoi Allahu njerëzimin? Ai u dha atyre çdo gjë dhe i furnizoi, por përse i vret? E meqenëse i vret, përse i ringjall?” - pyeti Behrami.

Shejh Ahmedi u përgjigj:

“Njerëzimin e krijoi

që ata të njohin ekzistencën dhe njëshmërinë e Tij, të kuptojnë fuqinë hyjnore dhe shfaqjet madhështore. I furnizoi ata që të shohin Furnizimin dhe Mëshirën e Tij. I vret ata, që të njohin Fuqinë absolute të Tij. I ringjall ata, që të njohin Pafundshmërinë e Tij. Shkurtimisht, gjithçka ka për qëllim që ata të kuptojnë se Ai është mbikëqyrësi absolut në çdo ndodhi dhe ngjarje të jetës”.

Kur Behrami i dëgjoji këto, pranoi islam. Mirëpo, papritur shejh Ahmed Harbi u frikësua jashtë mase dhe i ra të fikët. Kur erdhi në vete e pyetën:

“Ç’është ndodhi o shejh?”

“Dëgjova një zë që më tha: Behrami ishte një mohues që adhuronte zjarrin tash e shtatëdhjetë vjet dhe tani u bë mysliman. Ndërsa ti je mysliman tash e shtatëdhjetë vjet, por a e di se çdo të bëhet me ty në frymën e fundit?!.. (Tedhkiretu’l-Evlia, fq. 97.)

Prandaj duhet që çdo frymë tonën ta harxhojmë në mënyrë të atillë që çasti ynë i fundit në këtë botë të jetë si mbas pritshmërive. Përveç kësaj, që të arrijmë shpëtimin e përjetshëm, ne duhet që gjithmonë të kërkojmë strehim tek mëshira e Allahut, e jo t’i besojmë vetëm punëve tona të mira dhe rrugës së drejtë që ndjekim.

Në një hadith fisnik thuhet:

*“Dikush për një kohë të gjatë bën punë që të shpien në Xhenet, më vonë fillon të punojë vepra që të shpien në Xhehenem.*

*Ndërsa një tjetër, për një kohë të gjatë bën punë që të shpien në Xhehenem, më vonë puna e tij përfundon me një vepër që të shpie në Xhenet”.* (Muslim, Kader, 11)

\*\*\*

Osman (r.a.) ka thënë:

“Një besimtar i vërtetë bart gjashtë lloje frikash:

1. Frika se mos i merret besimi prej Allahut të Madhëruar.



2. Frika se mos melekët shkruajnë gjërat të cilat do ta turpërojnë atë në ditën e Kiametit.

3. Frika se mos shejtani i mallkuar ia çon veptrat dëm.

4. Frika se mos kapet në mënyrë të papritur dhe të papërgatitur nga meleku i vdekjes, Azraili.

5. Frika se mos nuk arrin të merret mjaftueshëm me përmendjen e Allahut të madhëruar për shkak të dhënies së tepërt pas familjes.

6. Frika se mos mburret me mirësitë që ka në këtë botë dhe mbetet indiferent ndaj botës tjetër.”

Lidhur me këtë çështje, Allahu i Madhëruar na bën të ditur se si duhet të kërkojmë strehim tek Ai, duke na mësuar këtë dua:

**“O Zoti ynë! Mos lejo që zemrat tona të shmangen (nga e vërteta), pasi na ke udhëzuar në rrugën e drejtë, dhe jepna mëshirë prej Teje; vërtet, Ti je Dhuruesi i Madh!”** (Al-i Imran, 8.)

\*\*\*

I Dërguari i Allahut, (a.s.), bënte shpesh një dua të tillë:

*“O Allahu im, që i kthen zemrat nga një gjendje në tjetrën! Bëje zemrën time të qëndrueshme në fenë Tënde!”*

Madje, kur Enes ibn Maliku (r.a.) e pyeti:

“O i Dërguar i Allahut! Ne të kemi besuar ty dhe fesë që ke sjellë ti. Mos ndoshta keni frikë se po na ndryshon besimi?”,

Profeti (a.s.), u përgjigj:

*“Po! Zemrat janë midis gishtave të Allahut dhe ai i rrotullon ato si dëshiron.”* (Tirmidhi, Kader, 7/2140.)

\*\*\*

Një çështje tjetër, është edhe mendimi i mirë që duhet të ketë robi në lidhje me Allahun e Madhëruar. Lidhur me këtë, Xhabir ibn Abdullah (r.a.) ka thënë:

“Tre ditë para se ai të ndërronte jetë, e dëgjova të Dërguarin e Allahut, (a.s.), të thoshte:

*«Çdonjëri prej nesh duhet të vdesë me mendim të mirë për Allahun (jo në mënyrë tjetër)!»* (Muslim, Xhennet, 82; Ebu Daud, Xhenaiz, 12-13/3113.)

Po ashtu, është transmetuar edhe një hadith kudsij, ku Allahu i Madhëruar ka lajmëruar:

**“Unë jam ashtu siç mendon robi Im për mua. Unë jam aty ku ai më përmend.”** (Buhari, Teuhid, 15, 35; Muslim, Teube, 1.)

Të ushqesh mendim të mirë për Allahun, do të thotë të kërkohesh mëshirën dhe bujarinë e Tij, të mos i këpusësh kurrë shpresat prej mëshirës së pafundme dhe ndihmës së Tij, të shpresosh

se Ai do të të trajtojë me falje dhe mëshirë, e madje të besosh pa asnjë dyshim se do të arrish lumturinë në botën tjetër. Mirëpo, për realizimin e kësaj, është e domosdoshme që njeriu të zotërojë “besim” dhe “vepra të mira e të sinqerta”. Përmendja e besimit dhe e veprave të mira, pranë njëra-tjetrës në shumë ajete të Kuranit, tregon qartë domosdoshmërinë e zotërimit nga njeriu të të dyja këtyre elementeve.

Një njeri që bart në vete shpresën se do të shohë mirësi, mëshirë dhe falje prej Allahut të Madhëruar dhe përpiqet me sa ka mundësi

të çojë në vend të gjitha detyrat e tij të devotshmërisë, do ta gjejë Allahun ashtu siç e pret. Po kështu, edhe ai që pret të kundërtën prej Allahut, atë do të gjejë.

Le ta përfundojmë këtë temë me këtë lutje të sinqertë të Ebu Bekrit (r.a.):

“O Zoti im! Fundi i jetës, qoftë periudha më e mirë e jetës sime, përfundimet qofshin pjesa më e mirë e punëve të mia dhe dita që do takohem me Ty, qoftë dita më e mirë e ditëve të mia!” (Sujuti, Tarihu’l-Hulefa, fq. 103.)

Amin!..



**“O Zoti ynë!  
Mos lejo që zemrat  
tona të shmangen (nga  
e vërteta), pasi na ke  
udhëzuar në rrugën e  
drejtë, dhe jepna mëshirë  
prej Teje; vërtet, Ti je  
Dhuruesi i Madh!”**

*(Al-i Imran, 8.)*



# EL-HALIM

AFATIZUESI

— Ilir Hoxha —

Jetojmë në epokën e krimeve që kryhen për një zemërim të çastit dhe të jetëve që përmbysen për ambicie kalimtare. Epoka e ushqimit, zemërimit dhe kërkesave të tepërta... Epoka e atyre që përzihen në çdo fjalë, që flasin për çdo çështje dhe që shkojnë me vrap në çdo grindje, në çdo manifestim dhune, në çdo hakmarrje... Sigurisht që ky kalim kufijsh nuk është vetëm cilësi e kësaj epoke. Ky është mentaliteti që ka prodhuar të gjithë faraonët dhe nemrudët e çdo epoke kur njeriu ka pandehur se ka kuptuar/njohur gjithë ekzistencën dhe ka humbur frikë-respektin ndaj Zotit dhe nevojën për të kontrolluar veten.

Në këtë epokë, ku vetëbesimi i rremë lind prej pandehmës se dimë gjithçka, edhe pse dija jonë pakësohet, ku flitet kot pa asnjë lloj kompetence dhe ku udhëhiqet në bazë të forcës në mënyrë faraonike dhe të dhunshme, kemi shumë nevojë për kuptimin e emrit Halim, i cili përmban qetësinë, paqen, largpamësinë dhe respektin ndaj qenies njerëzore! Emri el-Halim, është një prej emrave hyjnor në të cilin spikatet më tepër vlera që i jepet njeriut dhe besimi që ndjehet tek ai në lidhje me përmirësimin dhe korigjimin e vetvetes. Kjo, sepse Halim do të thotë, “të sillesh me durim dhe maturi, të mos veprosh me nxitim dhe zemërim dhe të lësh mundësi për zhvillimet që do të ndodhin në të ardhmen”.

Komentuesit e Emrave të Allahut (Esmau'l-Husna), shpjegojnë se ky emër shpreh, “Atë që është falës dhe largpamës i madh dhe që nuk zemërohet dhe nuk nxitet duke u ndikuar prej sjelljeve të pavenda të injorantit dhe rebelimit të padrejtë të të pabindurit”. Ky emër shpreh tolerancën e Zotit tonë

të Madhëruar kundrejt gabimeve që janë rezultat i paevitueshëm i të genit njeri.

Njësoj siç tregohet në ajetin 155 të sures Al-i Imran, ku Allahu i Madhëruar shprehet se nuk do t'i ndëshkojë luftëtarët që me instinktin për t'u mbrojtur, u hapërdanë dhe e braktisën Profetin (a.s.), në fushëbetejën e Uhudit...

Kjo cilësi e Zoti tonë, tregon se Ai, edhe pse është mbrojtësi i të drejtave të të dhunuarve dhe hakmarrësi ndaj dhunuesve, nuk vepron me nxitim si udhëheqësi i padurueshëm që ndërhyr për çdo rast, por veprohen brenda realitetit të jetës që thurin përpjekjet dhe zgjedhjet personale të njerëzve. Në këtë mënyrë, Allahu i jep kohë të padrejtisë të pendohet dhe të përmirësohet. E gjithë kjo, shpreh besimin që tregohet ndaj mirësisë që bart njeriu në vetveten e tij dhe mundësinë që i jepet. Nëse do të ndodhte e kundërta dhe Allahu do t'i ndëshkonte njerëzit në çast për të gjitha ato që bëjnë, siç shprehet edhe Kur'ani Fisnik, në sipërfaqen e tokës nuk do të mbetej asnjë gjallesë dhe jeta do të shuhej brenda një kohe shumë të shkurtër. (shih. Nahl, 61; Fatir, 45.)

Mirëpo, të abuzosh me tolerancën dhe afatizimin hyjnor, mund të bëhet shkak i një humbjeje të pakthyeshme. Prandaj, është shumë e domosdoshme të mos harrohet për asnjë çast se emri Halim i Zotit tonë, shpreh afatin kohor që na është mundësuar për të korigjuar gabimet tona dhe për t'u përmirësuar.

Në Kur'anin Fisnik, emir Halim është përdorur gjithmonë i bashkëshoqëruar me emrat Gafur, Alim, Gani dhe Shekur. Ky lloj përdorimi, jo vetëm që





shpjegon më së miri kuptimin e këtij emri, por i shton atij thellësi dhe pasuri. Siç do të kuptohet edhe nga analizimi i ajeteve përkatëse, në vendet ku emri Halim është përdorur bashkë me emrin Gafur, bëhet fjalë për disa gjynahe të robërve dhe thuhet se këta gjynahqarë nuk do të ndëshkohen menjëherë, por do t'u jepet kohë për t'u kthyer (penduar). (shih. Bekare, 235; Al-i Imran, 155; Maide, 101; Isra, 44; Fatir, 41.) Ndërsa në ajetet ku është përdorur bashkë me emrin Alim, na bëhet e ditur se gjykimet dhe vendimet e Allahut të Madhëruar bazohen në dijen dhe drejtpeshimin e Tij hyjnor dhe se pavarësisht se Allahu njeh çdo sekret që ruhet në zemra, Ai vepron me durim dhe maturi. (shih. Nisa, 12; Haxh, 59; Ahzab, 51.)

Ajetet ku emri Halim është përdorur i shoqëruar me emrin Gani, janë ajete në të cilët trajtohen çështjet ekonomike dhe shpenzimet për hir të Allahut pa prituri asgjë në këmbim. (shih. Bekare, 63.) Kurse në ajetet në të cilët përdoret menjëherë pas emrit Shekur, thuhet se ata të cilët japin para borxh do të shpërblehen pamasë nga Allahu i Madhëruar. (shih. Tegabun, 17.) Në mënyrë të veçantë, këto dy përdorime të fundit të emrit Halim, tregojnë se përveç kuptimit të “tolerimit dhe mos zbatimit të menjëhershëm të dënimit për ata që e meritojnë”, është edhe kuptimi “i shpërblimit me bujari të mirësive që bëhen dhe sjelljeve të virtytshme, pa llogaritur disa mangësi të tyre”.

Nëse cilësia hyjnore Halim, nuk manifestohet tek dikush, nuk mund të bëhet fjalë për moral të bukur. Kjo, sepse për të qenë falës, tolerant, mirëkuptues, durimtar, besnik, bujar, i drejtë dhe i matur, duhet të gëzosh moralin e emrit hyjnor Halim.

Kur Ibrahim (a.s.), iu lut Allahut, **“Zoti im! Më fal një (fëmijë) prej të mirëve!”**, Ai përgjigjet duke thënë: **“Dhe Ne e përgëzuar atë me një djalë halim (të urtë, të butë...)”**. (shih. Saffat, 100-101.) Nisur nga ky fakt, dijetarë Islamë janë shprehur se cilësia halim është kusht për të qenë prej të mirëve.

Fjala “hilm” që rrjedh prej së njëjtës rrënjë me emrin “Halim” dhe ka kuptimin e përmbajtjes nga

zemërimi, në ajetin 32 të sures Tur, është përdorur në kuptimin e “mendjes”. Nisur nga kjo, mund të themi se thelbi i “hilm-it” është mendja. Përmbajtja nga zemërimi kërkon një forcë të madhe personaliteti dhe një mbizotërim të lartë të mendjes dhe ndjenjave. Sipas mistikëve, njeriu tek i cili manifestohet emri hyjnor el-Halim, është çliruar prej presioneve të egos së tij dhe ai ka shpallur pushtetin mbi veten e tij. Ai nuk kaplohet prej hidhërimit të thellë përballë fatkeqësive, sepse shpesh herë, hidhërimi i tepërt është rezultat i zemërimit të madh dhe dyshimit në caktimin e Allahut.

Ai që e beson se Allahu është Halim, e di se njerëzit nuk do të lihen pa u ndëshkuar për të këqijat që bëjnë dhe se Zoti më parë dëshiron t'u japë atyre kohë të kuptojnë gabimin e të pendohen dhe të përmirësohen. Kështu, ai nuk mashtrohet me këtë afat që i ka dhënë Allahu, duke e humbur këtë mundësi. Po ashtu, edhe ai sillet në të njëjtën mënyrë me të tjerët. Pa u dhënë atyre mundësinë për t'u përmirësuar dhe për të korigjuar gabimet, nuk i pret lidhjet me askënd për shkak të sjelljeve të tyre. Të qenit i pajisur apo jo me moralin e emrit hyjnor Halim, nuk duket atëherë kur çdo gjë është e qetë dhe të gjithë respektojnë njëri-tjetrin, por atëherë kur ndihesh i sulmuar dhe përballesh me sjellje të këqija.

Emri hyjnor Halim, është manifestuar më së shumti tek profetët. Kjo, sepse ata e kanë pasur të domosdoshme të pajisen me këtë moral për shkak se duhej të përballeshin me njerëz të paditur e inatçinj dhe t'i drejtoheshin shoqërive të përbëra nga lloj-lloj tipash njerëzor. Për rrjedhojë, edhe edukuesit që kanë për detyrë të edukojnë dhe zhvillojnë njerëzit kanë nevojë për pajisjen me moralin e këtij emri të Allahut të Madhëruar.

Ata që i përdhosin të drejtat e njerëzve dhe kanë ndërtuar një sistem padrejtësie e dhune në tregti dhe politikë, njerëzit e drejtë dhe të durueshëm i konsiderojnë si të mjerë dhe tallen me ta. Mirëpo, ata që do të fitojnë në fund, janë njerëzit që nuk i lidhin reagimet e veta me sjelljet e të tjerëve ndaj tyre dhe e ruajnë maturinë morale. (En'am, 135.)



# Gruaja

## nga këndvështrimi i ajetit 35 të sures “El-Ah’zab”

— Imam Muhamed Sytari —

“Nuk ka dyshim se për myslimanët e myslimanet, besimtarët e besimtare, adhuruesit e adhurueset, të sinqertit e të sinqertat, durimtarët e durimtare, të përlururit e të përlururat, mirëbërësit e mirëbërëset, agjëruesit e agjërueset, ruajtësit e nderit e ruajtëset e nderit, shumëpërmendësit e Allahut e shumëpërmendëset e Allahut, Allahu ka përgatitur falje (gjynahesh) dhe shpërblim të madh!”<sup>1</sup>

Imam Ebu Mensur El-Maturidi (v. 333 h.), në tefsirin e tij të këtij ajeti sjell edhe shkakun e shpalljes së këtij ajeti, që përbën në vetvete një ndër kulminacionet më të spikatura të historisë shekullore të qytetërimeve njerëzore në trajtimin e gruas dhe lartësimin e pozitës së saj!

Thotë, bazuar mbi transmetime<sup>2</sup> të shumta (të verifikuara): [Umu Seleme (r.a.), bashkëshortja e Resulullahut (a.s.), bashkë me një grua të quajtur Nusejbe bintu Ka’b, erdhën tek i Dërguari i Allahut (a.s.) dhe i thanë: “O i Dërguar i Allahut, pse Zoti ynë i përmend për të mirë burrat në Kuran dhe nuk i përmend fare gratë?”. Me këtë rast, u shpall ajeti: “Nuk ka dyshim se për myslimanët e myslimanet...”].<sup>3</sup>

Imam Razi, teksa komenton këtë ajet kuranor, thekson: “Pasi Allahu i urdhëroi, i ndaloi dhe i shpjegoi se çfarë shpërblimi do të kenë, i përmendi grave dhjetë shkallë: **e para**: Islami dhe nënshtrimi ndaj urdhrorit të Allahut. **E dyta**: Imani (besimi) në atë që vjen nga ana e Allahut... Pastaj, Allahu i Madhëruar tha: “shumëpërmendësit e Allahut e shumëpërmendëset e Allahut”, pra ata, në të gjitha këto gjendje, ata e përmendin Allahun, duke bërë që Islami i tyre, besimi i tyre, adhurimi i tyre, sinqeriteti i tyre, durimi i tyre,

përlujta e tyre, mirëbërja e tyre dhe agjërimi i tyre, të jenë me njet të sinqertë për Allahun! ... Sepse krejt saktësia e krejt veprave realizohet me përmendjen e Allahut të Madhëruar, që është **nijeti**”.<sup>4</sup>

Mjafton ky ajet, për të dëshmuar madhësinë e Islamit në trajtimin elitare të gruas në jetë, plot dinjitet e nderim, plot përlujta e përkujdesje; që, parë në hapësirat e thirrjeve të teksteve të shumta kuranore dhe atyre të Resulullahut (a.s.), na frymëzojnë përherë e më shumë drejt përhapjes së tyre në shoqëri, me bindjen absolute se në to gjendet shërimi i plotë i sëmundjeve bashkëkohore, që e kanë dobësuar deri në shkatërrim, cilësinë e jetës mbi tokë, si pasojë e prishjes dhe imoralitetit, shthurjes dhe çlirimit nga përgjegjësitë në jetë!

Përtej të gjitha leximeve dhe interpretimeve, njerëzimi nuk do të gjejë si Islami; Kurani dhe Tradita e Muhamedit (a.s.) në trajtimin e femrës; si bijë, si nënë, si bashkëshorte, si motër, si edukatore; të nderuara e të respektuara!

Këtu më vjen ndër mend një fragment nga një publikim i hershëm në revistën “Zani i Naltë”, ku ndër të tjera theksohet: “Sa herë që evoluzioni i Kombit t’onë pengohet dhe kushedi për ç’arsye nuk shpejton përpara, dalin disa oksidentalofilë dhe si shkaktar të këtij mos përparimi akuzojnë groën muslimane që nuk zbulohet. Gruaja me perde e çarçaf qenka pengimi i mos përparimit t’onë!

...

Përse akuzohet perdeja e çarçafi si pengim përparimi? Grát e krishtene janë të zbulueme; grát fshatare që të gjitha janë të zbulueme; grát korçare janë zbulue; gjinokastritët janë zbulue; edhe shumë gra të kryeqytetit zbulue. Ç’është rezultati? Ç’rol luejti zbulimi i këtyne grave në përparimin t’onë? Ne shqiptarët hala s’e kemi bërë definicionin e përparimit. Me zbulue gratë nuk është punë e vështirë. Puna e vështirë është me i prurë grát n’atë gjendje që t’a çmojnë detyrën e tyre.

1. Kurani, El-Ah’zab: 35.

2. Imam Neseftu (v. 710 h.), në tefsirin e tij shënon: [Ndërkohë që për gratë e të Dërguarit (a.s.) u shpallën disa ajete, gratë e myslimanëve thanë: “Po për ne nuk qenka shpallur asgjë?!” Me këtë rast u shpall: “Nuk ka dyshim se për myslimanët e myslimanet” ] Për më shumë, mund të shihet: Ebul-Berekat Abdullah ibn Ahmed ibn Mahmud En-Nesefti, *Tefsirin-Nesefti*, botimi i shtatë, Damask, 2017, vëll. 3, f. 30.

3. Imam Ebu Mensur El-Maturidi, *Te’vilatu Ehli-Sunne*, botimi i parë, Liban, 2005, vëll. 8, f. 384-385.

4. Imam Fekhruddin Er-Razi, *Et-Tefsirul-Kebir*, botimi i parë, Bejrut, 1990, vëll. 25, f. 182.

Thohet se feja islame e pengon groën shqiptare qi të përparojë. Po pse s'na diftohet se ç'e pengon gruën e Shalës, atë të Mirditës e atë të Shpatit të Elbasanit e të tjerat qi s'janë muslimane?

Tue i gjykue punët në kët pikpamje né jemi të mendimit se nuk është feja islame qi e pengon groën nga përparimi. Sëmundja është gjetiu...<sup>5</sup>

Shihni se si trajtohet femra në shoqëritë e sotme materialiste dhe se si ky model dekadent, po tentohet të katapultohet dhunshëm edhe në realitetet shqiptare, nëpërmjet përpjekjeve të ndryshme që bëhen drejt "çlirimit të femrës" në shoqëritë e hapura, "lirisë absolute" në shoqëritë moderne, e të ngjashme!? Të gjitha këto përpjekje të dëmshme dhe lajkatare, duan të shkatërrojnë tabanin e shëndoshë, që bazohet mbi edukimin fetar të vajzave, motrave, nënave e grave!

"Shkurt mund të thuhet se Kurani me principet udhërrëfyese të vetat, femnen e mashkullin e ka bamë qi të bashkohen në fushën e drejtësisë e të barazimit me të drejta të njajta. Dmth, mashkullin e ka zbritë nga pozita dhunuese e tiranike dhe femnen e ka naltue nga pozita e poshtrimit"<sup>6</sup>, siç shkruhet edhe në shtypin tonë islam të vitit të largët 1930!

Por, ajo që është më e rëndësishme për t'u përmendur në këto kontekste, është se cila është detyra e imamëve, vaizeve, thirrësve islamë në drejtim të thirrjes me urtësi e largpamësi, larg tendencave të ekstremizmit dhe leximit të cungët të teksteve dhe fetvave, që shpesh kanë ndikuar në etiketimin e fesë islame me çfarë nuk e meriton dhe me çfarë nuk është në realitet!

Ku jemi në drejtim të përhapjes së mësimave qytetëruese të fesë tonë dhe edukimit fetar të brezit të ri, në realitetet e mungesës së lëndës së edukatës fetare në shkollat e vendit tonë, si dhe përtej demagogjisë së premtimeve elektorale dhe tendencave të përhapjes së ateizmit dhe afetarizmit, edhe nëpërmjet tribunave politike dhe ithtarëve të rinj të frymërave të reja që e duan shoqërinë njerëzore larg besimit dhe fesë, larg disiplinës së besimit dhe përkushtimit ndaj Fjalës së pandryshuar të Zotit; Kuranit Famëlartë, si garanci e padiskutueshme dhe krejtësisht e mundshme për ndreqjen e asaj që dekada e shekuj kanë prishur në jetën e njeriut!

Imam Shihabuddin El-Alusi (v. 1270 h.), përmend një detaj me rëndësi në shpjegimin e ajetit të lartpërmendur, thotë: ["*muslimanët dhe muslimanet*", dmth, ata që kanë hyrë në botën e paqes, të nënshtuarit ndaj ligjit të Allahut të Madhëruar, ata që ia kanë dorëzuar jetën e tyre Allahut të Madhëruar, burra a gra qofshin].<sup>7</sup>

5. Artikulli me temë: "Zbulimi i Grues Muslimane", në revistën "Zani i Naltë", vjeti XI, Maj 1936 - Sefer 1355, nr. 5, f. 143.

6. Artikulli me temë: "Grueja duhet të respektojë Kuranin më tepër se mashkulli", në revistën "Zani i Naltë", vjeti VI, Dhilixhe 1348 - Majë 1930, nr. 6, f. 1027.

7. Imam Shihabuddin El-Alusi, *Rruhul-Meani*, botimi i 4-t, Liban, 2014, vëll. II, f. 201.

Këtë duhet të synojmë me krejt përpjekjet tona në proceset e edukimit të brezit të ri, nëpërmjet vaseve, hytbeve, takimeve sporadike, ligjëratave, tribunave fetare, në medrese, në mejtepe, në gazeta, në revista, nëpërmjet rrjeteve sociale, emisioneve radiofonike, atyre televizive dhe me krejt mundësitë legjitime që na janë dhënë në këtë kohë! Nuk duhet të ndalemi për asnjë moment dhe aq më tepër të stepemi përballë propagandave të mbështetura nga faktorë të huaj dhe axhenda të përgatitura kushedi se ku, që vijnë të gatshme dhe gjejnë terren të përshtatshëm për vegjetimin e tyre tek individë të dobët të kësaj shoqërie dhe çdo shoqërie në botë!

Duke iu rikthyer ajetit të 35 të sures Ah'zab, në librat e tefsirit gjejmë se: "Allahu i Madhëruar, nëpërmjet këtij ajeti deshti të na vërtetojë se gruaja është njësoj si burri në obligime dhe në vlerësim; ajo është e ngarkuar me Islam, me besim, me adhurim, me durim, me përlulje, me mirëbërje, me agjërim, me ruajtje të nderit e me përmendjen e shumtë të Allahut, njësoj si burri. Kjo vërteton edhe një herë ajetin kuranor: "Kush bën një vepër të mirë, qoftë mashkull ose femër, e duke qenë besimtar, Ne do t > i japim atij një jetë të mirë (në këtë botë), e (në botën tjetër) do t > u japim shpërblimin më të mirë për veprat e tyre"<sup>8</sup>... Madje femra besimtare ka një pozitë të lartë tek Allahu, më të lartë se ajo e njëmijë burrave të shtthurur! Gruaja e bindur është e afërt me Allahun, ndërsa burri i shtthurur, larg Tij! Prandaj, mashkulli dhe femra, burrat dhe gratë, të rinjtë dhe të rejat, vajzat dhe djemtë, të gjithë janë të barabartë tek All-llahu, asnjëri nuk qëndron më afër, përveç se nëpërmjet adhurimit ndaj Tij!"<sup>9</sup>

Për fund të këtij vështrimi të shpejtë, iu ktheva librit të famshëm të Hoxhës tonë Vehbi S. Gavoci, "Gruaja muslimane". Në botimin e tetë të tij, gjeta edhe këtë shënim thelbësor: "Islami e ktheu gruan në natyrën e saj të origjinës, në të cilën e krijoi All-llahu. Islami e ktheu gruan në udhëzimin, që All-llahu i Madhëruar ia zbriti njeriut të parë, Ademit (a.s.), për të mirën e njerëzimit! Sepse Islami është ide dhe sistem, Islami është e vërtetë dhe udhëzim dhe, nuk është lidhur ndonjëherë ideja e saktë, duke qenë ide e saktë, me kohën, sepse ajo qëndron mbi kohën! As është lidhur ndonjëherë e vërteta, duke qenë e vërtetë, me kohën, sepse ajo qëndron mbi kohën!

A nuk e ke parë të vërtetën, besën, turpin, dashamirësinë ndaj njerëzve, solidaritetin në të mirë, bindjen ndaj udhëheqësit në të mirë, etj.; të gjitha këto janë çështje të vjetra dhe edukatë e kaluar, porse ato sundojnë çdo kohë dhe qëndrojnë mbi çdo kohë, sepse koha është enë dhe shfaqje, ndërsa e vërteta – **Islami është e vërteta** – ajo është origjina dhe thelbi!"<sup>10</sup>

8. Kurani, En-Nahl: 97.

9. Dr. Muhammed Ratib En-Nabulsi, *Tefsirun-Nabulsi*, botimi i parë, Aman, 2016, vëll. 7, f. 294.

10. Vehbi Sulejman Gavoci, *El-Mer'etul-muslima*, botimi i 8-të, Damask, 1999, f. 31-32.

# Zgjidhja për ndihmë ndaj individit, shoqërisë, umetit dhe njerëzisë gjendet në përsheptje

— M. Ali Eshmeli —

Kurdo që njerëzimi është bërë pre e interesave dhe e dëshirave të nefsit, atëherë është bërë edhe agresive dhe barbare. Ajo kështu ka ndarë të njëjtin rol me shejtanin e mallkuar. Madje, e ka tepruar edhe më shumë. Si rezultat, doli Nemrudi dhe tha: “... (Edhe unë jam zot.) **Edhe unë mund të jap jetë e të shkaktoj vdekje...**” (Bakara, 258) Doli Faraoni dhe i: “**Tuboi njerëzit e u deklaroi: “Unë jam zoti juaj më i lartë!”** (Naziati, 23-24) Doli Karuni dhe tha: “**...Kjo më është dhënë vetëm prej diturisë sime...**” (Kasas, 78)

Çfarë nuk kanë bërë dhe çfarë nuk kanë thënë. Edhe pse një fjalë e urtë thotë: “Ha kafshatë të madhe, por mos fol me fjalë të mëdha!” – ata që nuk dëgjojnë dhe nuk marrin mësim nga e kaluara, vazhduan të bëheshin hallka të reja të të njëjtit gabim. Ata formuan rrugë të ndryshme dhe guxuan të bënin punë çnjerëzore për t’i arritur qëllimet e tyre. Ata u bënë mosmirënjohës e mashtrues dhe u zhytën në ligësi. U bënë dinakë dhe e shndërruan në profesion dinakërinë e mashtrimin. Gjithmonë shkaktuan luftëra, i vranë dhe i prenë njerëzit vetëm e vetëm për të qëndruar në pushtet. Ata dhanë çdo gjë të tyre për këtë. Pastaj e tepruan aq shumë sa që deklaruan se ishin zota. Gjithashtu pohuan se ishin edhe pejgamberë. Kur nuk i arritën dot ato që dëshironin, u tërbuan. Pastaj u mburrën, u hoqën si të mëdhenj dhe krenarë me ato që bënë. Ata bënë çdo lloj agresiviteti dhe barbarizmi në këtë rrugë. Allahu Teala thotë për këta në Kuranin Fisnik:

**“Pikërisht këta janë ata që kanë këmbyer udhëzimin me humbjen, kështu që tregtia atyre nuk u solli kurrfarë dobie dhe as nuk ishin të udhëzuar në rrugën e drejtë.”** (Bakara, 16)

Sytë e tyre u verbëruan kundrejt dritës që do t’ju bënte dobi. Ndërsa veshët iu shurdhuan kundrejt fjalës hyjnore. Secili prej tyre u bë prej të poshtëruarve. Të gjithë u rrëzuan dhe u kapluan nga

dobësia më e madhe. Njëri prej tyre u mposht nga një mushkonjë topalle, dikush u përpi nga dheu dhe dikush tjetër u mbyt në ujë.

Ata jetuan larg dhe të shkujdesur ndaj Zotit dhe përsheptjes. Kjo u bë shkak për shkatërrimin e tyre në këtë botë dhe në botën tjetër. Ata që ia vunë veshin thirrjes hyjnore, morën mësim. Ndërsa ata



që i mbyllën sytë ndaj mesazhit hyjnor dhe e lanë në harresë, përsëritën të njëjtat gabime. Tani edhe bota që po globalizohet po shfaq përsëri të njëjtat gabime dhe injorancë. Siç kanë qenë të djeshmit fatzinj, ashtu janë edhe të sotmit. Ata qëndruan larg Rrahmanit dhe afër shejtanit. Qëndruan larg drejtësisë e mëshirës dhe pranë zullumit e poshtërsisë. Qëndruan larg përshpirtjes e njerëzillëkut dhe ia dedikuan jetën e tyre adhurimit të interesave dhe barbarizmit. Qëndruan larg shpëtimit e prehjes shpirtërore dhe merituan humbjen e ndëshkimit.

Kur njeriu privohet nga cilësitë e virtytshme dhe edukimi shpirtëror, për fat të keq, kërkon vetëm shkatërrimin e vet. Vetëm për shkak të kësaj gjithmonë ka ngjarje tragjike dhe të tmerrshme ndërmjet individëve, familjeve, shoqërive dhe popujve. Në dorën e kujtdo që të jetë fuqia, klithmat dhe britmat që i shkakton mendimi se i forti është në të drejtë po dëgjohe në çdo vend të botës. Çfarë nuk shkatërrojnë sulmet, urrejtjet e pafundme, barbarizmat dhe padrejtësitë e atyre që janë tepër të pasur dhe që janë të privuar nga aspekti shpirtëror? Ja pra, u bënë dy shekuj që në gjeografinë islame po shkatërron historia, civilizimi, bibliotekat, po shemben monumentet, po vriten foshnjat, po vriten nënat, po prishen vatrat dhe po shkatërrohet çdo gjë prej qafirëve dhe një dore shkatërrimtare. Të gjithë njerëzit po përfetojnë tmerr. E gjitha kjo sepse njeriu ka nevojë për edukim.

Njeriu ka nevojë për edukim shpirtëror, jo për edukim djallëzor. Ai ka nevojë për një edukim shpirtëror që do ta bëjë të jetojë sipas rregullave në dobi të njerëzimit. Ky edukim është disiplina, mësimi dhe kalitja shpirtërore. Pra, është edukimi mistik Islam, sepse ky lloj edukimi i ka gjuhëzuar në derën e të vërtetës edhe mbretërit më të fuqishëm të botës dhe i ka bërë ata jo tiranë kundrejt popujve të tyre, por monumente mëshire dhe veçanërisht personalitete të larta. Në sajë të këtyre, bota dëshmoi për shekuj me radhë mëshirë, drejtësi dhe prehje shpirtërore. Ligësitë u mposhtën. Për këtë arsye, ato nuk mundën t'i shkatërronin muret e mirësisë dhe mëshirës. Por siç e sulmojnë shëndetin mikrobet sapo të gjejnë mjedisin e përshtatshëm, edhe ata që përbëjnë palën negative, si domosdoshmëri e sprovës hyjnore

mbi sipërfaqen e tokës, gjithmonë janë përpjekur ta prishin njerëzimin sapo u është dhënë shansi i parë. Format më të tmerrshme të këtyre aksioneve me mikrobe janë qasjet që shfaqen sikur të jenë me të vërtetën, por që në realitet përpiqen t'ia shkatërrojnë aspektin shpirtëror njeriut dhe ta shndërrojnë atë plotësisht në një krijesë materialiste.

Veçanërisht këtu dëshirojmë të theksojmë edhe armiqësinë ndaj përshpirtjes. Kur këtë e bëjnë jobesimtarët, është normale, por kur të diturit e shkujdesur zënë vend në të njëjtin rresht me jobesimtarët kundër përshpirtjes, atëherë kjo është një humbje e madhe dhe e dhimbshme. Edhe përdorimi i materialeve fetare për t'ia tharë dhe shkatërruar njeriut aspektin shpirtëror, është diçka mjaft e çuditshme. Pra, është diçka dredharake sikur

dëshiron ta bësh njeriun ateist duke i thënë: Ky është besimi më i drejtë! Prandaj duhet të pyesim:

Përpjekja për ta shkatërruar devotshmërinë, edukatën, urtësinë dhe përshpirtjen që Islami dëshiron t'i ndërtojë te njeriu, mos vallë është një miqësi me zemër të hapur apo një armiqësi e fshehtë me zemërngurtësi? Mos vallë është një punim akademik i pranueshëm apo aktiviteti i një injorance dinake dhe disfatizëm? Mos vallë është edukim shkatërrimi i ndërtesës së paqëndrueshme të besimit të nxënësve me dinamitin e dyshimit krejt pa vend dhe pa e ndjerë ata? Mos vallë nxjerrja e të vërtetës në pah, njohja e së drejtës dhe përfaqësimi i saj është veprimtaria për ta këputur si me sëpatë këtë lidhje të dobët të brezit të sotshëm që ka me Allahun dhe

Pejgamberin për shkak të atyre që kanë bërë jobesimtarët? Çfarë shpreh mendimi për ta thyer timonin për shkak të shoferit të dobët, apo mendimi për t'i shkatërruar mihrabet për shkak të një imami që gabon, apo mendimi për t'i thyer lapsat dhe grisur letrat për shkak të një piktore të shëmtuar? Qëllimi nga kjo është mjaft i qartë. Për këtë arsye, sot ndjehet nevoja për përshpirtje më shumë se kurrë. Veçanërisht devotshmëria, siç ka qenë gjithmonë, edhe në ditët e sotme është shumë e domosdoshme. Mbi të gjitha është e domosdoshme për botën e dijes/shkencës. Përndryshe njeriu largohet nga Allahu Teala. Ai largohet nga Zoti (xh.xh.), sado i ditur që të jetë. Pra, largohet nga Allahu i



*Kur njeriu privohet nga cilësitë e virtytshme dhe edukimi shpirtëror, për fat të keq, kërkon vetëm shkatërrimin e vet. Vetëm për shkak të kësaj gjithmonë ka ngjarje tragjike dhe të tmerrshme ndërmjet individëve, familjeve, shoqërive dhe popujve. Në dorën e kujtdo që të jetë fuqia, klithmat dhe britmat që i shkakton mendimi se i forti është në të drejtë po dëgjohe në çdo vend të botës.*



Lartësuar siç është larguar shejtani i mallkuar. Ndërsa shkaku i vetëm i këtij largimi është egoizmi... Pra, kanceri shpirtëror që është kusht për t'iu hequr nga njeriu. Për këtë arsye, kjo çështje në mistikën islame është njëra prej temave bazë të edukimit të njeriut, sepse egoizmi është një çengel i shejtanit që e pengon robin për t'iu afruar Allahut Teala. Ja pra, edhe shejtanin, krahas gjithë asaj dijeje që kishte, mikrobi i egoizmit e shkatërroi. Për këtë

*Njeriu ka nevojë për edukim shpirtëror, jo për edukim djallëzor. Ai ka nevojë për një edukim shpirtëror që do ta bëjë të jetojë sipas rregullave në dobi të njerëzimit. Ky edukim është disiplina, mësimi dhe kalitja shpirtërore.*



arsye, edukimi shpirtëror është një urdhër hyjnor i ardhur pikërisht nga Allahu, xhel-le xhelaluhu, për të nxjerrë nga zemra dhe jeta çdo lloj të egoizmit negativ dhe të gjitha ndikimet e tij.

Praktika më e qartë e kësaj është kurban, sepse kurban nuk është vetëm çështje e therjes së kafshës. Kurban, para therjes së kafshës, ka anën e edukimit hyjnor që përjetohet nga besimtari. Ky edukim formohet në formën: Flijim i egoizmit, nefsi, pasuria, shpirti dhe fëmijët të mos zënë vendin e Zotit (xh.sh.), në zemër dhe të gjitha këto t'i bëhen kurban/t'i dorëzohen Allahut Teala. Ato duhet të bëhen kurban për Allahun Teala në thellësitë e zemrës dhe asnjëherë nuk duhet të shndërrohen në idhuj, sepse kurban çdo gjë që nuk mund të bëhet kurban, domethënë, çdo gjë që nuk mund t'i dorëzohet Poseduesit të saj të vërtetë, do të thotë se është shndërruar në idhull për zemrën. Ky rregull është i vlefshëm për dijen, për fëmijët, për pasurinë, për jetën etj. Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar e ka hedhur edhe në praktikë amanetin që në të vërtetë duhet të bëhet kurban shpirtërisht, në mënyrë që ta kuptojë e gjithë njerëzimi.

A e urdhëron Allahu njeriun që të therë fëmijën e tij? A mund ta zbatojë njeriu këtë urdhër? Nëse Allahu është Ai që e urdhëron këtë, sigurisht që mund ta zbatojë, sepse Allahu Teala urdhrin e Tij në fakt e bën që të zbatohet, por rezultatit e realizon sipas vullnetit të tij të lartë dhe jo siç shikohet dhe pritët nga njerëzit. Ja pra, me këtë vetëdije Ibrahim, alejhi's-selam, e çoi birin e tij, Hazreti Ismailin në vendin ku do ta bënte kurban. Sipas transmetimeve Ismaili (a.s.), më së shumti ishte trembëdhjetë vjeç. Babai i tij e shtriu atë përtokë me dhembshuri, ia vuri thikën në fyt dhe e tërhoqi, por në ato momente Allahu Teala e urdhëroi thikën të mos priste. Për këtë arsye, ajo nuk e preu Ismailin (a.s.). Domethënë, Allahu i Madhëruar e urdhëroi Ibrahimin (a.s.): "There birin tënd për ta bërë kurban për Mua!" Ndërsa thikën e urdhëroi: "Ndërsa ti mos e prit!" Në këtë mënyrë, vepra e therjes u realizua vetëm në botën e brendshme të Ibrahimit (a.s.) dhe të Ismailit (a.s.).

Ndërsa baba e bir ishin të habitur nga kjo që ndodhi, në ato momente erdhi Xhebraili (a.s.). Pranë kishte një dash që e kishte sjellë nga Xheneti. Ai u dha sihariq atyre për mirësinë e Allahut Teala. Ata thanë tekbiere dhe e therën dashin. Allahu i Madhëruar ka thënë kështu për Ibrahimin, alejhi's-selam, në Kuranin Fisnik:

*"Ibrahimi, i cili ishte shumë besnik..."* (Nexhm,

37) Krahas lavdërimit që i bëri, i dha edhe vlerësimin hyjnor duke u shprehur: **“Ne e zëvendësuam atë (Ismailin) me një kurban të madh dhe i lamë atij (Ibrahimit) kujtim të mirë në brezat e mëvonshëm. “Paqja qoftë mbi Ibrahimin!” Ja, kështu, Ne i shpërblejmë punëmirët. Ai ka qenë vërtet një nga robërit Tanë besimtarë.”** (Saffat, 107-111)

Domethënë se qëllimi i Allahut Teala kur e urdhëroi Hazreti Ibrahimin për ta therë birin e tij, Ismailin, alejhi's-selam, nuk ishte që ta bënte një baba të therte birin e tij, por ishte që ta bënte një baba t'i ekzekutonte të gjitha dashuritë e përkohshme përveç dashurisë së Allahut në zemrën e vet. Pra, edhe nëse bëhet fjalë për dashurinë ndaj fëmijës. Ndërsa qëllimi që e urdhëroi Ismailin ta pranonte këtë flijim, nuk ishte për ta therë atë në qafë, por për ta bërë atë ta kuptonte se diçka që i përket Allahut nuk mund të bëhet e askujt. Madje, këtë ia aprovoi me babain e tij.

E gjithë çështja është që të mos biem në një gjendje që nuk dëshirojmë t'i kthejmë pas amanetet që ka dhënë Allahu Teala dhe të mos i shndërrojmë ato në idhuj. Pra, të mos e shndërrojmë në idhull as shpirtin, as pasurinë dhe as fëmijët dhe të përjetojmë besnikërinë e dashurinë për t'ia dhënë çdo amanet Poseduesit të vërtetë.

Allahu i Lartësuar kërkon vetëm këtë gjendje dashurie. Përndryshe, qëllimi i Tij nuk është që ta bëjë robin të therë birin e tij. Siç ka thënë edhe Mevlana, Xhelaleddin Rumi: “Nëse dikush e zgjat qafën dhe përgatitet për t'u bërë kurban për Allahun si Hazreti Ismaili, Allahu nuk lejon që t'i pritët qafa.”

Siç është kusht të jesh mysliman për të therë kurban, po ashtu, edhe për t'u bërë kurban është kusht një nënshtrim në shkallën e dashurisë. Gjithashtu, siç është kusht që të jesh i lirë për të therë kurban, edhe për t'u bërë kurban është kusht një vullnet dhe dëshirë që buron nga brenda dhe pa pasur asnjë lloj imponimi. Siç është kusht për të qenë një njeri i mençur që e ka arritur pubertetin për të bërë kurban, edhe për t'u bërë kurban është kusht që të jesh një njeri me mendje të shëndosh dhe i pjekur shpirtërisht. Siç është kusht pasuria për të therë kurban, është kusht është për t'u bërë kurban. Në çfarëdo çështjeje që do të bëhemi kurban, mendja dhe zemra duhet të jenë të pasura në lidhje me atë çështje. Nëse do të bëhemi kurban për besimin, patjetër duhet të jemi të pasur në besim. Në të njëjtën mënyrë, duhet të jemi të pasur në dashuri, në dije etj., sepse dikush që është i varfër në dashuri, nuk mund të bëhet kurban. Ai që është i varfër në besim,

nuk mund të bëhet kurban. Të bërë kurban është shenjë e pasurisë. Gjithashtu është edhe shenjë e besnikërisë dhe lidhjes së fortë shpirtërore. Nisur nga kuptimi dhe natyra sublime e kurbanit, i Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, ka thënë:

*“Namazi është kurban i çdo njeriu të devotshëm.”* (Kuzai, Musned, I, 181.)

Nisur nga ky aspekt, e vërteta më e qartë e kurbanit është që ai të bëhet për hir të Allahut Teala. Thuhet se në umetet e kaluara kishin qenë dy besimtarë. Në vendin ku jetonin, politeistët i kishin imponuar për të therë kurban për një idhull që e kishin bërë vetë. Ata të dy rezistuan dhe e refuzuan këtë duke thënë: “Kurbani theret vetëm për Allahun.” Këtë herë politeistët i kërcënuan duke u thënë: “Atëherë përgatituni për vdekje! Ose do të therni kurban për idhullin tonë, ose do t'ju vrasim!” Por politeistët nuk e arritën dot atë që dëshironin. Për këtë arsye, atyre zullumqarëve dhe fatzinjve iu shtuan edhe më shumë zemërimi e hidhërimi. Më pas, këtë çështje e kthyen në çështje inati. Ata patjetër dëshironin t'ua bënin atë që u thoshin. Por sidoqoftë, gjoja e lehtësuan pak propozimin duke u thënë: “Të paktën therni një mizë dhe shpëtoni nga vdekja!”

Njëri prej këtyre dy besimtarëve e pa të zakonshëm dhe jo të dëmshëm me një shikim sipërfaqësor këtë propozim. Pastaj bëri një vlerësim të verbër dhe mendoi: “Ajo është thjeshtë një mizë! Çfarë të keqeje ka nëse e ther atë? Në vend se të vdes, më e logjikshme do të ishte që ta therja këtë mizë...” Nisur nga ky mendim, ai e pranoi këtë propozim të politeistëve. Menjëherë pasi e pranoi, bëri kurban një mizë për idhullin që i treguan ata. Pastaj politeistët e lanë të lirë atë. Po kështu edhe besimtarit tjetër thanë:

“Hajt, there edhe ti një mizë!” Por besimtari tjetër nuk e pranoi këtë propozim. Përsëri ua ktheu: “Sido që të jetë, kurban i theret vetëm për Allahun!” Nisur nga ky refuzim, politeistët u zemëruan shumë dhe e martirizuan këtë besimtar të begatë duke i thënë: “Sa njeri i pamend paske qenë!” Në këtë mënyrë, ky besimtar e dha shpirtin, por nuk e dha besimin. Për këtë arsye, u bë prej banorëve të Xhenetit. Ndërsa besimtari që bëri kurban një mizë për idhullin e politeistëve dhe që mendoi se shpëtoi, ndërroi jetë pa e shpëtuar dot besimin e tij kur i erdhi exheli. Për shkak të kësaj, ra në humbjen e përhershme.

Ja dy pikëkthesa/qëndrime për shkak të kurbanit! Që të dyja janë jetike. Që të dyja janë shumë të

rëndësishme nisur nga destinacionet. Që të dyja shumë të rralla nisur nga mësimi që japin. Mesazhi që jepet është mjaft i qartë: Dashuria, besimi dhe afrimiteti ynë është vetëm sa sakrifikojmë, sepse jeta është e ndërtuar mbi themelin e sakrificës. Edhe feja është sakrificë, edhe dashuria...

Kjo është sakrifica që e bëri Ibrahimin “Halil/mik të Zotit”, Ismailin “Delil/argument” dhe Jusufin “Xhemil/të bukur”. E vërteta e jetës nga fillimi e deri në fund:

Çfarë pret një foshnje e dobët e sapolindur? Çfarë pret një nënë dhe baba që dridhen nën kthetrat e pleqërisë? Çfarë pret një i sëmure që përpëlitet në dhimbje? Çfarë presin të dëmtuarit nga tërmetet që u janë shembur shtëpitë të cilat janë strehimi i jetës së tyre? Çfarë presin rënkimet e shkreta që kërkojnë shpresë jete ndërmjet gërmadhave dhe nën bombardime? Çfarë presin milingonat që kanë rënë robër të flakëve dhe po digjen të gjalla? Çfarë kërkojnë të dëshpëruarit që presin në gojën e krokodilit të zisë pa asnjë shpresë për jetën? Çfarë presin fëmijët e vegjël që nuk dinë të notojnë në dallgët e cunameve të mëdha që kanë shpërthyer në shpirtrat dhe moralin e njerëzve? Çfarë pret historia e baltosur në faqet fisnike të saj? Vetëm një gjë: Sakrificën...

Çdo gjë po pret sakrificën. Pra, një sakrificë që do të shndërrohet në festë. Një sakrificë që e shndërron zemrën, në të cilën pikon, në një zemër monument mëshire dhe dhembshurie.

Siç dihet, kjo botë që kur është krijuar e deri më tani gjithmonë ka përjetuar vullkane, tërmete, furtuna, mungesë të ushqimit, sëmundje, fatkeqësi, vuajtje, luftëra... Për këtë arsye, të gjitha rrugëzgjidhjet janë mbledhur në një fjalë të vetme: Sakrificë...

Hazreti Ibrahim u hodh në zjarr me katapultë nga ana e Nemrudit dhe e fitoi sprovën e sakrificës me jetën e tij. Zjarri jo që nuk e dogji Ibrahimin, alejhi's-salam, por u shndërrua edhe në kopsht trëndafilash për të. Pejgamberi i begatë në këtë mënyrë fitoi cilësinë “el-Halil / mik i Zotit”.

Edhe i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, ka shfaqur të njëjtën sakrificë. Madje, ai arriti pikën kulmore në shfaqjen e sakrificave. Në këtë mënyrë, fitoi cilësinë “el-Habib / i dashuri i Zotit”. Edhe sakrifikesit në kohën e tij që i thanë me gjithë zemër: “Të qoftë falë dhe t’u bëfshin kurban nëna, babai dhe pasuria ime, o i Dërguari i Allahut!” – në audiencën e tij për çdo urdhër, dëshirë, shenjë, frymë, hap, fjalë dhe të vërtete që shprehte, arritën nderin për t’u bërë sahabë të tij.

Ndërsa ata që u bënë shembuj të kësaj sakrifice pa e parë të Dërguarin e Allahut (a.s.), fituan pozitën për t’u bërë vëllezërit e Hazreti Pejgamberit (a.s.). Ai që e sakrifikoi veten për një përgëzim të tillë, u bë Fatih dhe Akshemseddin. Ata që shfaqën sakrifica të panumërta, gjithmonë u lartësuan dhe u bënë Mevlana, Junus, Edebali, Nakshibend dhe Hydaji. Të gjithë këta arritën gjendje sublime.

Në të vërtetë, a nuk është sakrifica e fshehta e festave të vërteta? Sigurisht! Ai që e bën veten kurban, ka festë. Ai që e bën pasurinë kurban, ka festë. Ata që ia dorëzojnë në kohë fëmijët Zotit (xh. xh.), kanë festë, sepse Allahu i Madhëruar thotë në Kuranin Fisnik:

**“Tek Allahu nuk arrin as mishi, as gjaku i tyre, por arrin përkushtimi tuaj. Kështu, Ai i ka vënë ato në shërbimin tuaj që ju ta madhëroni Allahun sepse ju ka udhëzuar. Dhe, jepu lajmin e mirë, punëdrejtëve!”** (Haxh, 37) Domethënë, qëllimi nga kurbanit është që ta mbrujmë gjendjen tonë shpirtërore me devotshmëri. Domethënë, afrim te Allahu Teala. Pra, afrim me sinqeritet ndaj Tij. Afrim me gjithë shpirt dhe nën orientimin e Islamit. Afrim me dashuri. Afrim në një mënyrë shumë të pastër. Për këtë arsye, asnjëherë nuk duhet të harrojmë se kurbanit gjithmonë e afron njeriun te ai për të cilin e ka therë kurbanin. Nëse njeriu ther kurban për një gur, atëherë edhe njeriu ngurtësohet. Nëse ther kurban për dhe e pluhur, atëherë edhe shpirti zhytet në baltë. Nëse njeriu ther kurban për Allahun e Lartësuar, atëherë zemrat bëhen udhëtare të miraxhit.

Për këdo që të bëhet therja e kurbanit, andej anon edhe qendra e besimit. Pastaj fillon një lidhje e fortë ndërmjet atij për të cilin është therë kurbanit dhe atij që e ka therë kurbanin. Për këtë arsye, personin prej atyre dy besimtarëve që folëm më sipër në të vërtetë nuk e shkatërroi therja e kurbanit, por afrimi me idhujt për shkak të njetit për kurbanin. Sikundër kësaj, besimtari tjetër u lartësua dhe e arriti lumturinë e përhershme me nënshtrimin dhe kurbanin që bëri për Allahun e Madhëruar, sepse me kurbanin, i cili është afrim i zemrës me atë për të cilin bëhet kurbanit, qoftë pozitiv apo qoftë negativ, përjetohen ndryshime dhe transformime të mëdha. Prandaj, edukimi i njeriut në lidhje me kurbanin mbart një rëndësi shumë të veçantë, sepse, nisur nga natyrshmëria e tij, nëse njeriu jepet pas krijësive të përkohshme, domethënë, nëse kaplohet nga paraaja, objektet e çdo gjë tjetër, duke u bërë kurban për to, atëherë largimi prej tyre bëhet i vështirë e në disa raste edhe i pamundur. Të njëjtën gjë mund ta themi edhe për të kundërtën e kësaj gjendjeje. Kushdo që e flijon veten e tij për dashurinë subli-



me dhe Krijuesin e Lartë, do të thotë se zemra e tij tashmë është e lidhur me lidhje të pakëputshme. Në të vërtetë, e gjitha që synohet nga këto që thamë është arritja e kësaj pjekurie në rrugën e nënshtrimit ndaj Allahut (xh.sh.).

Dashuritë e vërteta gjithmonë i kanë lidhur zemrat me njëra-tjetrën nëpërmjet kodit të kurbanit. Kurbanit gjithmonë ka qenë shenja më e rëndësishme dhe e vetme e dashurisë së vërtetë. Të gjithë poetët e dashuruar i kanë shprehur poezitë e tyre në horizontin e flijimit për Allahun Teala. Ja Junus Emreja! Jetën e tij e pranon si flijim/kurban, sepse sipas tij ky është rregulli i përparimit në rrugën e drejtë të Zotit (xh.sh.).

“Junusi është i varfër dhe i shkretë,  
Ai e bën kurban çdo gjë që të ketë,  
Prandaj te Subhani eja, strehohu ti vetë,  
Eja ti zemër në rrugën e drejtë!..”

Junus Emre e shpreh me emocion dhe me një gjuhë flijimi edhe përmallimin që ndjen ndaj të Dërguarit të Allahut (s.a.s.):

“Jeta ime i qoftë kurban rrugës tënde,

Emrin e ke të bukur, vetë je i bukur, Muhammed...”

Të flijohesh për atë është nderi më i madh. A mund të ketë ndonjë mirësi më të madhe se kjo për njeriun? Kurrë. Në të vërtetë:

“Gjemb (i ndarë nga trendafil) meriton vetëm zjarrin,

Por kur ai gjendet pranë trëndafil meriton xhennetin...” (Sejri)

Ja, kjo zemër për të cilën folëm është trëndafil. Pra, zemra e të urtëve. Zemra e miqve të Allahut Teala. Zemra e personaliteteve monumentale. Domethënë, zemrat që nuk kanë largësi me Zotin (xh.sh.).

Lum për besimtarët që e kalojnë të gjithë jetën e tyre bashkë me ata!

Ndërkohë mjerë për ata që nuk e konceptojnë dot këtë të vërtetë!

Mjerë për ata!

Mjerë për ata që u bëhen kurban nefsit, shejtanit dhe armiqve të tyre në vend që t'i bëhen Allahut Teala! Mjerë edhe për të diturit që ia bëjnë të vërtetat kurban injorancës! Mjerë edhe për të shkujdesurit që ua bëjnë kurban mizat moderne idhujve modernë të kohës së fundit! Një mijë herë mjerë edhe për ata që ia kushtojnë veten padrejtësisë dhe barbarizmit në vend që t'ia kushtojnë drejtësisë dhe mëshirës!

Krahas këtyre,

Lum për ata që kapen pas përshpirtjes pa e prishur aspak qëndrimin e tyre të drejtë krahas materializmit, barbarizmave dhe padrejtësive!

Në veçanti lum për ata fatlumët që e kanë arritur lumturinë e përhershme ngaqë u janë nënshtruar dhe e kanë flijuar veten e tyre për Sulltanin e pejgamberëve, për rrugën e tij të ndritur dhe për miqtë e Zotit (xh.sh.)!

*“Junusi është i varfër dhe i shkretë,  
Ai e bën kurban çdo gjë që të ketë,  
Prandaj te Subhani eja, strehohu ti vetë,  
Eja ti zemër në rrugën e drejtë!..”*





“JO, KY NUK ËSHTË I FALIMENTUARI I VËRTETË.  
I FALIMENTUARI I VËRTETË ËSHTË AI I DITËS SË  
KIJAMETIT, ËSHTË AI QË KA PËR TË DALË PËRPARA  
ZOTIT ME SHUMË NAMAZ, ME SHUMË AGJËRIM, ME  
SHUMË SEVAPE DHE SHUMË HAXH, POR KY NJERI KA  
BËRË EDHE DISA PUNË TË TJERA...”

# I falimentuari I AHIRETIT

— Ferit Piku —

Zoti ynë thotë ne Kuranin fisnik: **Thuaj: “A t’ju tregojmë për më të dëshpëruarit në veprat e tyre? Ata janë veprimi i të cilëve u asgjësua në jetën e kësaj bote, e megjithatë ata mendojnë se po bëjnë mirë. Të tillët janë ata që nuk besuan argumentet e Zoit të tyre as takimin (ringjalljen) e Tij, prandaj veprat e tyre shkuan huq dhe në ditën e Gjykimit atyre nuk do t’u japim kurrfarë vlere”.** (Kehf, 103-105).

Cili person quhet i falimentuar? I falimentuar është ai njeri, që ka shumë para, por me shumë se para ai ka borxhe dhe kur bën llogarinë, ai është i falimentuar. I falimentuar është ai njeri, që ka shumë ndërtesa në pronësi, po kur bën llogaritë, ai s’ka as shtëpinë e vet, pasi është i detyruar ta shesë edhe atë. I falimentuar është ai njeri, që mund të ketë shumë pasuri, por në fund fare edhe rrobën që ka veshur nuk e ka të tijën. I falimentuar është ai njeri, që ka bërë shume llogari, por s’ka bërë mirë llogaritë e vetes së tij, ky është i falimentuari i dynjasë. Realisht është për të ardhur keq për njerëz të tillë dhe mos na bëftë Zoti prej tyre. Por ka një të falimentuar tjetër, që është i falimentuari i Ahiretit, i falimentuari i botës tjetër, i cili është më i keq se i dynjasë. Personit, që falimenton në dynja, mund t’i vijë bota në atë formë, saqë ta nxjerrë nga situata dhe bëhet përsëri pasanik, mund t’i dalë një shok dhe një mik që e nxjerr nga falimentimi, ndërsa atë të Ahiretit nuk ka kush e nxjerr prej falimentimit. Muhamedi (a.s) i pyeti një herë

shokët e tij: “Cilin njeri e quani te falimentuar?” Ata i thanë: “I falimentuar tek ne o profet i Zotit është ai njeri, që nuk i ka mbetur asnjë grosh në xhep, asnjë dinar e asnjë dirhem”. Profeti (a.s) ua ktheu: “Jo, ky nuk është i falimentuari i vërtetë. I falimentuari i vërtetë është ai i ditës së Kijametit, është ai që ka për të dalë përpara Zotit me shumë namaz, me shumë agjërim, me shumë sevape dhe shumë Haxh, por ky njeri ka bërë edhe disa punë të tjera. Ai ka ofenduar dikë, ka sharë dikë tjetër, një tjetër e ka rrahur, ndërsa një tjetri ia ka prekur nderin, ka vrarë dikë dhe ka derdhur gjakun e dikujt tjetër. Ky fillon dhe jep borxhin e tij. Por atë ditë borxhi s’jepet me para, jepet me sevape. I jep të parit sevapet e veta, derisa e shlyen borxhin e të parit, por ka dy tre apo katër njerëz që u ka borxh, që u ka hyrë në hak. Kështu vjen fundi dhe atij i mbarojnë sevapet, por akoma s’i ka larë borxhet e veta. Atëherë Zoti thotë: “Merr nga gjynahet e këtyre njerëzve, që u ka hyrë në hak!” Njeriu fillon e merr nga gjynahet e tyre dhe ato i rendohen mbi supe, derisa në fund e fusin në Zjarr”. Ky është i falimentuari përpara Zotit. Ka ardhur me male me sevape, dhe fundi i tij është zjarri i Xhehenemit. Ai, që kur i jep borxhet e tij, s’i ngelet kurrëgjë, falimenton dhe fundin e ka në zjarrin e Xhehenemit.

I falimentuari i vërtetë tek Zoti është ai që falet, por kurrë s’ka mësuar prej namazit të vet, është ai që agjëron një muaj, por kurrë s’ka marrë mësim prej këtij mësuesi të madh, është ai njeri që ka qenë në Haxh, por ai kurrë se ka respektuar emrin haxhi, është ai njeri që e quan veten musliman dhe njeri të mirë, por i ka hyrë në hak të tjerëve dhe kur fillon

*“Ai që është besimtar, s’mund të jetë akuzues, s’mund të bëjë akuza të pabaza, ai s’mund të mallkojë, ai s’mund të jetë njeri i ulët, ai s’mund të jetë fjalëndyrë. Ai që i vepron këto punë, ai s’mund të jetë besimtar.”*

e lan borxhet e veta, s’i ngelet as edhe një sevap, përkundrazi përfundon në zjarrin e xhehenemit. Me të vërtetë imagjinoje një njeri të falimentuar. Të vjen shumë keq për të, por e mira e të mirave është ta pyesim veten tonë: Çfarë punësh ka bërë ky njeri që përfundoi në zjarrin e xhehenemit”? E kuptuam se ai ka falur namaz, se ka qenë në haxh, se ka agjëruar, por ka bërë disa punë të tjera, të cilat ia kanë marrë të gjitha sevapet. Çfarë ia dogji sevapet këtij njeriu? Sevapet ja dogji ofendimi, gjuha e vet. Ai shan, ofendon dhe nëpërkëmb dinjitetin e njerëzve. Ai me të vërtetë përmend emrin e Zotit me gjuhë, por po me atë gjuhë ai përmend fjalët e liga. Muhamedi (a.s) thoshte: “Ai që është besimtar, s’mund të jetë akuzues, s’mund të bëjë akuza të pabaza, ai s’mund të mallkojë, ai s’mund të jetë njeri i ulët, ai s’mund të jetë fjalëndyrë. Ai që i vepron këto punë, ai s’mund të jetë besimtar”. Është e vërtetë sot, se në tre fjalë që thuhën. një e ke fjalë të pistë. Sot edhe plaku i vjetër skuqet nga turpi, ndërsa fëmija i vogël nuk skuqet prej kësaj fjale. Kjo është shumë e vërtetë, por besimtari është gjithmonë besimtar. Atij i vjen turp, kur e dëgjon këtë fjalë e jo më ta thotë atë me gjuhën e tij. Ai njeri, që ka në gjuhën e tij emrin e Zotit, nuk duhet ta prishë atë me fjalë të pista, me fjalë të liga, se me të vërtetë këto fjalë të liga ia djegin punët. Mos përgojo të tjerët, mos merr gjynahet e të tjerëve e t’u japësh sevapet e tua. Është i çuditshëm fakti, që e ke inat një njeri dhe kur vjen fundi i jep sevapet atij dhe i merr gjynahet. Kështu është puna e atij, që përgojo të tjerët dhe bën thashetheme ndaj të tjerëve. Ai ka akuzuar pa të drejtë, ka njollosur nderin e të tjerëve, duke thënë: “Ky është imoral dhe kjo është imorale”. Ky lloj njeriu ka kënaqësi të madhe, kur vulos për keq një njeri të ndershëm.

Profeti (a.s) ka thënë: *“Nga shtatë gjynahet që e fusin robin në zjarr dhe s’e nxjerrin atë prej zjarri është t’i akuzosh gratë e ndershme dhe burrat e ndershëm”*. Ata s’dinë asgjë se çfarë thua ti, ndërsa ti e përhap fjalën në shoqëri. Ti je një mysliman. Nëse shikon diçka, bëj sikur s’e ke parë, nëse dëgjon diçka, bëj sikur s’e ke dëgjuar. Nëse as këtë punë s’e bën dot, të paktën mos akuzo të tjerët pa të drejtë. Me të vërtetë është nga cilësitë më të ulëta, që s’mund ta ketë një njeri i mirë e mbi të gjitha s’mund ta ketë një besimtar. Ajo që ia dogji punët dhe sevapet këtij njeriu është, se ka ngrënë pasurinë e të tjerëve. Dikujt i ka falsifikuar dokumentet, dikujt i ka marrë ryshfet, dikë e ka vjedhur, dikë e ka mashtruar, ai ka vënë pasuri, po e ka vënë pa djersë. Zoti nuk ia begaton këtë pasuri as në këtë botë, por përkundrazi ka për t’ia bërë shkatërrim dhe dënim në botën tjetër. Muhamedi (a.s) u tha njëherë shokëve të tij: *“Betohem në Zot, se ai njeri që i merr tjetrit pasurinë, duke dëshmuar në gënjeshtëri, Zoti e ka caktuar vendin e tij në mes të xhehenemit dhe ia ka bërë haram të hyjë në xhenet”*. Fjalë e frikshme. Shokët e tij e pyeten: *“O profet i Zotit, po nëse bëhet fjalë për punë të vogël, për mall të vogël?”* Profeti (a.s) u përgjigj: *“Betohem në Zot, se nëse njeriu i merr dikujt një shkop të thatë pa të drejtë, vendin e ka në zjarrin e xhehenemit”*. Zoti na ruajt nga pasuria dhe haku i tjetrit. Njeriut ia djeg sevapet vrasja e tjetrit. Profeti (a.s) ka thënë: *“Njeriu do të jetë në hajr, derisa s’ka derdhur gjak në mënyrë të paligjshme. Nëse ai derdh gjakun e tjetrit, ka bërë gjynahun më të madh”*. Ai (a.s) thoshte gjithashtu: *“Betohem në Zot, se sikur gjithë bota të shkatërrohet përpara syve të Allahut, kjo është më e lehtë sesa një njeri i pafajshëm të vritet pa të drejtë”*. Zoti i ruajt duart tona dhe mendjet tona nga gjaku i të tjerëve.

Le të imagjinojmë pak fytyrën e atij njeriu, që ka falimentuar. Ai nuk ka fjalë për të thënë, ai e ka fytyrën të nxirë, ai kishte shumë por të gjitha iu bënë shkurmë. Imagjinoje atë njeri, që ditën e Gjykimit shkon tek Zoti me shumë sevape dhe mendon se jo vetëm që do të hyjë në xhenet, por do të jetë në majat më të larta të tij, mirëpo ai futet në zjarr. Me të vërtetë do të jetë për të ardhur keq gjendja e këtij personi. Imagjinoni njerëzit, që kërkojnë hakun. Njeriu ka falimentuar, ndërsa ata përsëri turren pa mëshirë për të kërkuar hakun e tyre. Mbani mend se ç’ndodhi në 97-tën, kur njerëzit morën vesh, se bankat në të cilat kishin futur para me kamatë,

kishin falimentuar. Ata u bënë egërsira. Po ashtu edhe ditën e Kijametit njeriu kërkon hakun një më një dhe s’ta fal. Atëherë imagjinojeni veten tuaj, Zot na ruaj, sikur të na thuhet ditën e Kijametit: *“Ti ke bërë shumë punë të mira, ke shumë sevape, por gjynahet e tua janë më të shumta, pasi u ke hyrë në hak njerëzve. Sot ti je i falimentuar”*.

Njeriu në këtë botë ka tre lloje detyrimesh. Një detyrë e ka ndaj vetes ndaj nefsit të tij, një tjetër e ka ndaj Krijuesit, ndaj Allahut (xh.sh) e të tretën e ka ndaj njerëzve të tjerë.

Nëse i ke hyrë në hak vetes tënde, dije se vetja jote do të kërkojë hakun ndaj teje. Nëse i ke hyrë në hak Zotit, ka shumë mundësi të të falë, se Ai është Falës është Bujar i madh dha ka mëshirë shumë të madhe, por në qoftë se i ke rënë në qafë njerëzve, ji i sigurt, që ata s’ta falin as në këtë botë, por sidomos në atë tjetrën dhe vetë Allahu fuqiptotë nuk hyn ndërmjetës, që të të pajtojë ty me njerëzit e tjerë, sepse ti u ke hyre në hak atyre. Zoti është i drejtë me të gjithë njerëzit dhe ia kthen hakun secilit prej tyre. Sikur ata të thonë: *“Të kemi falur”*, lum si ti. Por nëse nuk të falin, atëherë dije se kjo do të jetë humbje për ty.

Le t’i ruajmë gjuhët tona dhe vetet tona që të mos i hyjmë në hak të tjerëve. Njeriu do të llogaritet një ditë, por atë ditë kur bëhet llogaria, nuk ka para, s’ka as euro e as dollarë, nuk mund ta marrësh me të mirë tjetrin, atë ditë njeriu ka hallin e veprave të tij dhe është i shqetësuar për përfundimin e tij. Prandaj Muhamedi (a.s) thoshte: *“O njerëz! Kush i ka hyrë në hak një tjetri, le ta lajë sot borxhin, përpara se të vijë e nesërmja, ku nuk ka dinar e dërhëm, por ka vetëm sevape dhe gjynahe. Lajini borxhet në këtë botë, se ato janë shumë të rënda në botën tjetër”*.

Ka shumë përkufizime se kush është muslimani. Po të na pyesësh ne se kush është një musliman, fillojmë e flasim gjithë ditën, por profeti (a.s) e ka përmbledhur me dy fjalë. Ai (a.s) ka thënë: *“Musliman i mirë është ai njeri, që prej gjuhës dhe dorës së tij nuk i vjen e keqja të tjerëve”*. Nëse gjuha e tij s’i hyn në hak të tjerëve, nëse dora e tij nuk i hyn në hak të tjerëve, atëherë ky është myslimani i vërtetë.

O Zot! Të lutemi ty që siç i zbukurove fytyrat tona, zbukuroi moralet tona, na trego të mirën dhe na bëj nga ndjekësit e saj, na e trego të keqen dhe na bëj nga ata, që gjithmonë i largohen asaj.

Amin!..

**“MUSLIMAN I MIRË  
ËSHTË AI NJERI,  
QË PREJ GJUHËS  
DHE DORËS SË TIJ  
NUK I VJEN E KEQJA  
TË TJERËVE”.**

## Nëse nuk do të keni më punë me Allahun

Sulltan Mahmuti, i cili ishte prej sulltanëve të mëdhenj të shtetit të Gaznës, i cili ishte njëri prej shteteve të para të turqve myslimanë, kishte përjetuar shumë vështirësi përgjatë një ekspeditë që kishte organizuar kundrejt Indisë dhe kishte filluar të mendonte se nuk do të korrite dot fitore. Përgjatë kësaj gjendjeje të vështirë i kishte premtuar Zotit duke i thënë: “O Zot! Nëse do të korr fitore në këtë luftë, të gjithë plaçkën e luftës që do ta marr do t’ua shpërndaj të varfërve.” Me të vërtetë Allahu (xh.xh.), e ndihmoi dhe Sulltan Mahmuti krahas fitores së madhe arriti të merrte edhe një plaçkë lufte shumë të vlefshme. Kur u kthye në Gazna, filloi t’ua shpërndante të varfërve dhe nevojtarëve të gjithë plaçkën e luftës siç kishte premtuar. Këtë gjë e kundërshtuan disa vezirë dhe komandantë. Kur Sulltan Mahmuti tha: “Ky është premtimi im,

Sigurisht që do t’i shpërndajë të gjitha.”, disa ia bënë kokën lëmsh duke i thënë: “Aman o Sulltani ynë! Si mund t’ua dinë vlerën të varfrit këtyre pasurive të shtrenjta? Një pjesë të tyre shpërndajeni, por më të shtrenjtat vendosini në thesarin e shtetit. Në fakt, thesari ka nevojë për këtë plaçkë lufte.” Nisur nga kjo, Sulltan Mahmuti vendosi të konsultohet me një dijetar që jetonte në Gazna dhe që nuk hezitonte të thoshte të vërtetën cilido qoftë çmimi i saj. Ky njeri i madh që Sulltan Mahmudi e pyeti për mendimin e tij, i dha këtë përgjigje kuptimplote Sulltanit: “Sulltan! Në këtë situatë nuk ka aspak vend për hezitim. Nëse nuk do të keni më punë me Allahun, bëni atë që ju kanë thënë vezirët dhe komandantët tuaj. Por nëse do të keni punë përsëri me Allahun, mbajeni premtimin tuaj dhe shpërndajuni të varfërve plaçkën e luftës.”

## NË ÇFARË TRANSFORMOHEN?

*Riciklimi është shumë i rëndësishëm edhe nga aspekti i mbrojtjes së mjedisit, edhe nga aspekti i ekonomisë. Sipas të dhënave të Ministrisë së Mjedisit të Republikës së Turqisë, në vitin 2013 janë mbledhur 82 mijë e 688 ton mbetje ambalazhesh. Këto i janë dhënë ekonomisë si një lëndë e parë e përdorur. Kontributi ndaj ekonomisë i mbetjeve të ambalazheve që mund të riciklohen ishte 124 milion e 32 mijë lira. Prej këtyre 82 mijë e 688 ton mbetjeve të riciklueshme u prodhuan pjesë të poshtme të tapetave, tollumba gjumi, materiale izolimi të veshjet, furça boje, kamerdare, torba, kuti poste, tavolina pikniku, gardhe, çizme, kova me dy pjesë, rrëshqitëse, etj. Kur 2.5 litra plastik i shkrirë të përftohet dhe të përdoret në prodhim, kursehet 60 vat energji elektrike për 6 orë. Prej 25 copë mbetjeve plastike prodhohet një xhup plastik.*



# TË QASH

## *për jetimët*

— Shefika K. Meriç —

Ebu Derda, radijallahu anhu, transmeton:

Kam dëgjuar Pejgamberin, salallahu alejhi ve selem, të thotë:

*“Kujdesuni për të varfrit. Mos kini dyshim se ndihmoheni nga Allahu për shkak të të varfërve që ndodhen mes jush.”* (Ebu Davud, Xhihad, 70.)

Çështja e jetimëve është një nga çështjet për të cilën Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, fliste

me shumë ndjeshmëri... Ajetet fisnike dhe Hadithet e Pejgamberit (s.a.s), tregojnë se sa i ndjeshëm duhet të jetë myslimani në këtë çështje.

Në suren ed-Duha Allahu na tërheq vëmendjen duke thënë:

***“Mos e shtyp jetimin, lypësin mos e shtyj me ashpërsi.”*** (Duha, 9-10)

Përsëri në të njëjtën sure i kujtohen Pejgamberit

(s.a.s.), mirësitë që i janë dhënë dhe si shpajmim për këtë urdhërohet që t'i mëshirojë jetimet të cilët janë pjesa më e dobët e njerëzve:

***“A nuk ishe jetim e Ai të dha strehë? A nuk të gjeti të paditur (për Islamin) e të udhëzoi? A nuk ishe nevojtar e të bëri të mos ia kishe nevojën askujt? Prandaj mos e shtyp jetimin.”***  
(Duha, 6-9)

Sprovat e njeriut janë të ndryshme. Çdo provë duhet ta forcojë durimin tonë dhe duhet të na bëjë ne ta rrisim forcën e të duruarit... Duhet ta jetojmë me një dorëzim të plotë jetën që Allahu na ka dhënë ne si robër të Tij dhe nëse është e nevojshme, duhet të shohim nga kjo dritare durimi kundrejt fatkeqësive.

Shprehja e këtyre është ana më e lehtë e çështjes... Duhet ta ndjesh gjendjen e atyre njerëzve që e përjetojnë këtë dhe të qash hallet me ta. Të mund të mendosh: “Unë nuk kam ndonjë ndryshim nga ai, kështu që edhe unë mund të bëhem si ai”... Të falënderosh me fjalë dhe me vepra...

Gjendja e jetimit e ka sprovën shumë të rëndë. Njeriu në këtë gjendje privohet nga prindërit dhe përjeton një mungesë të thellë dashurie... Jetimet sytë i kanë të mjegullt, kokat të përulura, shpirtin të plagosur dhe zemrën e thyer. Prandaj gjendja e jetimit është një gjendje që nuk ke nga t'i ikësh kur të vjen dhe që ke nevojë për anën materialo-shpirtërore të njerëzve të tjerë.

Për këtë arsye, Allahu veçanërisht kërkon nga ne vëmendjen që t'u bëhemi strehë jetimëve dhe të bëhemi ortakë në hallet e tyre.

Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, kishte një ndjeshmëri shumë të thellë. Ndoshta në botën e Tij të brendshme gjurmët e thella të jetimit gjatë gjithë jetës kurrë nuk shuan. Ndoshta prandaj, kudo që shihte një jetim, mërzitej e i copëtohej zemra.

Ai, Pejgamberi i mëshirës, i mbrojti dhe u kujdes gjithmonë për të varfrit dhe të dobëtit. Kur iu dha detyra e profecisë, të gjitha ata që ishin rrethuar nga mëshira dhe dashuria e Tij (s.a.s.), i qëndruan pranë dhe pranuan me shpirt çdo gjë që i zbriti Atij nga Allahu.

Vetëm mushrikët e Mekës për shkak të krenarisë dhe mendjemadhësisë, duke dhënë si justifikim të varfrit, të cilët ishin nderuar të parët me Islam te Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, u shprehën se nuk mund të bëheshin myslimanë ngaqë nuk mund të përziheshin me ta:

“Dëboji ata dhe do të shohësh se do bëhemi menjëherë myslimanë!”

Kjo kërkesë e kishte bërë konfuz Pejgamberin, salallahu alejhi ve selem. Në njërën anë përpiqej me sa mundej që feja islame, e cila është rruga e shpëtimit të përjetshëm, të arrinte te secili, në anën tjetër nuk dëshironte t'i përzinte të varfrit dhe të vetmuarit të cilët kishin nevojë për dashuri e mëshirë. Ndërkohë ajeti fisnik që zbriti, nxori në pah fytyrat e qafirëve dhe urdhëroi të Dërguarin e Allahut, salallahu alejhi ve selem, të bënte zgjedhjen:

***“Mos i dëbo ata që i luten Zotit në mëngjes e në mbrëmje, duke kërkuar Fytyrën (mirësinë) e Tij!..”*** (En'am, 52)

Një ndodhi që tregon krenarinë dhe egoizmin e mushrikëve po ashtu edhe nënçmimin e jetimëve, është kjo ngjarje që ka ndodhur mes Ebu Xhehlit dhe Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem:

Ebu Xhehli kishte vënë dorë mbi të gjithë pasurinë e jetimit të cilin e kishte nën mbikëqyrje dhe nuk ia kishte dhënë hakun atij fëmije, edhe pse kishte nevojë. Po ashtu, kur jetimi i kërkonte diçka, sillej shumë keq me fëmijën.

Përsëri një ditë fëmija erdhi te Ebu Xhehli dhe i kërkoi diçka, ndërsa ai e përzuri. Mushrikët që panë ngjarjen, për ta acaruar më shumë gjendjen dhe për t'u argëtuar, e thirrën fëmijën dhe i thanë:

“Shko te Muhamedi, le t'ia kërkojë ai Ebu Xhehlit atë që dëshiron!..”

Fëmija në një mënyrë konfuze shkoi te Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, dhe ia tregoi gjendjen. Ai, (s.a.s.), e mori jetimin, shkoi te Ebu Xhehli dhe i tha:

“Jepja menjëherë hakun këtij fëmije!...”

Ebu Xhehli pa e bërë fjalën dysh, ia dha menjëherë hakun jetimit. Pasi Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, u largua, shokët u tallën me Ebu Xhehlin duke i thënë:

“Si ka mundësi që ia dhe menjëherë? Ne të dinim për më të fortë!”

Ebu Xhehli u përgjigj:

“Për Zotin, edhe ju po te kishit qenë në vendin tim, do të vepronit në të njëjtën mënyrë. Në të djathtën dhe në të majtën e Tij pashë nga një hesh-të. Nëse nuk do t'ia jepja, do të më nguleshin.”

Si përfundim, të tregojmë shkurtimisht këtë tablo mësimdhënëse që u përjetua në luftën e Uhudit dhe ta përfundojmë temën:

Në luftën e Uhudit ranë dëshmorë përafërsisht shtatëdhjetë myslimanë nga ushtria islame. Edhe

xxhaxhai i dashur i Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem, Hamza ra dëshmor në këtë luftë. Madje, u plagos edhe i Dërguari i Allahut (s.a.s.) dhe lajmi se kishte rënë dëshmor shkoi deri në Medine.

Pasi mbaroi lufta, gratë myslimane të Medinës, shkuan drejt Uhudit dhe vrapuan të prisnin ushtrinë. Të gjitha pothuajse i kishin harruar dëshmorët e tyre dhe kërkonin për Pejgamberin, salallahu alejhi ve selem.

Ndërkohë, vajza e Xhahshit, Zejnepeja u takua me të Dërguarin e Allahut, salallahu alejhi ve selem dhe mes tyre u bë një bisedë e tillë: Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, i tha:

“Bëhu e durueshme!..”

Zejnepja, radijallahu anha, e pyeti:

“Përse, o i Dërguari i Allahut?”

“Sepse vëllai yt Abdullahu ka rënë dëshmor!”

“Qoftë bekuar dëshmia e tij!”

“Bëj durim!”

“Përse o i Dërguari i Allahut?”

“Daja yt Hamzai ka rënë dëshmor.”

Ajo iu përgjigj:

“Të gjithë i përkasim Allahut dhe te Ai do të kthehemi. Bekuar qoftë pozita e dëshmorit për të...”

Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, pasi qëndroi pak, u kthye nga Zejnepeja dhe i tha përsëri:

“Bëhu durimtare, o Zejnepe!”

Ajo e pyeti sërish:

“Përse o i Dërguari i Allahut?”

“Burri yt Mu’sabi ka rënë dëshmor.”

Zejnepja, radijallahu anha, kur dëgjoji këtë fjalë,

filloi të qante me dënësë. Kur e pa këtë gjendje i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, tha:

“Askush nuk mund ta zërë vendin e burrit në zemrën e gruas!..”

Në atë çast, kur Pejgamberi (s.a.s.), e pyeti Zejnepen, radijallahu anha:

“Pse po qan kaq shumë për burrin?”, ajo u përgjigj:

“Nuk po qaj për burrin, sepse ai ra dëshmor duke luftuar përkrah Pejgamberit, salallahu alejhi ve selem. Po qaj për fëmijët të cilët mbetën jetimë.”

Disa ajete lutjeje nga Kurani Famëlartë:

**“...O Zoti ynë, mos na bëj sprovë për popullin keqbërës (duke i lënë të na shkatërrojnë)”** (Junus, 85)

**“Mes robërve të Mi ishte një grup i cili thoshte: ‘O Zoti ynë, ne kemi besuar prandaj na fal dhe na mëshiro! Ti je më i miri i mëshiruesve!’** (Mu’minun, 109)

**“...O Zoti ynë, na jep mëshirë dhe na përgatit për sjellje të drejtë!”** (Kehf, 10)

**“O Zoti ynë, Ti e di vërtet çfarë fshehim e çfarë shfaqim haptazi. Allahut nuk i fshihet asgjë, as në tokë e as në qiell.”** (Ibrahim, 38)

**“O Zoti ynë, më fal mua, prindërit e mi dhe besimtarët në ditën kur do të jepet llogari!”** (Ibrahim, 41)

**“O Zoti ynë, falna neve dhe vëllezërit tanë, të cilët kanë besuar para nesh dhe mos lejo që në zemrat tona të ketë asnjë të keqe ndaj besimtarëve! O Zoti ynë, Ti je vërtet i Butë dhe Mëshirëplotë!”** (Hashr, 10)







# Rrezja e parë që bie në zemër

— Fatma Allada —

E çfarë është e qeshura?! Buzëqeshja e fytyrës, zëri naiv i stolitur me shikime të hareshme. E çfarë është buzëqeshja, në rrjedhën e jetës, në bisedën me njerëzit e dashur, kur ditët kalojnë nën ritmin e punëve...

Normaliteti i buzëqeshjes së fytyrës në pranverë të bën të përmallohesh për të në ditët e ftohta të dimrit, stinës së trishtimit... Në derën e zemrës trokasin me radhë të gjitha gjërat që e ftohin brendësinë e njeriut... Në mendje vijin pyetje të reja... Çfarë është në të vërtetë buzëqeshja? Edhe veprimet e tilla të zakonshme në stinë të vështira bëhen të paçmueshme. Ashtu siç fytyra pret në mallin e buzëqeshjes, vështron me mall rrugën...

Ishte e vështirë të thuash: “Të kërkosh diçka që nuk i përket stinës, është e dëmshme; çdo gjë është e bukur në kohën e saj!..” Nuk është e drejtë ta kërkosh buzëqeshjen në gjethet e thata të stinës së trishtimit, të kërkosh me këmbëngulje katër stinë me diell. Jetën duhet ta jetojmë ashtu siç duhet, duke qenë të kënaqur me rregullin që ka vënë Krijuesi...

Ja, duhet të fillojmë me dashurinë ndaj stinëve. “Shqetësimi” që e viziton shpirtin është lajmëtari i asaj stine. Mos pandehni se zemra është e thatë, në të janë mbjellë halle... Lotët që rrjedhin nga sytë, bëhen shi dhe e bëjnë të bereqetshëm çdo vend... Nëse robi do ta përjetonte të qarën dhe buzëqeshjen në stinën e duhur, lumturia papritur do të lindte e do të bëhej filiz.

Stina e trishtimit në fakt është periudha e ugarit të zemrës... Toka forcohet aq shumë!.. Sepse është lagur me lotët më të begatshëm... Janë gati të

mbijnë farat e lumturisë përbrenda, të cilat janë mbjellë që nga ekzistenca. Zemra lakmitare aq ziliqare, që lakmonte bukurinë e tokave të tjera, tashmë ka filluar të edukohet.

Kjo erë e cila u bë shkak që të qëndrojmë vetëm për vetëm me Krijuesin, e çon njeriun në botë të tjera... Nuk ngelën as gjendjet e zakonshme të paçmuara, as pyetjet... Njeriu u ndërgjegjësua; kjo stinë është kalimtare, prandaj duhet ta jetojë atë të mbushur plot. Përkujtimi herë pas here se lidhja që ka me Zotin, është adresa e vetme e derës më të sigurt, është fryti i vetëm i kësaj toke në stinën e trishtimit.

Pasi u jepet formë halleve e dertëve, vjen koha të përshëndetet me stinën e trishtimit. Toka e forcuar tashmë është gati të rrisë të gjitha frutet e jetës. Mbi të përhapet aroma e forcës së besimit... Të gjitha stinët janë përgatitje për frytin e Xhenetit... Shportat mbushen plot e përplot me lumturi e kënaqësi. Sigurisht që stina e trishtimit vjen sërish, deri në frymën e fundit herë pas here shfaqet vlera e rrjedhjes së thjeshtësisë dhe jetës normale.

Përsëri, me lindjen e diellit vazhdon rruga nën falënderimin e një zemre të fortë. Mendimi se çdo stinë ka bukurinë e saj dhe se secila ka aromën e saj të veçantë, e bën jetën më të sigurt...

Pyetja e parë që të vjen në mendje: “Ç’është buzëqeshja?” Fytyra që mërdhin në vetmi, ndërkohë që të ngrohet nga lotët, formon përgjigjen. Përgjigja sigurisht që jepet më bukur mes lutjeve, pastrimit dhe në ngrohtësinë e mbështetjes te Allahu.

**“Buzëqeshja është rrezatimi i parë që bie në zemër pas stinës së trishtimit.”**



# DISA MËNYRA TË THJESHTA

## *për të përmirësuar funksionin e zemrës*

Ka më shumë se 7 milionë njerëz që vuajnë nga sëmundjet kardiovaskulare. Shpesh e menduar si një sëmundje mashkullore, por në të vërtetë vret më shumë femra në krahasim me kancerin e gjirit.

Ka disa mënyra të thjeshta për të minimizuar rrezikun e këtyre sëmundjeve:

1-Minimizoni përdorimin e kripës. Kripa rrit presionin e gjakut dhe përdorimi i shumtë i saj rrit rrezikun e sëmundjeve kardiovaskulare.

2-Kryeni ushtrime gjimnastikore. Është e nevojshme që 30 minuta në ditë të kryeni ushtrime gjimnastikore. Forcon zemrën.

3-Përdorni omega 3. Pilulat omega 3 janë vaj peshku dhe ulin rrezikun e sëmundjeve të zemrës. 2 pilula në javë janë të domosdoshme.

4-Kryeni shpesh kontrollet e zemrës. Duhet të jeni në dijeni se sa të lartë e keni presionin e gjakut.


5-Ushqehuni me fibra. Ushqimet e pasura me fibra forcojnë zemrën.

6-Regjimi i gjumit duhet të jetë i rregullt. Një studim ka dalë në rezultatin se personat që kanë një regjim gjumi jo të rregullt, janë më të rrezikuar nga sëmundjet e zemrës.

7-Përdorni vitaminën D. Vitamina D është e nevojshme për të gjithë ata që vuajnë nga zemra.

8-Lëngu i shegës. Një studim ka treguar se një gotë lëng shege përmirëson presionin e gjakut.

9-Stresi. Stresi është një faktor i fshehtë, i cili shkakton sëmundjet e zemrës. Është e rëndësishme të ruani qetësinë.





## PERIME QË KANË MË SHUMË VITAMINË C *se portokalli dhe limoni*

Kur dëgjoni për vitaminën C, mendja juaj menjëherë shkon tek portokalli ose limoni, por ka dhe disa perime të tjera të shijshme që përmbajnë po aq vitaminë C sa agrumet kështu që është mërzitur portokalli tani mund të hani:

**Luleshtrydhe:** Krahasuar me 70 mg të vitaminës C në një portokall, një kokrra e kuqe e madhe e luleshtrydhes përmban 10.5 mg vitamin C. Luleshtrydhet gjithashtu kanë një dozë të madhe të magnezit dhe folatit, të cilat ndihmojnë për të stabilizuar sheqerin në gjak dhe për të mbajtur zemrën të shëndetshme.

**Brokoli:** 100 gram brokoli të papërpunuar përmban 89 mg vitaminë C. Kjo është pothuajse 90 mg

më shumë se sa rekomandohet në ditë. Gjithashtu ato përmbajnë një dozë të shëndetshme të vitaminës K, e cila promovon shëndetin e kockave .

**Specat:** Specat e kuq, e gjelbër dhe të verdhë përmbajnë pothuajse trefishin e vitaminës C të një portokalli, në 95.7 mg në një spec të gjelbër, 152 mg në specat e kuq dhe 341 mg në specat e verdhë. Janë gjithashtu një burim i madh i fibrave dhe kanë shumë pak kalori.

**Kivi:** Rreth dy kivi kanë 168.8 mg të vitaminës C. Ato janë gjithashtu të pasur me bakër, kalium dhe serotonin, hormon që ndihmon në përmirësimin e cilësisë së gjumit.

## TË NGROHTË APO TË FTOHTË *Si duhet ta konsumoni qumështin*

Qumështi është burim i shkëlqyer i kalçiumit, kaliumit dhe vitaminës D. Ai i ofron organizmit shumë përfitime shëndetësore.

Sigurisht, qumështi është ndër produktet që konsumohet rregullisht pothuajse nga të gjithë njerëzit.

Disa preferojnë ta pijnë qumështin të ngrohtë dhe pjesa tjetër të ftohtë.

Por cila është mënyra më e mirë e konsumimit për të marrë përfitime maksimale nga qumështi?

Sipas dietologëve nuk ka një matës ekzakt për një përgjigje të prerë, kjo pasi temperatura e qumështit (i ngrohtë apo i ftohtë) kur e konsumoni varet nga gjendja shëndetësore dhe shumë faktorë të tjerë.

**Qumështi i Ngrohtë**

Konsumimi i qumështit të ngrohtë është shumë i rekomanduar në rastet e intolerancës së laktozës.

Kur qumështi është i ngrohtë, ai ndihmon organizmin për një tretje më të lehtë.

Kur ju e ngrohni qumështin, laktoza që përmban qumështi shpërbëhet dhe ndihmon në parandalimin e problemeve të pakëndshme që vijnë nga mos tretja, siç është fryrja e stomakut apo edhe diarreja.

Një filxhan me qumësht të ngrohtë para se të flini ndihmon për një gjumë më të qetë.

**Qumështi i Ftohtë**

Nëse vuani nga djegia në stomak atëherë qumështi i ftohtë ndihmon në lehtësimin e menjëhershëm të stomakut.

Përveç kësaj, konsumimi i qumështit të ftohtë pas ngrënies së vaktit ndihmon në parandalimin e aciditetit në stomak.

Të gjithë e dimë se temperaturat e larta në stinën e verës shkaktojnë dehidratim. Konsumimi i një gote me qumësht të ftohtë ndalon dehidratimin.

Koha më e mirë për ta konsumuar atë është herët në mëngjes.

Por duhet të keni kujdes dhe të mos e pini qumështin të ftohtë në rastet kur jeni me grip apo të ftohur.

Pra, siç e shihni pavarësisht nëse preferoni ta pini qumështin të ngrohtë apo të ftohtë gjithçka varet në situatën tuaj shëndetësore.

Ndaj dhe do të ishte e përshtatshme që edhe qumështin ta konsumoni bazuar në faktorët tuaj shëndetësorë.

## ZBULOHEN HARTAT E KOHËS NË TRU

Zbulohen në tru hartat e kohës që mundësojnë të perceptohet kalimi i minutave, ditëve dhe viteve. Këto harta gjenerohen nga zona që quhet “korja shtesë motorike” dhe ky mekanizëm përshkruhet për herë të parë në revistën shkencore “Plos Biology” të institutit “Scuola Internazionale Superiore di Studi Avanzati” (SISSA) në Trieste.

Të koordinuar nga Domenica Bueti, studiuesit kanë zbuluar se në tru disa pjesë aktivizohen nga stimuj me afate të ndryshme. Zonat e përparme për afatet e shkurtra, zonat e pasme për periudhat e gjata.

“Për herë të parë u kuptua, tek njeriu, se si truri jonë shkodifikon kalimin e kohës”, thotë Bueti. Deri tani dihej vetëm që korja shtesë motorike ishte e

përfshirë vetëm në perceptimin e kohës, por nuk dihej se si funksiononte.

Këto zbulime u arritën nëpërmjet monitorimit me rezonancë manjetike të dy grupesh vullnetarësh të shëndetshëm, që duhej të seleksiononin disa imazhe të njëpasnjëshme në ekranin e një kompjuteri për afate të ndryshme kohore, si dhe të thonin se cila nga dy imazhet kishte qëndruar për një kohë më të gjatë.

Tani studiuesit duan të kuptojnë se kujt i përket harta e kohës që kanë krijuar. Pra, është ajo fizike e kohëzgjatjes së stimujve në ekran, apo është ajo e perceptuar nga vullnetari, si dhe nëse kjo hartë është e natyrshme, apo është fryt i eksperiencës dhe edukimit.

## ZHVILLOHET UDHËTIMI I PARË NË KOHË ME NJË KOMPJUTER KUANTIK

Një kompjuter kuantik ka mundësuar udhëtimin e parë pas në kohë, duke u kthyer në të shkuarën për një fraksion sekonde, duke shkelur kështu një prej ligjeve të fizikës, që e paraqet kohën si një shigjetë që mund të ecë vetëm nga e kaluar drejt të ardhmes dhe asnjëherë anasjelltas.

Ky studim i publikuar në revistën shkencore “Scientific Reports” dhe i drejtuar nga Instituti i Fizikës dhe Teknologjisë në Moskë, ka treguar se në kompjutera kuantikë jashtëzakonisht të thjeshtë ky fenomen mund të ndodhë në 85% të rasteve.

Në fakt, shumë ligje të fizikës nuk bëjnë dallime mes të ardhmës dhe të shkuarës. Për shembull, ekuacioni që përshkruan dy bila bilardoje identike që përplasen dhe kthehen është e njëjta gjë edhe nëse shikohet kjo ngjarje e regjistruar në të kundërtën. Ndërsa nëse kthejmë pas videon e bilave

që shpërndahen në të gjitha drejtimet në fillim të lojës, duket qartësisht absurditeti i këtij fenomeni, falë të kuptuarin tonë intuitiv të ligjit të dytë të termodinamikës, sipas të cilit një sistem i izoluar, si ai i tavolinës së bilardos, zhvillohet në mënyrë të pakthyeshme nga një gjendje rendi në kaos.

Studiuesit e drejtuar nga Gordey Lesovik kanë arritur të thyjenë këtë parim, duke përdorur një kompjuter kuantik të përbërë nga shumë pak njësi bazike, që janë ekuivalente me bitët e kompjuterave tradicionale dhe që quhen kubit.

Falë një programi special, kompjuteri e mbështolli shiritin e kohës në një fraksion sekonde, duke u kthyer nga kaosi në rend. Në një kompjuter të përbër nga dy kubit genomeni ndodh në 85% të rasteve, ndërsa kur vemi në tre kubit shkojmë në 50%.

## SHKENCËTARËT: NJERIU QUHET ADOLESHENT DERI NË 30 VJEÇ

I rritur quhesh në moshën 30 vjeç. Ky është zbulimi i fundit nga shkencëtarët, sipas një studimi të publikuar në një konventë ndërkombëtare të mbledhur në Akademinë e Shkencave Mjekësore në Oxford. Sipas mediave britanike, shkencëtarët kanë konfirmuar se qeniet njerëzore quhen të rritur rreth të 30-ve, me diferenca të vogla nga një person në tjetrin.

Mosha ligjore adulte në pothuajse mbarë botën, përfshirë vendin tonë, është 18 vjeç. Por sipas shkencëtarëve, në atë moshë njeriu është ende në rritje, ndërsa pëson edhe ndryshime thelbësore në tru.

Sipas tyre fundi i adoleshencës mund të nisë në moshën 24 vjeçare, siç kanë deklaruar edhe studiues të tjerë të mëparshëm mbi këtë argument. Theksohet se rritja është një proces që zgjat 3 dekada.

## NGADALËSOHET RRYMA E ATLANTIKUT VERIOR, EUROPA BËHET MË E FTOHTË

Ngadalësohet rryma oqeanike që ngroh Atlantikun verior dhe pasojat, që mund të ndihen pas 150 vitesh, mund të jenë temperatura shumë të ulëta në Europë dhe të larta përgjatë brigjeve lindore amerikane, ku për pasojë do të rritet rreziku për uragane, sipas një studimi mbi ndryshimet klimatike që nga fundi i periudhës së fundit të akullnajave, të publikuar në revistën shkencore, “Nature Communications”.

Ky studim është drejtuar nga italianin, Francesco Muschitiello i universitetit britanik të Kembrixhit dhe nga William D’Andrea, i “Columbia University”. Kjo është hera e parë që një studim përlogarit kohët e efekteve mbi klimën të ngadalësimit të rrymës së quajtur AMOC (Atlantic Meridional Overturning Circulation). Kjo u realizua falë riprodhimeve të ndryshimeve klimatike të ndodhura në periudhën

mes 10 000 dhe 15 000 vite më parë falë analizimeve të sedimenteve detare.

“Rezultatet tregojnë se në fund të epokës së fundit akullnajore, kur temperatura botërore u rrit me rreth 3,5 gradë, klima e veriut të Atlantikut pësoi ndryshime shumë të fuqishme për shkak të ndryshimeve të AMOC”, tha Muschitiello. Për më tepër u verifikua se ngadalësimet dhe përshpejtimet e rrymës kishin filluar rreth 300-400 vite para se të verifikoheshin ndryshimet e temperaturës.

“Duke pasur parasysh se studimet e fundit kanë treguar që AMOC është ngadalësuar në 150 vitet e fundit, studimi jonë sugjeron se mund të duhen edhe 150 vite para se të vërrehen rënie të ndjeshme të temperaturave në veri të Atlantikut dhe në Europë”, thekson studiuesi.

## INTERNETI MBUSH 30 VJEÇ, POR PËR SHUMË VAZHDON TË JETË NJË ËNDËRR

Interneti, me emërtimin zyrtar “World Wide Web” (www) ka mbushur 30 vite. Më 12 mars 1989, Tim Berners Lee prezantoi studim në laboratorin CERN të Gjenevës që përbënte bazën teorike të internetit dhe më pas hyri në histori. Duke u bazuar në atë dokument, faqja e parë web u hap në vitin 1991 dhe nga ajo kohë interneti shpërtheu duke i hapur dyert një bote të re komunikimi, informimi, pune dhe krijimtarië.

Megjithatë këto dyer vazhdojnë të jenë të mbyllura për shumë njerëz. Janë mbi dy miliardë persona për të cilët interneti është i paarrtshëm sepse nuk kanë mundësi ekonomike ose sepse nuk ka investime teknologjike në vendet ku jetojnë. Nga ana tjetër, shqetësimi më i madh për përdoruesit e internetit ka të bëjë me sigurinë dhe privatësinë.


Dokumenti që Berners Lee i paraqiti mbikëqyrësit të tij në CERN të Gjenevës quhej “Information Management: a Proposal” (Menaxhimi i Informacioni: një Propozim), që shërbente për të lehtësuar shpërndar-

jen e të dhënave shkencore mes shkencëtarëve.

Brenda dy vitesh Berners-Lee dhe një studiues tjetër, Robert Cailliau, ndërtuan themelet e Web-it duke krijuar edhe browser-in e parë, programi që shërben për të shfletuar faqen në internet. Fizikani që u vlerësua me titullin “Sir” nga mbretëresha Elisabeta II, aktualisht është drejtori i konsorciumit të “World Wide Web”, me të cilin vazhdon të punojë për zhvillimin e internetit.

Pikërisht kjo organizatë, në saj të përpunimit të të dhënave të OKB-së, disa muaj më parë vërtetoi një rënie të numrit të personave në internet, me një ngadalësim drastik në vitin 2015, pavarësisht rritjes që vjen nga Kina. Sipas analizës së fundit të bërë nga “Alliance for Affordable Internet” (Aleanca për Internet të përballueshëm), të futesh në internet vazhdon të jetë një ëndërr për dy miliardë persona në botë, ku më të prekurit janë të varfërit dhe gratë.





“...Mos e lini jetën  
e kësaj bote t’ju mashtrojë  
dhe as djallin  
mos e lini t’ju mashtrojë  
për Allahun.”

*(Lukman, 33)*